



LOGOS

- REVISTË SHKENCORE -

| 2018 | Nr. 5 |



BOTIMET "NGJALLJA"

Kolegji Universitar “LOGOS”

Kryeredaktor:

Prof. Asoc. TEFTA ROTA

Redaksia:

Prof. MERSIN MERSINLLARI

Prof. ILIA NINKA

Prof. Asoc. BEATRIÇE POLO

Ph.D. BLEDAR ILIA

Ph.D. GUXIM KOLA

Dr. RIDVANA MEDIU

M.Sc. DORINA MINXURI, sekretare e redaksisë

Përgatiti për botim:

M.Sc. Dorina Minxuri

Redaktore letrare:

M.Sc. Aida Zoto

Adresa e kontaktit: redaksia@shlplogos.edu.al

ISSN 2308-2208

TREGUESI I LËNDËS

- Një reformë tatimore e studiuar dhe e mbështetur në kushtet konkrete të vendit rrit cilësinë dhe efikasitetin e politikës fiskale 5
Prof.Asoc. Beatrice Polo
- Zhvillimi i qëndrueshëm domosdoshmëri në programet arsimore15
Dr. Blerta Avdia
- Buxhetet e vogla marketing në kushtet e bizneseve shqiptare, aspekte për t’u konsideruar 27
Prof. Asoc. Dr. Blerim Kola, Dr. Jehona Gjermizi
- Prospektivat e revolucionit digjital: Nga teknologjia e informacionit tek makinat inteligjente 35
M.Sc. Elvis Xhori, Ph.D. Guxim Kola
- Krimi kompjuterik dhe shoqëria shqiptare47
Ph.D. Bledar Ilia, M.Sc. Gazmend Sulaj
- Faktorët përcaktues të përfitueshmërisë së bankave: Shqipëria63
M.Sc. Klejda Gabeshi, M.Sc. Iva Sulaj
- Komunikimi marketing në kontekstin ndërkulturor 77
M.Sc. Enxhi Marku
- Zbatimi i parimit të kujdesit nëpërmjet njohjes së provizioneve në Shqipëri93
M.Sc. Enida Abazi, Dr. Rezart Demiraj

• Lidhja afatgjatë ndërmjet inflacionit dhe elementëve të sistemit financiar	105
<i>M.Sc. Iva Sulaj, M.Sc. Klejda Gabeshi</i>	
• Mbi huazimet e gjuhës greke nga ajo angleze	121
<i>M.Sc. Aida Zoto</i>	
• Raporti midis lirisë dhe barazisë sipas Alexis De Tocqueville	151
<i>Anila Kashnjeti</i>	
• Kumtesë: Virtyti, Jeta dhe Vdekja	163
<i>M.Sc. Dorian Sevo</i>	
• Ndikimi i kohës së kontaktit serum-klot në testin e fosforit në grup pacientësh të shëndoshë	171
<i>Dr. Erjola Reufi, Aurela Xhardja</i>	
• Sistemet e shfrytëzimit mobile	181
<i>M.Sc. Olta Petritaj, M.Sc. Xhezmije Lulo</i>	

NJË REFORMË TATIMORE E STUDIUAR DHE E MBËSHTETUR NË KUSHTET KONKRETE TË VENDIT RRIT CILËSINË DHE EFIKASITETIN E POLITIKES FISKALE

Prof. Asoc. Beatrice Polo
Kolegji Universitar “Logos”
Fakulteti Ekonomik
Departamenti Financë-Kontabilitet

Abstrakt

Shteti, që të plotësojë funksionet dhe detyrat që ka në kompetencë të tij, ka nevojë për një sistem tatimor, i cili di t’i sigurojë të ardhura të rrjedhshme, të qëndrueshme dhe do të jetë në reformim të vazhdueshëm. Thelbi i një reforme tatimore synon që të transformojë sistemin aktual tatimor në një model të drejtësisë, të thjeshtësisë dhe efikasitetit, gjë që kërkon që legjislacioni fiskal të ndërtohet në bazë të parimeve themelore të drejtësisë dhe ndershmërisë së kombit.

Në ndryshimet ligjore të paketës fiskale për vitin 2018 një vend të rëndësishëm zë ligji për sistemin e taksave vendore, ku ndryshon metodologjia e llogaritjes së tatimit të pasurisë, nga tatim fiks që bazohet në sipërfaqen e ndërtesës (pasurisë) e shprehur në m², në tatim që aplikohet në përqindje mbi vlerën e tregut të ndërtesës.

Ky ndryshim shoqërohet me ngritjen e kadastrës fiskale (regjistrin të të dhënave të pasurive të paluajtshme) si domosdoshmëri objektive për verifikimin, kontrollin e pasurive, si dhe efikasitetin e mbledhjes së këtij tatimi.

Shqipëria si një vend që ka hyrë në ekonominë e tregut krahas të tjerave,

ka përqendruar vëmendjen tek cilësia dhe efektiviteti i politikës fiskale me synimin e krijimit të një lidhje të qëndrueshme midis objektivave të saj dhe instrumenteve të përdorur. Në hartimin e politikës fiskale qeveria është mbështetur në përvojën e vendeve të zhvilluara, por duke pasur në konsideratë dhe veçoritë e proceseve të zhvillimit në vendet pak të zhvilluara (si vendet e lindjes), në të cilat aftësitë administrative janë të kufizuara, kushtet ekonomike janë krejt të ndryshme si dhe u mungon eksperiencia e ekonomisë së tregut, për të zbatuar një politikë tatimore efikase. Në këto kushte krahas rezultateve të arritura në plotësimin e objektivave makroekonomike të politikës fiskale, mbetet shumë për të bërë në drejtim të përsosjes së instrumenteve financiare, ku një rol primar zënë tatimet sipas llojeve të tyre.

Tatimet janë burimi kryesor i të hyrave publike me të cilat shteti plotëson të dalat publike në kompetencë të tij dhe që kanë të bëjnë me rolin që ai luan në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Në kushtet e ekonomisë së tregut ku bashkëjetojnë dhe konkurrojnë të gjitha format e pronës, shteti ka rolin e rregullatorit kryesor mbi të gjithë veprimtarinë ekonomike dhe sociale, rol ky që mund të përmbledhet në katër drejtime kryesore: a) së pari, në hartimin dhe zbatimin e ligjit publik si një ligj i kudo gjendur që do të thotë se shtetit i takon detyra e ruajtjes së rendit brenda vendit dhe mbrojtjes së kufijve shtetërorë; b) së dyti, në mbajtjen e një konkurrence sa më efektive në treg për të siguruar një zhvillim dhe një rritje të ekonomisë; c) së treti, në korrigjimin e avarive në treg sepse siç është e njohur, zhvillimi ekonomik nuk realizohet automatikisht dhe pa pengesa dhe për këtë arsye lind nevoja që shteti të marrë kundërmasa në vijim të parimeve të tregut, që realizohen nëpërmjet politikës tatimore, të dalave publike, eksport-importit etj.; dhe d) së katërti, në përmbushjen e detyrës për kompensimet shoqërore të individëve në rrethana të caktuara. Në të tilla raste përfshihen sëmundjet, invaliditeti, pensionet, asistenca sociale etj.

Në këto kushte, pa një sistem tatimor efikas dhe elastik që t'i sigurojë shtetit të hyra të rrjedhshme dhe të qëndrueshme, ai nuk mund të plotësojë funksionet dhe detyrat që ka në kompetencë të tij dhe për pasojë të luajë rolin që i takon në të gjithë jetën e vendit. Shprehur më thjeshtë, të ardhurat

tatimore janë të nevojshme për të garantuar demokracinë, rendin publik dhe funksionimin e sistemit ligjor.

Në ditët e sotme tatimi duhet të jetë më shumë se sa thjesht burim i të ardhurave për funksionimin e shtetit; tatimi duhet të garantojë që strukturat publike të kontribuojnë në mënyrë aktive për ndjekjen e synimeve të politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore. Një infrastrukturë e duhur rrugore, një sistem efikas i transportit publik, një shërbim modern shëndetësor dhe spitalor, një sistem i përshtatshëm i politikave arsimore, të mbrojtjes mjedisore dhe punësimit aktiv si dhe trajnimit profesional, kërkojnë zbatimin me korrektësi të financave publike.

Në vendet e zhvilluara sistemi tatimor ligjor është rezultat i një shtresimi shekullor për të cilin me evoluimin e kushteve politike, ekonomike, dhe sociale ndryshohen dhe mënjahohen tatimet e vjetra dhe futen lloje të reja të tatimeve, pra bëhet e nevojshme reforma në fushën e tatimeve. Thelbi i reformës tatimore është të synojë në transformimin e sistemit aktual tatimor në një model të drejtësisë, thjeshtësisë dhe efikasitetit; pra, legjislacioni fiskal të ndërtohet në bazë të parimeve fundamentale të drejtësisë dhe të ndershmërisë së kombit. Nuk duhet lejuar që ndërsa një pjesë e publikut të jetë i rënduar nga tatime të larta që pengojnë punën dhe kursimin, pjesa tjetër të jetë e privilegjuar të përfitojë nga shmangiet legale apo ilegale, duke evituar në këtë mënyrë të paguajnë pjesën që u takon dhe ndonjëherë për të mos paguar fare asnjë detyrim. Për këtë është e nevojshme që sistemi tatimor të ndërtohet në mënyrë të tillë që tatim-paguesit të jenë të vetëdijshëm për tatimet që duhet t'i paguajnë shtetit, në mënyrë që procesi politik të mund të reflektojë me kujdesshëm preferencat e qytetarëve.

Sipas llojit të tatimeve sistemet tatimore mbështeten në tri shtylla: a) tatimet direkte, ku përfshihen tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi fitimin dhe tatime të tjera mbi të ardhurat; b) tatimet indirekte, ku më kryesoret janë tatimi mbi vlerën e shtuar, akciza si dhe tatime të tjera mbi konsumin; c) kontributet shoqërore të punonjësve, punëdhënësve dhe të vetë-punësuarve.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat për vitin 2016 zënë mbi 90% të të ardhurave totale të shtetit, dhe detajuar sipas zërave më kryesorë TVSH

(tatimi mbi vlerën e shtuar) përben 32,3% të të ardhurave totale buxhetore; të ardhurat nga fitimi zënë 7.2%; nga tatimi mbi të ardhurat personale zënë 7.7%; të ardhurat nga akciza zënë 10.3% të totalit të të ardhurave buxhetore.

Veprimtarinë e tij shteti nuk e realizon vetëm nëpërmjet pushtetit qendror por edhe nëpërmjet niveleve më të ulëta, që janë pushtetet lokale me autonomi lokale sipas ndarjes administrative territoriale të një vendi. Karta evropiane mbi vetëqeverisjen lokale parashikon që pushtetet lokale kanë të drejtë të menaxhojnë një pjesë të fondeve jashtë buxhetit të shtetit të cilat përputhen me nevojat që ka pushteti lokal për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë, të cilat janë të përcaktuara nga legjislacioni fiskal dhe nga Kushtetuta. Një burim i rëndësishëm të ardhurash për pushtetin lokal, krahas burimeve të tjera, është dhe tatimi mbi pasurinë e paluajtshme si një tatim i drejtpërdrejt, dhe vjetor. Dy janë karakteristikat themelore që e dallojnë tatimin e pasurisë nga llojet e tjera të tatimeve: a) tatimi vendoset mbi vetë pasurinë, dhe jo mbi pronarin; dhe b) tatimi llogaritet mbi vlerën e pasurisë (tek ne në bazë të sipërfaqes) dhe jo mbi fuqinë ekonomike të pronarit, që do të thotë se në rast se detyrimi tatimor nuk paguhet, procedura e detyrueshme është shitja e pasurisë dhe pagimi i tatimit me të ardhurat nga shitja e saj.

Ky lloj tatimi përcaktohet në lidhje me tipologjinë e pasurisë së paluajtshme, ka karakter real, si rrjedhim prek pronësinë e ndërtesave, trojeve për ndërtim dhe tokave bujqësore, pavarësisht nga gjendja ekonomike e tatim paguesit.

Ndonëse siç përmendëm më sipër tatimi mbi pasurinë është një tatim i rëndësishëm për pushtetin lokal, siç është vërtetuar nga praktika e vendeve të zhvilluara perëndimore, ai mbetet gjithmonë një burim i kufizuar të ardhurash. Një gjë e tillë ka argumentet e vet objektive.

Teoria dhe praktika financiare ka vërtetuar se për tatim-paguesin e rëndësishme është se prej cilave burime tatimore do të kryet detyrimi tatimor. Si burim tatimor janë të hyrat apo të ardhurat ose dhe pasuria e tatim-paguesi. Si rregull duke iu referuar literaturës financiare të shteteve me ekonomi tregu të zhvilluar, duhet të tatohen vetëm ato burime të ardhurash të cilat në mënyrë të vazhdueshme përtërihen dhe ripërtërihen, pra si burim për pagimin e tatimit duhet të shërbejnë të hyrat apo të ardhurat e tatim-paguesit, të tilla si të ardhurat nga puna, të ardhurat e firmës në formën e

fitimit të saj, të ardhurat nga interesat për depozitat e kursimit, të ardhurat nga qiratë, të ardhurat nga shitja e pasurës së paluajtshme etj., dhe kjo përben një postulat në fushën e tatimeve mbi të cilën bazohet gjithë sistemi tatimor i çdo shteti me ekonomi tregu dhe ndërtohet legjislacioni fiskal i tij. Krahas të hyrave apo të ardhurave, si burim tatimor për tatimpaguesin shërben edhe pasuria e paluajtshme të tilla si ndërtesat, trojet apo toka bujqësore, ku tatohet pasja e ndërtesës, e truallit apo tokës bujqësore, pra e pronës-pasuri, me fjalë të tjera tatohet vlera figurative e pasurisë. Tatimpaguesi paguan tatimin mbi pasurinë e nëmënyrë indirekte tatohen të ardhurat e tij, pasi objekt tatimi në këtë rast është ekzistenca e pasurisë, jo të ardhurat që ajo krijon. Është kjo arsyeja që ngarkesa tatimore tek ky lloj tatimi nuk duhet të jetë e lartë sepse përndryshe do të krijojë mundësinë që tatimi të paguhet prej pasurisë ekzistuese, p.sh. duke shitur një dhomë nga ndërtesa që tatim-paguesi ka në pronësi të tij, apo duke shitur një pjesë të tokës bujqësore të tij për të paguar tatimin që përben një detyrim ligjor ndaj shtetit. Për pasojë pagimi i tatimit bëhet nga pasuria e tatimpaguesit sepse të ardhurat e tij janë të pamjaftueshme që do të thotë se nuk tatohen burimet që përtërihen vazhdimisht por me anë të tatimit zvogëlohet realisht pasuria e tatim-paguesi.

Një politikë fiskale e shtetit që synon të rrisë të ardhurat e veta duke vendosur tarifa të larta tatimore për tatimin mbi pasurinë, mendohet se është e dëmshme sepse e shkatërron tatim-paguesin dhe burimin tatimor. Po t'i referohemi praktikës financiare të shumë vendeve, ajo ka vërtetuar se të ardhurat nga ky lloj tatimi nuk janë të larta, ndonëse këtu një ndikim të ndjeshëm jep shkalla e zhvillimit të çdo shteti. Për rrjedhojë, në shtetet e zhvilluara dhe me individë më të pasur, ky lloj tatimi zë në strukturën e të ardhurave një peshë më të madhe, se në strukturën e të ardhurave të shteteve në zhvillim.

Duke iu referuar statistikave të OECD mund të themi se në vendet e zhvilluara të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë: në Itali zënë 2.8% të PBB (Produktit të Brendshëm Bruto); në Greqi 2% të PBB; ndërsa në Zvicër 1.9% të PBB. Nivelin më të lartë në të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë e mbajnë Anglia dhe Franca me 4.1% të PBB. Në vendet në zhvillim me gjithë ndihmën

dhe asistencën ndërkombëtare, ky lloj tatimi siguron më pak se 1% të PBB. Aktualisht vendet e Rajonit e kanë këtë tregues nga 0.7 – 1% të PBB, ndërsa vendi që ka performancën më të mirë në rajon është Kroacia me 2% të PBB. Në vendin tonë të ardhurat e buxhetit lokal nga tatimi mbi pasurinë zënë me pak se 0.3 % të PBB.

Nuk përjashtohet rasti që të ekzistojë dhe mendime subjektive, sigurisht jo ekonomike, që ky tatim të mos përdoret fare, pra të hiqet nga sistemi tatimor.

Ritheksojmë se tatimi mbi pasurinë është element i rëndësishëm i sistemit tatimor të çdo shteti me ekonomi tregu dhe vjelja e tij bëhet mbi bazën e disa kriterëve që dëshmojnë mbi rëndësinë që ka në praktikë zbatimi i këtij tatimi. Së pari, është problemi i paanësisë horizontale që përben aspektin themelor për të mbrojtur tatimin mbi pasurinë, pasi posedimi i një pasurie paraprin njëseri avantazhesh, sepse shton pavarësinë, prestigjin, likuiditetin. Së dyti, ky kriter lidhet me efikasitetin. Meqenëse barra e një tatimi mbi pasurinë është e pavarur nga vetë e ardhura e pasurisë, ajo nxit për të përdorur pasurinë në investime me frytshmëri të madhe. Pra, tatimi mund të ketë efekte nëzhvendosjen e përdorimit të pasurisë nga forma jo produktive (si koleksionet e artit) në forma më produktive. Së treti, ky kriter ka të bëjë me një shpërndarje sa më të drejtë të barrës tatimore. E konkretizojmë me një shembull: supozojmë se kemi dy persona që sigurojnë të ardhura të barabarta nga puna që kryejnë, e për pasojë sistemi tatimor i taton në mënyrë të barabartë. Por ndërsa njeri prej tyre ka në pronësi të vet një vilë të tipit bashkëkohor, tjetri nuk disponon asnjë pasuri të paluajtshme. Në këto kushte a do të ishte e drejtë që sistemi tatimor t'i tatonte këta persona në mënyrë të barabartë? Kriteri i fundit është i karakterit administrativ dhe konsiston në faktin se mbi bazën e lidhjes së ngushtë që ekziston midis pasurisë dhe të ardhurave, administrimi i tatimeve mbi pasurinë mund të ndihmojë pushtetin tatimor në administrimin e tatimit mbi të ardhurat përmes një kontrolli të kryqëzuar të deklarimeve të të dy llojeve të tatimeve.

Çfarë ofron ligji i Tatimit mbi Pasurinë e paluajtshme që zbatohet në vendin tonë?

Tatimin mbi pasurinë e paluajtshme e paguajnë të gjithë personat fizikë

ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Në tatimin mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) Tatimi mbi ndërtesat;
- b) Tatimi mbi tokën bujqësore;
- c) Tatimi mbi truallin.

Tatimi llogaritet si detyrim vjetor i tatim-paguesit. Si bazë e tatimit mbi ndërtesat aktualisht përdoret sipërfaqja e ndërtimit në m². Sipërfaqja e ndërtesës në pronësi apo në përdorim përcaktohet sipas dokumenteve që vërtetojnë këtë pronësi. Niveli i tatimit caktohet në lekë për m². Detyrimi për tatimin llogaritet si shumëzim i nivelit të tatimit me bazën e tatueshme. Tatimi i mbledhur në mbështetje të ligjit të tatimit mbi pasurinë Nr.9632 datë 30.10.2006, i ndryshuar, paguhet në buxhetin e Bashkisë (pushteti lokal) ku ndodhet pasuria (prona) dhe ky detyrim është vjetor. Baza e tatueshme klasifikohet për ndërtesat në tri kategori: kategoria e parë, e dytë dhe e tretë, ndërsa niveli i taksës është i diferencuar për çdo kategori. E konkretizojmë me një shembull: nëse ndërtesa e banimit, me sipërfaqe 90 m², ndodhet në Tiranë dhe është e ndërtuar para vitit 1993, ajo bën pjesë në kategorinë e parë (zona 1) dhe niveli i tatimit për m² në këtë zonë është 15 lekë, atëherë detyrimi tatimor i pronarit të ndërtesës në formë të tatimit mbi pasurinë do të jetë $90 \times 15 = 1350$ lekë. Në rast se ndërtesa e banimit është ndërtuar pas vitit 1993, atëherë niveli i taksës për zonën 1 është 30 lekë për m² dhe shuma e tatimit për të njëjtën sipërfaqe do të jetë: $90 \times 30 = 2700$ lekë.

Tatim-paguesit që kanë në pronësi më shumë se një ndërtesë (shtëpi) ku kanë banimin e zakonshëm, paguajnë tatimin për çdo pronë sipas zonave ku ndodhet prona (ndërtesa) të kategorizuara, sipas zonës. Për të gjitha ndërtesat e tjera në pronësi, tatimi i ndërtesës është sa dyfishi i tatimit që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.

Ndryshimet që janë bërë në përsosje të ligjit “Për Sistemin e Taksave Vendore” Nr. 106 / 2017 në kuadrin e reformës fiskale të pushtetit vendor, do të shoqërohen duke filluar nga muaji prill i vitit 2018 me zbatimin e një formule të re në llogaritjen e tatimit mbi pasurinë. Konkretisht si bazë e tatueshme për

tatimin mbi pasurinë nuk do të shërbejë sipërfaqja e ndërtesës, sikurse është vepruar deri më sot, por llogaritja do të bëhet mbi bazën e vlerës së pasurisë si një metodë më reale dhe që zbatohet në të gjitha vendet evropiane ku duam të aderojmë edhe ne. Ligji “Për Sistemin e Taksave Vendore” si pjesë e paketës fiskale për vitin 2018, përcakton se niveli i tatimit mbi pasurinë për ndërtesat që shfrytëzohen për banim do të jetë 0.05% të vlerës së pronës dhe 0.2% të vlerës së pronës që përdoret për veprimtari ekonomike.

Vlera mesatare e pasurisë (ndërtesa banimi) në tregun e lirë të banesave është e përcaktuar sipas qyteteve dhe e ndarë në zona me Udhëzimin Nr.3 datë 28.12.2016.P.sh. po t’i referohemi qytetit të Tiranës zona 1/1 e ka të përcaktuar çmimin për m2 sipërfaqe shfrytëzimi 97.700 lekë; zona 1/2 e ka të përcaktuar çmimin për m2 në 78.000 lekë; dhe zona 2/4 e ka të përcaktuar çmimin për m2 në 110.000 lekë. Nëse qytetari ka një pasuri (apartament) me sipërfaqe banimi 70 m2 dhe ndodhet në Tiranë, në zonën 2/4 (çmimi për metër katror në këtë zonë është vlerësuar me udhëzimin e Këshillit të Ministrave në 110.000 lekë), atëherë shuma e tatimit mbi pasurinë (apartamentin) do të llogaritet: $70 \times 110.000 = 7.700.000$ është vlera e apartamentit - $7.700.000 \times 0.05\% = 3.850$ lekë është shuma e tatimit mbi pasurinë (apartamentin) që do të paguajë qytetari për pasurinë e paluajtshme që ka në pronësi.

Me metodën e re të llogaritjes së tatimit mbi pasurinë është parashikuar që në projekt-buxhetin e vitit 2018 të ardhurat nga ky tatim të arrijnë në 0.5 % të PBB. Vlera e pasurisë që do të shërbejë si bazë për tatimin llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Detyrë e rëndësishme për realizimin me sukses të procesit të vjeljes së tatimit mbi pasurinë është menaxhimi i regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale) që do të kryet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimit të Pasurisë si një hallkë e re që do të ngrihet për këtë qëllim dhe udhëheqja metodologjike nga kjo Drejtoria mbi procesin e administrimit të tatimit mbi pasurinë e paluajtshme.

Të ardhurat e mbledhura nga tatimi mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë’.

Përvoja e vendeve të zhvilluara dhe zbatimi i kësaj përvoje në kushtet konkrete të vendit tonë, shoqëruar kjo me reforma ekonomike të studiuara dhe efikase do të çojë përpara zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Bibliografia

1. Harvey S. Rosen. Financa Publike.
2. Mario Leccisotti. Leksione të Shkencës së Financave.
3. Martin Hutsebaut. Politikat Tatimore sipas Këndvështrimit Evropian.
4. Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.
5. Fondacioni Shoqëria e hapur Për Shqipërinë. Monitorimii Financave Publike. Analiza e Projekt-Buxhetit 2017.
6. Udhëzimi Nr. 3 date 28.12 2016. “Për Miratimin e Kostos Mesatare të Ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për Vitin 2016.
7. Ligji Nr. 68/2017. “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.
8. Ligji Nr. 106/2017. “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9632, datë, 30.10.2006 - “Për sistemin e Taksave Vendore” - të Ndryshuar”.

Summary

The state needs a tax system to fulfil its functions and duties having in its jurisdiction, which ensures a sustainable flow of income, and continuous reform. The essence of a tax reform aims to transform the current tax system into a model of justice, simplicity and efficiency, which requires fiscal legislation to be built on the fundamental principles of righteousness and honesty of the nation.

In the legal changes of the fiscal package for 2018, the law on local tax system takes an important place, where the methodology for calculating the property tax is changed from fixed tax based on the surface of the building (property) expressed in square meters to a tax which is applied in percentage to the market value of the building.

This change is accompanied by the establishment of a fiscal cadastre (real estate register) as an objective for the verification, control of assets and the efficiency of collecting this tax.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DOMOSDOSHMËRI NË PROGRAMET ARSIMORE

Dr. Blerta Avdia

Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Menaxhim Turizëm

Abstrakt

Shoqëria në ditët e sotme po bëhet gjithmonë dhe më shumë shoqëri konsumi. Prirja individualiste e saj për të plotësuar nevojat të jetesës në aspektin ekonomik, social, kulturor ka bërë që ta konsiderojë mjedisin si një pasuri të pashtershme duke sjell pasoja negative. Në këtë aspekt realiteti i sotëm është në kërkim të një zhvillimi ekonomik, social, mjedisor të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Këtë mundësi e siguron modeli i ri, ai i zhvillimit të qëndrueshëm.

Po si lindi ky koncept? Si ta kuptojmë ndikimin e tij në zhvillimin social, ekonomik, mjedisor të një vendi në përgjithësi dhe Shqipërisë në veçanti?

Cilët janë aktorët përgjegjës për Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm?

Sa vend zë në programet arsimore shqiptare Zhvillimi i Qëndrueshëm?

Këtyre pyetjeve dhe të tjerave që do të dalin gjatë trajtimit të temës do t'i japim përgjigje përmes metodologjisë përshkruese, analizuese, argumentuese. Ky punim nuk do të jetë përfundimtar të problematikës, pasi Zhvillimi i Qëndrueshëm është një model sa i thjeshtë për t'u kuptuar, aq dhe kompleks për t'u zbatuar në praktikë.

Fjalëtkyçe: Zhvillimi i Qëndrueshëm, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm, program

1. Çfarë është zhvillimi i qëndrueshëm? Konceptet bazë

Në zhvillimin ekonomik, social, teknologjik të një shoqërie duhet të merret në konsideratë dhe mjedisi si një element kyç në zhvillimin ekonomik, social afatgjatë dhe të qëndrueshëm të saj. Shoqëria në ditët e sotme po bëhet gjithmonë dhe më shumë shoqëri konsumi. Prirja individualiste e saj për të plotësuar nevojat të jetesës në aspektin ekonomik, social dhe kulturor ka bërë që ta konsiderojë mjedisin si një pasuri të pashtershme duke sjellë pasoja negative, të cilat reflektohen në katastrofa natyrore.

Problematika mjedisore është e lidhur ngushtë me ecurinë e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, duke bërë që mjedisi dhe koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm të bëhet objekt studimi i një numër të madh të shkencave natyrore dhe humane, pjesë e debateve dhe konferencave kombëtare e ndërkombëtare.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një model i ri zhvillimi, që kërkon një zhvillim të integruar mjedisor, ekonomik dhe social. Ky model zhvillimi, i tërheq vëmendjen shoqërisë se: *«Ne nuk e trashëgojmë tokën nga paraardhësit tanë, ne e kemi marrë atë hua nga fëmijët tanë.»*¹ Ndaj çdoaktivitet ekonomik apo social duhet të shihet i lidhur ngushtë me mjedisit në mënyrë që të jetë afatgjatë dhe i qëndrueshëm.

Fillesat e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm i kemi në vitin 1972 me Deklaratën e Stokholmit e cila u miratua në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi *“Mjedisin Njerëzor”*, ku u hodh dritë mbi respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, për të arritur deri tek koncepti i Brutlandit në Rio (1992), sipas të cilit *“Zhvillimi i qëndrueshëm, konsiderohet si një zhvillim që takon nevojat e së tashmes, pa kompromentuar aftësinë për të plotësuar nevojat e brezave të ardhshëm”*² dhe përmes të cilit, cilësohej se e ardhmja bazohej në zhvillimit ekonomik, social dhe qëndrueshmërinë mjedisore.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një koncept i ri i lidhur ngushtë

1 Antoine de Saint-Exupery në vitet 30-të të shekullit të kaluar.

2 https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5839GSDR%202015_SD_concept_definiton_rev.pdf

(United Nations General Assembly, 1987, p. 43).

me jetëgjatësinë e një aktiviteti, i cili mund të lidhet me veprimtarinë ekonomike, sociale apo mjedisore. Përmes këtij koncepti theksi vendoset te fakti se realizimi i një veprimtarie të shoqërisë njerëzore nuk mund të shihet i ndarë apo iveruar.

“Nëse ne duhet të zhvillojmë turizmin në një hapësirë gjeografike të caktuar (e cila përmbushë kriteret që duhet të ketë një destinacion turistik), si një aktivitet ekonomik që prodhon të ardhura, mundësi punësim dhe krijon treg turistik; njëherazi në aspektin social duhet të mos krijojë kushte për diskriminim të turistëve nga popullsia pritëse (që turisti të mos shihet si një “mbret” dhe popullsia vendase si “shërbëtor” i tij), pre e krimeve, por të shërbejë si një aktivitet ekonomik që përmirëson statusin social të familjes, shkëmbiminkulturor dhe forcimin e identitetit lokal, rajonal apo kombëtar; nga ana tjetër zhvillimi i turizmit duhet të marrë në konsideratë kapacitetin mbajtës të mjedisit për numrin e turistëve të pranishëm në atë zonë në mënyrë që të shmangë ndotjet akustike, grumbullimin e mbetjeve, të ruajë dhe të mbrojë ekuilibrat natyrorë”.

Përmes këtij shembulli të thjeshtë evidentuam që zhvillimi i turizmit në një zonë të caktuar nuk mund të shihet si një zhvillim apo aktivitet i izoluar ekonomik, por i lidhur ngushtë edhe me dy shtyllat e tjera të zhvillimit të qëndrueshëm: social dhe mjedisor, në funksion të zhvillimit të turizmit afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

Realizimi i konceptit të Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk është diçka e lehtë, por mjaft komplekse pasi kërkohet një bashkëpunim mes aktorëve të ndryshëm të pushteti lokal, qendror, komunitetit, biznesit, OJF etj.

Rëndësia që ka sot Zhvillimi i Qëndrueshëm në jetën ekonomike, sociale dhe mjedisore ka bërë që politikat kombëtare dhe ndërkombëtare të kushtojnë një rëndësi të veçantë Zhvillimit të Qëndrueshëm afatgjatë. Kjo është reflektuar edhe në hartimin e Strategjive Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020³ dhe në Strategjitë Rajonale të Bashkive, ku fokusi është zhvillimi afatgjatë dhe i qëndrueshëm i vendit dhe i rajonit në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor.

Shqipëria si një vend kandidat për t’u integruar në Bashkimin Evropian

3 Këshilli i Ministrave. **VKM Nr. 348, datë 11.5.2016**, botuar në **Fletoren Zyrtare Nr. 86**.

dhe në kuadrin e reformave që duhet të realizojë, mban një qëndrim të veçantëmbi reformat për mjedisin (përfaqësohet në raport përmes kapitullit 27⁴). Rëndësia që ka çështja mjedisore në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, të transportit, të energjisë si dhe të sigurisë ushqimore, bën që qëndrueshmëria mjedisore të marrë një dimension të rëndësishëm në kuadrin reformave në procesin integruar të Shqipërisë në BE dhe paralelisht me të dhe koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Roli i edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi është një e drejtë e shoqërisë njerëzore e njohur nga një sërë dokumentesh të rëndësishme ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), Konventa e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara (1989), të Drejtat Universale të Njeriut për fëmijët etj. Këto i japin një rol të veçantë të drejtës për arsim⁵. Megjithatë ishte viti 1975 kur Kombet e Bashkuara përcaktuan konceptin e “Edukimit për Zhvillimin” si një iniciativë që “...do të aftësojë njerëzit të marrin pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre, të kombeve dhe botës në tërësi”.

Përmes edukimit *krijohen qytetar dhe të jesh qytetar do të thotë të jesh i lirë; të jesh i lirë do të thotë të mundësh; të mundësh do të thotë të dish të zgjedhësh*. Ky edukim ndikon në formimin profesional, në zhvillimin kritik dhe afatgjatë e të qëndrueshëm të individit që mund të përkthehet në veprimtarinë e tij ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Termi “Zhvillim i Qëndrueshëm” erdhi nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës⁶ si një domosdoshmëri e kohës për mbrojtjen e mjedisit në kohën e zhvillimit ekonomik dhe social që po ndërmerrnin vendet e ndryshme, duke na kujtuar se të gjitha aktivitetet ekonomike, sociale dhe mjedisore duhet të shihen të integruara me njëra-tjetrën në funksion të shmangies së problemeve që sjell zhvillimi social, teknologjik, historik dhe politik.

Problemet mjedisore në nivel global, rajonal apo lokal ndikojnë që

4 EMA. Mbrojtja Konsumatore dhe mbrojtja e mjedisit. FLESH, Tiranë, 2017, fq. 15.

5 OKB. Deklarata e të Drejtave të Njeriut. 10.12. 1948 OKB. Konventa e të Drejtave të Fëmijës, neni 28, 29. 20.11.1989. <https://www.giz.de/expertise/downloads/giz2013-alb-seminari-1.pdf>

6 M.Keta. 2015. Filozofia, Shkolla e Lirisë që mundëson Sistemi Arsimor Shqiptar dhe MASH. Punim Doktorat, fq. 27.

edukimi mjedisor në veçanti dhe edukimi i qëndrueshëm në përgjithësi të jetë në qendër të diskutimeve të sotme pavarësisht mënyrës së edukimit: formal apo joformal.

Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm do të ndikojë në kultivimin e ndërgjegjes qytetare për pasojat që sjellin veprimet e tij si rezultat i shfrytëzimit të burimeve natyrore pa kriter në funksion të zhvillimit social dhe ekonomik duke rrezikuar të ardhmen e tij. Si një e drejtë e informimit që vjen nga Konventa Arhus⁷ në funksion të përmirësimit të sjelljes së tij.

Edukimi për qëndrueshmëri del jashtë auditorëve të universiteteve, klasave të arsimit para universitar, pasi prek jetën individuale të gjithsecilit prej nesh, duke reflektuar në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar ndaj problematikës mjedisore dhe rritur aktivizimin në vendimmarrjet me objektiv mjedisin.⁸

Një rol të rëndësishëm në edukimin për qëndrueshmërikanë institucionet e edukimit, të cilët kryejnë funksione kryesore në edukim në termat afatgjatë. Ky ndikim vërehet në kontributin individual që japim në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor në një hapësirë të caktuar kombëtare, rajonale dhe lokale. Roli edukues i këtyre institucioneve nis në një moshë të vogël, duke siguruar një të ardhme të sigurt në lidhje me edukimin e qëndrueshëm.

Edukimi për qëndrueshmëri nuk do të kryhet vetëm në mënyrë formale (kopshte, shkolla në arsimin parauniversitar, universitet), por dhe ato joformale si një proces i të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ky i fundit mund të jetë më tërheqës për edukimin e qëndrueshëm për arsyt të lehtësisë së përfshirjes së individëve për t'u bërë pjesë e këtij edukimi, dhe në mënyrë më kreative. Një formë tjetër e edukimi për qëndrueshmëri është dhe përmes trajnimeve të herëpashershme tashmë, metodologji që nuk kufizohet vetëm tek nxënësit, por dhe tek grupmoshat e ndryshme të popullsisë.

Edukimi për Zhvillimin e Qëndrueshëm që të arrijë një ndikim afatgjatë në zhvillimin social, ekonomik dhe mjedisor të një vendi të caktuar duhet:

- a) të jetë pjesë e kurrikulave shkollore përmes futjes së tematikave të

7 EMA. Mbrojtja Konsumatore dhe mbrojtja e mjedisit. FLESH, Tiranë, 2017, fq. 18.

8 EMA. Mbrojtja Konsumatore dhe mbrojtja e mjedisit. FLESH, Tiranë, 2017, fq. 20.

Edukimi për Zhvillimin e Qëndrueshëm në të gjitha lëndët dhe programet mësimore, ku të realizohet dhe integrimi ndërlëndor⁹;

b) të shkëmbehen përvoja të vlefshme për të pasur sjellje të qëndrueshme nga institucionet edukative, në vendin e punës, në familje dhe komunitet;

c) të rrisë bashkëpunimin dhe partneritetin midis anëtarëve të institucioneve edukuese dhe aktorëve të tjerë;

d) të trajtojë në mënyrë të integruar problemet globale, rajonale, kombëtare dhe lokale mjedisore, duke i lidhur paralelisht dhe me problemet ekonomike dhe sociale;

e) të përdorë një metodologji të gjerë në dobi të edukimit të qëndrueshëm me qëllim rritjen e përgjegjësisë mjedisore, sociale dhe ekonomike tek nxënësit, duke u larguar nga metodat tradicionale teorike në drejtim të ndërveprimit praktik me qëllim zgjidhjet konkrete të problemeve.

2.1. Cilët janë aktorët që mund të kontribuojnë në Edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm?

Aktorët që mund të kontribuojnë në Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm janë:

- *Qeveria*- Mjedisi është një drejtë e njeriut dhe Qeveria të jetë mbështetëse përmes nismave të caktuara (fushata për pakësimin e mbetjeve, përdorimin e materialeve të riciklueshme, ndarja e mbetjeve që në burim). Nga ana tjetër, për shkak të rëndësisë që ka mjedisi në sektorët e ekonomisë, merret në konsideratë në kohën e hartimit të planeve “Zhvilluese Kombëtare, Rajonale, Lokale”, me qëllim zhvillim ekonomik dhe social mjedisor afatgjatë. Në kuadrin e realizimit të objektivave ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm duhet të plotësohen objektivat që janë vendosur në “Agjenda 21”¹⁰ dhe organet përgjegjëse: Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave.

9 Rec. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm. fq. 18.

10 Konferenca e OKB-së për Mjedisin dhe Zhvillimin në Rio de Zhaneiro, qershor 1992.

- *Institucionet e edukimit*- Përfaqësohen nga institucionet që kryejnë edukimin formal privat apopublik (arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, arsimi universitar);përmes edukimit joformal i cili kryhet nga kompani të ndryshme të biznesit, Banka, OJF etj.

- *Organizatat Jofitimprurëse*– OJF-të (me fokus jo vetëm mjedisor) luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me edukim për qëndrueshmëri. Duke qenë se OJF-të kanë lehtësiranë lidhjeme realizimin e edukimi të qëndrueshëm (përmes seminareve, trajnimeve apo aktiviteteve të ndryshme), shmangin burokracitë, përdorin lobimin apo konsensusin për arritjen e marrëveshjeve të rëndësishme, kanë ndjeshmëri të veçantë ndaj problemeve mjedisore. Mund të përmendim rastin e ndalimit të importit të mbetjeve në Shqipëri , i cili u realizua tërësisht nga shoqëria civile. Përmes këtij akti u cilësua se sa i rëndësishëm është edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm. Disa nga organizatat që kanë rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor dhe promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm janë: WWF, REC, UNESCO, OKB etj.

- *Mediat dhe Masmedia*-Kanë një rol kryesor në informimin e publikut në lidhje me edukimin për qëndrueshmëri përmes efektit vizual dhe të shkruar duke ndikuar në ndryshimin e sjelljeve së konsumatorit, në politikat mjedisore dhe influencojnë vendimmarrjen e investueseve.

- *Shkencëtarët dhe ekspertët mjedisor* -Kanë një rol të rëndësishëm në formimin shkencor mbi qëndrueshmërinë mjedisore, pasi ofrojnë informacion të detajuar shkencor në identifikimin dhe sinjalizimin e problematikave mjedisore dhe identifikojnë nevojat për ndërhyrje për marrjen e masave, për zgjidhje të problematikave dhe për rritjen e qëndrueshmërisë. Shkencëtarët dhe ekspertët njëherazi, me punën e tyre kryejnë dhe rolin e këshilluesit mjedisor përmes përshkrimit të tregueseve mjedisore. Prishja e normave të këtyre tregueseve tregon problemet mjedisore që hasen në botë dhe masat që duhet të merren në ruajtjen e ekuilibrave mjedisore (ngrohja globale, ndryshimet klimatike, efekti sere etj.).

- *Sipërmarrësit*- Edukimi për qëndrueshmëri nga sipërmarrësit kryhet përmes aplikimit të praktikave të mira siç janë: promovimi i trashëgatieve në vend të qeseve plastike, prodhimi i produkteve, mbetjet e të cilave

janë të degradueshme, shitja e produkteve pa kimikate, pjesëmarrja në fusha mjedisore etj. Vetë sipërmarrësit e edukimit të qëndrueshëm e konsiderojnë aset për zhvillimin e tyre në tregun ku ato operojnë duke influencuar në rritjen e të ardhurave të tyre. Të tilla biznese janë: Toyota Motor Europe, BMW Bigmarket etj.

- *Partitë e Gjelbëra* - Partitë politike me objektiv mjedisin luajnë një rol kryesor në ndikimin e politikave mjedisore dhe sidomos në përfshirjen e tyre në sistemin arsimor. Partitë e Gjelbëra me veprimtarinë e tyre në parlament kanë ndikuar fuqishëm në ndryshimin e mentalitetit për çështjet mjedisore dhe marrjen në konsideratë të mjedisit gjatë hartimit të Planeve Kombëtare të Zhvillimit të një vendi.

Të gjithë aktorët sëbashku luajnë një rol të rëndësishëm në Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe ndryshimin e mentaliteteve ndaj qëndrimit në raport me mjedisin.

3. Vendi i zhvillimit të qëndrueshëm në programet e arsimit shqiptar sot, perspektiva

Arsimi luan një rol të rëndësishëm në formimin e individëve, të cilët si pjesë përbërëse e shoqërisë ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe social. Arsimi nuk është një fenomen statik, ai evoluon dhe përshtatet në funksion të zhvillimeve historike, politike dhe ekonomike.

Mjafton të përmendim kohën e pushtimit Osman deri në shpalljen e pavarësisë më 1912 në Shqipëri, ku prioritet në arsimin shqiptar ishte ruajtja e gjuhës shqipe dhe mësimi i shkrimit dhe këndimit.

Kur situata politiko-ekonomike e Shqipërisë filloi të stabilizohej evidentohet dhe prirja e profilizimit të arsimit shqiptar, duke shtuar dhe lëndë të tjera që kishin rëndësi po aq sa gjuha shqipe. Pas Luftës së Dytë Botërore, në 10-vjeçarën e parë në arsimin shqiptar, prioritet ishte lufta kundër analfabetizmit, në vitet e më vonshme deri më 1990, arsimi njohu një zhvillim të gjerë në të gjitha fushat e tij.

Me zhvillimin e arsimit u zhvillua dhe metodologjia e mësimdhënies duke kaluar nga ajo teorike – tradicionale (mësuesi është në qendër të klasës), në të nxëniet ndërveprues (nxënësi është në qendër të klasës).

Pavarësisht evoluimit të tij, në thelb të arsimit ka qenë përgatitja e

individëve të aftë për të ndikuar në zhvillimin social dhe ekonomik të shoqërisë.¹¹Formimi i tij duhet të ishte i qëndrueshëm dhe solid në kohë në mënyrë që t'i përshtatej nevojave të kohës. Kjo mbështet dhe Traktatin e Romës të vitit 1957 mbi aftësimin profesional, i cili u bë fushë e veprimit të komunitetit.

Pavarësisht se cili është objektivi në nivel makro i arsimit shtrohet pyetja: *Sa vend zë koncepti i Zhvillimit të Qëndrueshëm në kurrikulën e arsimit shqiptar? Kur filloi ky Koncept të marrë rëndësinë e duhur në kurrikulat e arsimit shqiptar?*

Takimi i realitetit shqiptar me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm ka ndodhur shumë vonë dhe ka ardhur si nevojë e kohës. Kjo vonesë, e ardhur për shkak të izolimit të gjatë të Shqipërisë gjatë viteve 1945-1990 dhe ndryshimeve sociale dhe ekonomike, evidentuan një sërë problematikash mjedisore, ekonomike dhe sociale. Njëkohësisht u kuptua se problematikat: ndryshimet klimatike, ngrohja globale, efekti serë, shkretimi etj., nuk mund të shihen të izoluara vetëm në Shqipëri, pasi ato janë të shtrira në kohë dhe hapësirë, nuk njohin kufij politikë, sovranitet e shteteve, shtete të pasura apo të varfra. Shqipëria e ndodhur në këto kushte duhet të bëhej pjesë e politikave ndërkombëtare me në fokus konceptin e qëndrueshmërisë si nevojë e kohës.

Në këtë kuadër pas viteve 1990 koncepti i qëndrueshmërisë filloi të përfshihej dhe në kurrikulat shkollore. Fillimisht në mënyrë indirekte, studimet rajonale integronin zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të një rajoni të caktuar, ndryshe nga vitet më të hershme ku këto çështje trajtoheshin të ndara midis konceptit natyror nga konceptit ekonomik dhe social.

Programeve të arsimit parauniversitar iu dedikua një kapitull i veçantë me temë “Mjedisi dhe shoqëria”, por dhe ky kapitull u planifikua në orët e fundit të lëndës gjatë vitit shkollor duke vendosur në pikëpyetje realizimin e gjithë programit shkollor me nxënësit.

Për shkak të ndjeshmërisë që mori çështja mjedisore pas viteve 1990 u bë e mundur të planifikohej një lëndë me zgjedhje me fokus mjedisin “Gjeografia e Problemeve Globale” dhe trajnimi i një kategorie mësuesish

11 Traktati i Lisbonës, 13 Dhjetor 2007.

mbi programin edukativ “Paketa e Gjelbër”¹² në vitin 2006 dhe në vitin 2014 “Paketa e Ajrit”¹³.

Megjithatë duhet të pranojmë se koncepti i qëndrueshmërisë është shndërruar në një çështje të ditës për shkak të rëndësisë që ai mbart, duke u bërë pjesë e kurrikulave shkollore (lëndët e gjeografisë, edukata qytetare, biologjia) në kuadër dhe të integritit ndërlëndor. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm akoma nuk është bërë pjesë e mentalitetit shqiptar

Bibliografia

1. Deklarata e të Drejtave të Njeriut.
2. EMA. 2017. Mbrojtja Konsumatore dhe mbrojtja e mjedisit. FLESH, Tiranë, fq. 18.
3. **H. Romeo. 2010. Politikat Mjedisore. Filara, Tiranë.**
4. <http://airpack.rec.org/index.php?page=rrreth-paketes-se-ajrit>
5. http://documents.rec.org/publications/Green_Pack_AL_MK.pdf
6. https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5839GSDR%202015_SD_concept_definiton_rev.pdf
7. <https://www.giz.de/expertise/downloads/giz2013-alb-seminari-1.pdf>
8. <https://www.youtube.com/watch?v=RPz05ShFm3Q>
9. <https://www.youtube.com/watch?v=weOSCDXdjZM>
10. K. Majlinda. 2015. Filozofia, Shkolla e Lirisë që mundëson Sistemi Arsimor Shqiptar dhe MASH. Punim Doktorat, Tiranë, fq. 27.
11. Këshilli i Ministrave. **VKM Nr. 348, datë 11.5.2016**, botuar në **Fletoren Zyrtare Nr. 86**
12. Konferenca e OKB-së për Mjedisin dhe Zhvillimin në Rio de Zhaneiro. Qershor 1992.
13. Konventa e të Drejtave të Fëmijës, neni 28, 29.
14. Rec. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm.
15. Traktati i Lisbonës. Dhjetor 2007.

Summary

Today's society is becoming more and more a consumer society. Its individualistic tendency to fulfil the economic, social, and cultural life

¹² http://documents.rec.org/publications/Green_Pack_AL_MK.pdf

¹³ <http://airpack.rec.org/index.php?page=rrreth-paketes-se-ajrit>

needs has led it to consider the environment as an inexhaustible asset bringing negative consequences.

In this sense, today's reality is searching sustainable economic, social, environmental, and long-term development. This opportunity is provided by the new, sustainable development model.

How did this concept generate? How do we understand its impact on the social, economic, and environmental development of a country in general and Albania in particular? Which are the factors responsible for education and sustainable development? How much does the Albanian Educational Program occupy in the sustainable development?

These and other questions that will arise during the topic's handling and will be answered through descriptive, analytical, argumentative methodology.

This paper will not be interpretative of the problem, since sustainable development is a simple and complex problem to be implemented in practice.

Keywords: *Sustainable Development, Education for Sustainable Development, Educational Program*

BUXHETET E VOGLA MARKETING NË KUSHTET E BIZNESEVE SHQIPTARE ASPEKTE PËR T’U KONSIDERUAR

Prof. Asoc. Dr. Blerim Kola^a

Dr. Jehona Gjermizi^b

^aUniversiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Fakulteti i Biznesit

Departamenti Financë-Kontabilitet

blekola@yahoo.com

^bKolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Financë-Kontabilitet

Abstrakt

Ndërtimi dhe ekzekutimi i një pakete marketingu për një biznes kërkon mbështetje të plotë financiare, por këtyre kërkesave buxheti i bizneseve nuk mund t’i përgjigjet gjithnjë. Nga ana

tjetër njihet dhe është plotësisht i pranueshëm fakti që marketingu është çelësi i padiskutueshëm i suksesit të një biznesi. Kjo dilemë, mes strategjive marketing dhe burimeve të kufizuara, është objekti i kërkimit në këtë artikull.

Analiza e peshës që duhet të zërë buxheti i marketingut në totalin e buxhetit për kategori të ndryshme biznesesh dhe marrja në konsideratë e të gjithë faktorëve kushtëzues, është pjesa fillestare e këtij artikulli.

Më tej, ky punim synon të sjellë në vëmendje disa nga format më pak të kushtueshme dhe të efektshme të të bërit marketing duke ditur që

kryesisht, për bizneset e vogla dhe te reja, mundësitë financiare janë të vogla dhe as mund të krahasohen me ato të bizneseve të mëdha.

Artikulli propozon ide marketingu që mund të realizohen lehtë, me pak buxhet dhe që mund të sjellim përfitime për kompaninë.

Rrafshi i studimit është mjedisi shqiptar i bizneseve.

Fjalë kyçe: *marketing, biznese shqiptare, ide marketingu*

Hyrje

Statistikat botërore flasin për një rëndësi të madhe që iu kushtohet projekteve të marketingut nga ana e bizneseve duke ditur përfitimet që ato sjellin në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e tyre në treg. Strategjitë e marketingut janë pjesë e punës së çdo biznesi pavarësisht madhësisë apo qëllimit që ai ka. Format e të marketuarit janë subjekt i evoluimit të vazhdueshëm në përputhje edhe me zhvillimet e vrullshme teknologjike. Megjithatë studimet tregojnë se 80-90% e bizneseve të reja dështojnë me projektet e tyre të marketingut, kryesisht për shkak të keqmenaxhimit të tyre.

Nga ana tjetër, menaxhimi i marketingut në një biznesi kërkon një buxhet të konsiderueshëm i cili zë një pjesë të madhe në buxhetin e përgjithshëm. Në këtë mënyrë gjetja e formës apo hartimi dhe zbatimi i strategjive më të mira duke pasur në vëmendje edhe minimizimin e kostove që implikojnë, është çelës suksesi për një biznes.

Ky artikull hedh dritë mbi mekanizmat e marketingut që rezultojnë me kosto më të ulët të cilat mund të jenë të përshtatshme edhe për bizneset në Shqipëri duke marrë parasysh se 99.9%¹ e bizneseve që operojnë në vendin tonë janë të vogla dhe të mesme. Nga ana tjetër, 77.6% e shitjeve neto realizohen nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat karakterizohen nga një buxhet i limituar.

Analiza teorike e faktorëve në përzgjedhjen e strategjisë së marketingut

Përcaktimi i buxhetit të marketingut është një çështje shumë e rëndësishme e cila lidhet shumë ngushtë me suksesin apo dështimin e planit të marketingut. Madhësia e një buxheti marketingu mund të përcaktohet nga

¹ http://www.instat.gov.al/media/379131/rezultatet_e_sme_nga_asn_2015.pdf

disa faktorë, si p.sh.:

- Në varësi të objektivave të marketingut apo strategjive të hartuara;
- Në përputhje me mesataren e tregut apo të konkurrentëve (p.sh. si përqindje e të ardhurave);
- E përshtatur me ndryshimet sipas programit të marketingut të këtij viti, etj., bazuar në vitin e kaluar.

Literatura njih disa metoda në përcaktimin e peshës së marketingut në buxhetin e përgjithshëm të cilat kanë rezultuar efektive:

Shuma që mbetet: Pasi të keni llogaritur marzhin bruto si dhe të keni përcaktuar fitimin e nevojshëm neto, ajo që mbetet pasi të keni zbritur të gjitha kostot dhe shpenzimet e tjera i takojnë buxhetit të marketingut dhe komunikimit. Kjo metodë nuk është shumë praktike, por është çfarë bëjnë shumica e kompanive shqiptare të cilat e shohin marketingun thjesht si shpenzim.

Përqindja e shitjeve: Buxheti i marketingut përcaktohet si një përqindje fikse (p.sh. 5%) e totalit të shitjeve. Por problemi me këtë mënyrë përcaktimi shfaqet kur niveli i shitjeve është në rënie, çka rrjedhimisht sjell edhe uljen e shpenzimeve të marketingut, kur në realitet mund të këtë nevojë që shpenzimet e marketingut të rriten. Kjo mënyrë mund të jetë e vlefshme, dhe relativisht e lehtë në përdorim, në rastet kur duhet të përcaktohet një buxhet i vogël për një produkt apo fushatë të caktuar. Në këto raste, përqindja e buxhetit për marketingun llogaritet me përafërsi bazuar mbi totalin e shitjeve që synohen. Pra, nëse ju synoni të shisni produkte me vlerë totale 100 lekë, atëherë 5 lekë i bie të shpenzohen që në fillim për marketingun (nëse buxheti për këtë fushatë marketingu është thjesht 5%).

Objektivi dhe detyrat: Kjo nënkupton pasjen e objektivave specifike dhe realizimin e detyrave të qarta të cilat duhet të përmbushen për të arritur objektivat. Kjo metodë lidhet disi me shembullin e dhënë pak më sipër, ku arritja e objektivit të shitjeve me total 100 lekë, përcakton si detyrë shpenzimin në vlerën 5 lekë (ose 5%) për marketingun.

Norma e konkurrencës: Shpenzimet bazohen mbi ato të konkurrencës gjatë vitit të kaluar apo atij që vjen, pra, krahasohen me shpenzimet e konkurrencës. Kjo është një praktikë e ndjekur nga të gjitha industritë dhe sektorët kryesorë. Kjo metodë përdoret shpesh në situata konkurrence,

por edhe si argument për të rritur buxhetin e marketingut të një korporate. Por buxheti i marketingut duhet të vlerësohet në radhë të parë bazuar mbi strategjinë që do ndiqet dhe efikasitetin që ka pasur.

Vijimi i modifikuar (ose buxheti i vjetshëm plus minus diçka): Kompanitë i mbështesin buxhetet mbi shpenzimet e vjetshme. Nëse buxheti i vitit të kaluar ishte i ulët atëherë konsiderohet rritja e tij për vitin në vazhdim. Kjo metodë është relativisht më e thjeshtë për t'u mbrojtur përpara drejtimit të kompanisë, kur bëhet vlerësimi vjetor i buxheteve të njësive brenda një kompanie, por edhe nëpër ato më të vogla, kjo metodë nënkupton më pak kokëçarje në përgatitjen e buxhetit, por jo domosdoshmërisht më efikasitet!

Norma e industrisë: Kompania përcakton një shifër apo përqindje të shitjeve që është tipike për industrinë në të cilën operon. Kjo metodë shërben si bazë për një industri të mirë-stabilizuar por jo gjithnjë vlen për ato industri apo sektorë biznesi ku ka shumë konkurrencë ndërmjet kompanive.

Statistika botërore të peshës së buxhetit të marketingut ndaj totalit të buxhetit

Cilët lloje biznesesh shpenzojnë më shumë në marketing?

Shumë studime kanë tentuar të vlerësojnë përdorimin e marketingut duke analizuar të dhëna mbi peshën e buxhetit të marketingut ndaj totalit të buxhetit. Në vijim kemi sjellë disa nga statistikat botërore të marra nga faqe të specializuara për të tilla studime:

Tabela e mësipërme na njeh me rezultatet e studimeve në lidhje me përdorimin e marketingut

	Biznes-Biznes Produkt	Biznes-Biznes Shërbim	Biznes-Konsumator Produkt	Biznes-Konsumator Shërbim
Përqindja e ndryshimeve të buxhetit në 12 muajt e ardhshëm	5.4 %	6.4%	7.1%	5.8%
Shpenzimet e marketingut si përqindje e buxheteve të firmave	10.4%	8.7%	14.9%	11.4%
Shpenzimet e marketingut si përqindje e të ardhurave të	8.1%	5.8%	15.2%	11.0%

Tabela 1: Shpenzimet e marketingut sipas sektorëve të ekonomisë - Burimi: CMO Survey

duke vlerësuar tre tregues:

- *Përqindja e ndryshimit të buxhetit të marketingut në 12 muajt e ardhshëm;*
- *Shpenzimet e marketingut si përqindje e buxhetit të marketingut;*
- *Shpenzimet e marketingut si përqindje e të ardhurave të firmës.*

Studimi merr në konsideratë 4 lloje biznesesh, siç vërehet edhe në tabelën e mësipërme. Nga të dhënat që shohim, vërejmë se kompanitë që ofrojnë produkte për konsumatorë kanë buxhetin më të madh të marketingut (si përqindje ndaj buxhetit total dhe të ardhurave) dhe përqindjen më të lartë të rritjes së buxhetit të marketingut. Pritshmëritë janë që bizneset që ofrojnë shërbime, të kenë shpenzimet më të mëdha të marketingut, por siç duket nga të dhënat bizneset që ofrojnë produkte për konsumatorët janë ato që kanë rritur pjesën e buxhetit për marketingun.

Për çfarë shpenzojnë marketerët më shumë?

Studimet tregojnë për 4 forma më të aplikuara të marketingut:

- Marketingu digjital;
- Marketingu përmes telefonit;
- Marketingu përmes mediave sociale;
- Marketingu analitik.

Sipas statistikave, përdorimi i marketingut digjital pritet të rritet me 14,7% vitin tjetër krahasuar me një rritje negative prej 1.1% për marketingun tradicional (jashtë uebit). Së dyti, shpenzimet në marketingun përmes telefonit pritet të trefishohen nga 3.2% në 9% të buxhetit në tre vitet e ardhshme. Së treti, marketingu përmes mediave sociale pritet të rritet me 126% në 5 vitet e ardhshme, nga 9.9 % e buxhetit aktual në 22.4%. Së fundmi, marketerët do të shpenzojnë më shumë në marketingun analitik, i cili zë aktualisht 6.4% të buxhetit të marketingut. Kjo formë pritet të rritet me 83% duke zënë 11.7% në 3 vitet e ardhshme.²

Marrëdhënia ndërmjet madhësisë së kompanisë dhe buxhetit marketing Ashtu siç tregohet në tabelën në vijim, fillimisht rritja e nivelit të të ardhurave në një biznes shoqërohet me rënien e buxheteve të marketingut, por më

² Strong Economic Outlook Spurs Marketing Spending.

pas vërehet një rritje. Gjithashtu vërehet se bizneset e vogla kanë një rritje më të madhe të peshës së buxhetit të marketingut krahasuar me bizneset e mëdha.

Statistika të buxheteve marketing nga bizneset shqiptare

Bazuar në studime të ndryshme të realizuara nga kërkues të ndryshëm,

	< \$25 milion	\$26-99 milion	\$100-499 milion	\$500 -999 milion	\$1-9.9 bilion	>\$10 bilion
Përqindja e ndryshimeve të buxhetit në 12 muajt e ardhshëm	10.5%	6.5%	5.2%	-2.3%	6.4%	2.3%
Shpenzimet e marketingut si përqindje e buxheteve të firmave	12.7%	12.6%	6.5%	6.6%	9.7%	7.8%
Shpenzimet e marketingut si përqindje e të ardhurave të firmave	13.9%	6.1%	5.9%	2.9%	6.7%	5.5%


Tabela 2: Shpenzimet e marketingut sipas të ardhurave të kompanive

bizneset shqiptare karakterizohen nga buxhete të limituara marketingu. Kjo kryesisht vjen nga disa arsye, si më poshtë:

- Mungesë fondesh financiare;
- Mungesë të strategjive afatgjata të biznesit;
- Mungesë të besueshmërisë në formatet e marketingut;
- Mungesë të profesionalizmit në fushën e marketingut;
- Mungesë departamenti marketingu;
- etj.

Nga ana tjetër, edhe kur bizneset aplikojnë metoda marketingu, ata nuk kanë një strategji të qartë apo të duhur marketingu. Referuar metodave marketingu të aplikuara, vërehet që metodat me pak të kushtueshme janë edhe më të preferuarat nga bizneset në kushtet e buxheteve të kufizuara.

Nëse ne i referohemi grafikut të mëposhtëm, i cili prezanton rezultatet e një studimi realizuar nga Business Challenge, vërehet se pjesa më e madhe e buxheteve të marketingut shkon për marketingun digjital, gjë e cila mund të interpretohet si një zhvillim progresiv dhe si një adaptim i shpejtë i formave moderne të marketingut. Por, në të njëjtën kohë kjo tregon që bizneset shqiptare kanë dhe operojnë me buxhete modeste për marketing.



Konkluzione dhe rekomandime

Ashtu siç botërisht pranohet, zemra e një biznesi të suksesshëm, është marketingu. Kështu që është shumë e rëndësishme që bizneset shqiptare ta kuptojnë këtë dhe të rrisin ndërgjegjësimin për përfitimet e mëdha nga marketingu profesional.

Sipas vëzhgimeve tona, bizneset shqiptare duhet të zgjerojnë buxhetet e tyre të marketingut dhe duhet të përmirësojnë strategjitë e tyre.

Pasja apo krijimi i një buxheti më të zgjeruar marketingu nga bizneset, do të mundësojë aplikimin e zgjeruar dhe të koordinuar të formave moderne dhe atyre tradicionale. Gjithashtu buxhete më të mëdha marketingu nënkuptojnë që bizneset mund të ndërmarrin edhe kërkime të thelluara marketingu të cilat do të pasurojnë me informacione të dobishme bizneset dhe do të bëjnë që vendimet që ata marrin të jenë më të drejtat. Por jo gjithmonë efektiviteti i marketingut lidhet apo i atribuohet madhësisë së buxhetit. Efektiviteti i marketingut lidhet ngushtë me disa çështje të rëndësishme, si:

- Pasja e një strategjie me objektiva reale;
- Realizimi i marketingut të integruar;
- Marrja në konsideratë e konkurrentëve dhe e buxheteve të tyre;
- Vlerësim i efektivitetit të secilës formë marketing.

Bibliografia

1. Barritt, Ch. & Alderman, F. Lee. 2004. Creating a Reusable Learning Objects Strategy. San Francisco, USA: Pfeiffer, etc.
2. Berlin: Spinger. Melvin, A. 2012. Decision-Making using the Analytic Hierarchy Process (AHP) and SAS/IML. SESUG.
3. Drucker, P. 2008. The Practice of Management, Harper & Row, New York, 1954, 12. Drummond Graeme, Ensor John dhe Ashford Ruth.
4. <https://www.forbes.com/sites/christinemoorman/2014/03/05/who-has-the-biggest-marketing-budgets/#9b71e3dc6a24>
5. Inc.: How to Build Your Marketing Budget.
6. Maier, G. 2001. History, spatial structure, and regional growth: lessons for poicy making growth.
7. Strategic marketing, Planning and Control, 3rd ed. Burlington MA, USA
8. U.S. Small Business Administration: Developing a Marketing Budget for Your Small Business - Going Beyond the Spreadsheet.

Summary

Analysis of the weight that should be given to marketing budget in the total budget for different categories of business and taking into consideration of all the conditioning factor is the preamble to this article.

Development and execution of a marketing business plan requires financial support and not always budget businesses can respond. On the other hand it is fully recognized and acceptable fact that marketing is the undisputed key business success. This dilemma between marketing strategies and limited financial resources is the research goal of this article. The article proposes marketing ideas that can be implemented easily, with low budget and can bring benefits to the company. This article sheds light on marketing mechanisms that result in lower costs which can be adapted for businesses in Albania knowing that 99.9% of businesses operating in our country are small and medium enterprises. On the other hand the marketing management of a business requires a substantial budget which occupies a large part in the overall budget. In this way, finding the shape or design and implementation of best marketing strategies taking into consideration the minimization of costs that implicate, it is the key to success for a business.

PROSPEKTIVAT E REVOLUCIONIT DIGJITAL: NGA TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT TEK MAKINAT INTELIGJENTE

M.Sc. Elvis Xhori ^a

Ph.D. Guxim Kola ^b

^a Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Financë-Kontabilitet

elvisxhori@gmail.com

^b Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Menaxhim-Turizëm

kolaguxim@gmail.com

Abstrakt

Ekonomia neolibérale ka arritur në një pikë kritike. Si rezultat, ndarja tradicionale politike e majtë dhe e djathtë, është duke u përsëritur si ndarje midis atyre formave të zhvillimit që janë më pak të prirura drejt mundësive dhe përqendrimit ekstrem të pasurisë që kërkojnë t’i japin fund një përqendrimi të tillë duke mbyllur tregjet dhe shoqëritë e hapura. Që nga koha e Revolucionit Agrar, përparimi teknologjik gjithmonë ka nxitur forcat kundërshtare të përhapjes dhe përqendrimit. Përhapja ndodh kur fuqitë e vjetra dhe privilegjet prishen, ndërsa përqendrimi ndodh atëherë kur fuqia dhe shtrirja e atyre që kontrollojnë aftësitë e reja, zgjerohet.

I ashtuquajturi Revolucioni i Katërt Industrial nuk do të bëjë përjashtim në këtë drejtim.

Revolucioni i Katërt Industrial që po zhvillohet mund të komprometojë

burimet tradicionale të njerëzimit që nënkuptojnë - punën, komunitetin, familjen dhe identitetin - ose mund ta tërheqë njerëzimin drejt një ndërgjegje të re kolektive dhe morale të bazuar në një ndjenjë të përbashkët të fatit, rezultati i të cilit shfaqet deri tek ne. Revolucioni i Katërt Industrial mbështetet në Revolucionin e Tretë Industrial, i njohur edhe si Revolucioni Dixhital, i cili përfshin përhapjen e kompjuterëve dhe automatizimin e ruajtjes së regjistrimeve. Megjithatë, vala e re e transformimit ndryshon nga revolucionet paraardhëse në disa pika kyçe: a) së pari, rriset mund të zhvillohen dhe shpërndahen më shpejt se kurrë; b) së dyti, ulja e kostove marxhinale të prodhimit dhe rritja e platformave që agregojnë dhe përqendrojnë veprimtarinë në sektorë të shumëfishte, rrisin kthimet në të njëjtën klasë; dhe c) së treti, ky revolucion global do të përshtatet në të gjitha vendet dhe do të ketë një ndikim në nivel sistemesh në shumë fusha të veprimtarisë. Për sa i përket kësaj çështje, ne synojmë të japim përgjigje duke iu referuar disa analizave ekonomike.

A është e mundur që ekonomia neoliberales të jetë tashmë fundi i një fillimi? Le të përpiqemi të kuptojmë perspektivën e ardhshme të këtij sistemi në marrëdhëniet ekonomike globale në përputhje me mendimet e ekonomistëve të ndryshëm amerikanë dhe botërorë. Gjithashtu, ato do të na njohin me disa nga debatet kryesore për Liberalizmin Ekonomik dhe efektet e tij në ekonominë globale.

Fjalët kyçe: Liberalizimi, Kapitalizmi, Proteksionizmi, Globalizimi

Prezantimi

Revolucioni i Katërt Industrial ka potencialin të fuqizojë individët dhe komunitetet, pasi krijon mundësi të reja për zhvillimin ekonomik, social dhe personal. Por kjo gjithashtu mund të çojë në marginalizimin e disa grupeve të caktuara, në rritjen e pabarazisë dhe krijimin e rreziqeve të reja për sigurinë dhe shkatërrimin e marrëdhënieve njerëzore.

Nëse duam të shfrytëzojmë mundësitë dhe të shmangim kurthet e Revolucionit të Katërt Industrial, duhet të shqyrtojmë me kujdes pikëpyetjet që ngrihen për të. Ne duhet të rishikojmë idetë tona rreth zhvillimit ekonomik dhe social, krijimit të vlerave, privatësisë dhe pronësisë, madje edhe identitetit

personal. Duhet të trajtojmë, individualisht dhe kolektivisht, çështjet morale dhe etike të ngritura nga hulumtimet e fundit në inteligjencën artificiale dhe bioteknologji, të cilat do të mundësojnë rritje të jetëgjatësisë, krijim laboratorik të embrioneve/foshnjave dhe ruajtje të kujtesës, si dhe duhet t'u përshtatemi qasjeve të reja për të ruajtur kontaktet me njerëzit dhe për të ushqyer marrëdhëniet me ta.

Sfida e ndryshimeve nuk duhet të nënvlerësohet. Revolucioni i Katërt Industrial mund të çojë në forma të zhvillimit njerëzor që ngrenë pikëpyetje mbi vetë natyrën e ekzistencës njerëzore - madje edhe më shpejt sesa mund të imagjinohet.

Le të marrim në konsideratë ndikimin që teknologjia celulare ka krijuar tashmë në jetën dhe marrëdhëniet tona. Risitë e teknologjisë bëhen të domosdoshme - dhe, më vonë, nga nevoja për teknologji, teknologjia bëhet e pjesë e pandashme. Por a do të na privojë kjo nga mundësia për të ndaluar, reflektuar dhe angazhuar në biseda domethënëse dhe substanciale? Si do të ndryshojë bota jonë e brendshme dhe lidhjet me ata rreth nesh? Këto janë pyetje të rëndësishme, për të cilat debati ndoshta do të intensifikohet në vitet e ardhshme.

Natyrisht, teknologjia nuk është një forcë e jashtme mbi të cilën njerëzit nuk kanë kontroll. Nuk jemi të detyruar të kufizohemi nga një vijë ndarëse midis zgjedhjes së pranimi ose refuzimit të teknologjisë. Përkundrazi, vendimet që marrim çdo ditë si qytetarë, konsumatorë dhe investitorë, drejtojnë përparimin teknologjik. Sa më shumë që mendojmë për këto vendime, sa më shumë njohim veten dhe modelet shoqërore në të cilat ne mbështetemi dhe aq më të mëdha janë shanset tona për ta bërë këtë revolucion duke përmbushur objektivat e përbashkëta dhe duke ruajtur vlerat tona.

Ndikim thelbësor në këtë përpjekje do të kenë format e reja të bashkëpunimit dhe qeverisjes, të shoqëruara nga treguesit pozitiv të përbashkët. Për të arritur këtë përfundim, nevojiten tre hapa kyç: a) së pari, duhet të rrisim ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit të çështjeve në fjalë - procesi i vendimmarrjes nuk mund të jetë i mbyllur. Ne kemi nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse që bashkon "mendjet e mëdha" nga e gjithë bota, duke përfshirë sektorët publikë dhe privatë paralelisht; b) së dyti, duhet të zhvillojmë debate gjithëpërfshirëse dhe konstruktive rreth faktit se si duhet

të zhvillohet Revolucioni i Katërt Industrial. Ne duhet të sigurohemi se vlerat dhe etika janë në qendër të sjelljeve tona individuale dhe kolektive, duke i përfshirë ato në tregjet financiare dhe kapitale. Nëpërmjet tolerancës dhe respektit duhet të shkojmë drejt ndjenjave të kujdesit të vërtetë dhe dhembshurisë, duke fuqizuar kështu parimet që drejtojnë veprimtarinë tonë; dhe c) së treti, duhet të ndërmarrim hapa për të ristrukturuar sistemet tona ekonomike, sociale dhe politike. Është e qartë se strukturat tona aktuale të qeverisjes dhe modelet dominuese të krijimit të të mirave materiale nuk janë të përshtatshme për të përmbushur nevojat kryesore të së tashmes dhe të së ardhmes. Ajo që nevojitet tani nuk janë përmirësimet në shkallë të vogël apo reforma margjinale, por transformim sistematik dhe gjithëpërfshirës.

Por si do të perceptohet progresi i Revolucionit të Katërt Industrial tek njerëzit, kultura dhe vlerat? Teknologjitë e reja, sado të mrekullueshme që mund të duken, janë në thelb vetëm mjete të krijuara nga njerëzit për njerëzit. Ky fakt duhet marrë parasysh këtë dhe duhet të sigurohemi që inovacioni dhe teknologjia të vazhdojnë të vënë në plan të parë njeriun, duke na nxitur drejt

një zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Pasi të arrijmë këtë, mund të shkojmë edhe më tej... Moshë e re e teknologjisë, n.q.s. formohet me përgjegjshmëri, mund të nxisë një rilindje të re kulturore që do të krijonte ndjesinë se ne jemi pjesë e diçkaje shumë më të madhe se vetvetja - pra qytetërimin e vërtetë global.

Revolucioni i Katërt Industrial mund të komprometojë burimet tradicionale të perceptimit mbi - punën, bashkësinë, familjen dhe identitetin- ose mund ta tërheqë njerëzimin drejt një ndërgjegjeje të re kolektive dhe morale të bazuar në një ndjenjë të përbashkët të fatit. Zgjedhja është e jona!

Një revolucion makroekonomik?

Që prej fillimit të krizës financiare globale një dekadë më parë, nuk ka pasur mungesë të ideve të dobishme për përmirësimin e kushteve ekonomike dhe zbutjen e pakënaqësisë publike. Pyetja e vërtetë është, pse kaq pak prej tyre janë zbatuar?

Përvjetori i dhjetë i krizës globale financiare, filloi më 9 gusht 2007, kur Banka Kombëtare e Parisit njoftoi se vlera e disa fondeve të saj, duke përfshirë dhe ato që supozohej se ishin barrët hipotekare me të sigurta të mundshme

të SHBA, u zhdukën. Nga ajo ditë fatkeqe, bota e përparuar kapitaliste ka përjetuar periudhën më të gjatë të ngërçit ekonomik që prej dekadës së nisur me rrëzimin e Wall Street në 1929 dhe të përfunduar me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore dhjetë vjet më vonë.

Me pyetën dikur n.q.s. mund të ishte bërë diçka për të shmangur “dekadën e humbur” të pasivitetit ekonomik që nga periudha e krizës. Në një sesion të titulluar “A kemi mbetur ne jashtë politikave ekonomike?”, bashkë-panelistët e mi shpjeguan se nuk kemi mbetur jashtë tyre. Ata ofruan shumë shembuj të politikave që mund të kishin sjellë përmirësime në rritjen e prodhimit, punësimit, stabilitetit financiar dhe shpërndarjes së të ardhurave.

Kjo më lejoi të drejtojë pyetjen që konsideroj si më interesante: “Duke pasur parasysh larmishmërinë e ideve të dobishme, përse kemi pasur kaq pak politika që mund të përmirësonin kushtet ekonomike dhe të zbusnin pakënaqësisë publike të implementuara që nga periudha e krizës?”

Pengesa e parë ka qenë ideologjia e fundamentalizmit të tregut. Që në fillim të viteve 1980, politika është dominuar nga dogma që tregjet janë gjithmonë të drejta dhe ndërhyrja ekonomike e qeverisë është pothuajse gjithmonë e gabuar. Kjo doktrinë u zhvillua me kundër-revolucionin monetar ndaj ekonomisë keynesiane që erdhi si pasojë e krizës së inflacionit të viteve 1970. Ajo frymëzoi revolucionin politik Thatcher-Reagan, i cili nga ana e tij ndihmoi në nxitjen e një bume ekonomik 25-vjeçar që nga viti 1982 e vijim.

Por fundamentalizmi i tregut gjithashtu frymëzoi teza intelektuale të rrezikshme, si: tregjet financiare janë gjithmonë racionale dhe efikase; bankat qendrore duhet thjesht të synojnë inflacionin dhe nuk duhet të merren me stabilitetin financiar dhe papunësinë; i vetmi rol legjitim i politikës fiskale është të balancojë buxhetet, jo të stabilizojë rritjen ekonomike. Edhe pse ekonomia fundamentaliste e tregut pas vitit 2007 u fry me këto ide false, politikat fundamentaliste të tregut mbijetuan, duke parashtruar politikat e duhura në përgjigje të krizës.

Kjo nuk duhet të konsiderohet e habitshme. Fundamentalizmi i tregut nuk ishte thjesht një trend intelektual. Interesa të fuqishme politike motivuan revolucionin e të menduarit ekonomik të viteve '70. Dëshmitë e supozuara shkencore sipas të cilave ndërhyrja ekonomike e qeverisë është pothuajse gjithmonë kundër-produktive legjitimuan një zhvendosje të

madhe në shpërndarjen e pasurisë, nga punëtorët industrialë tek pronarët dhe menaxherët e kapitalit financiar dhe pushtetit; nga puna e organizuar në interesat e biznesit. Ekonomisti polak Michal Kalecki, bashkë-shpikësi i teorisë ekonomike Keynesian-e, e parashikoi këtë ndryshim ideologjik të motivuar politikisht me saktësi të çuditshme në vitin 1943.

Supozimi se nëse qeveria në ekonominë kapitaliste di çfarë bën dhe si rrjedhojë duhet të sigurojë punësim të plotë, është i gabuar. Nën regjimin e një punësimi të plotë të përhershëm, “largimet nga puna” do të humbnin rolin e tyre si një masë disiplinore, e lidhur me ndikimin qeveritar parazgjedhor. Klasa punëtore do të dilte jashtë kontrollit dhe drejtuesit e industrisë do të ishin të shqetësuar “për t’iu dhënë atyre një mësim”. Një bllok i fuqishëm ka të ngjarë të formohet kështu ndërmjet bizneseve të mëdha dhe interesave rentiere dhe ata ndoshta do të gjejnë më shumë se një ekonomist që do të deklarojë se situata është qartazi e paqëndrueshme.

Milton Friedman ishte ekonomisti i cili deklaroi se politikat e qeverisë për të siguruar punësimin të plotë, ishin “qartazi të pasuksesshme”. Revolucioni i tregut-fundamentalist që ai udhëhoqi kundër ekonomisë Keynesian-e zgjati 30 vjet. Por, ashtu sikurse keynesianizmi u diskreditua nga krizat e inflacionit të viteve 1970, fundamentalizmi i tregut iu nënshtrua kontradiktave të veta të brendshme në krizën e deflacionit të vitit 2007.

Një kontradiktë specifike e fundamentalizmit të tregut sugjeron një arsye tjetër për “ngërçin” e të ardhurave dhe rritjen së fundmi të ndjenjave populiste. Ekonomistët besojnë se politikat që rrisin të ardhurat kombëtare, siç janë tregtia e lirë dhe de-rregullimi, janë gjithnjë të dobishme për shoqërinë, pavarësisht mënyrës së shpërndarjes së të ardhurave më të larta. Ky besim bazohet në parimin e ashtuquajtur “Pareto optimality” që supozon se njerëzit që përfitojnë të ardhura më të larta gjithmonë mund të kompensojnë humbjet. Gjithsesi, çdo politikë që rrit të ardhurat agregate duhet të shihet si një e mirë për shoqërinë, sepse mund t’i bëjë disa njerëz më të pasur pa lënë askënd në situatë më të keqe.

Por, sikur kompensimi i arritur nga ekonomistët në teori të mos ndodhi në praktikë? Po në qoftë se politikat e tregut-fundamentalist ndalojnë në mënyrë specifike rishpërndarjen e të ardhurave ose subvencioneve rajonale, industriale dhe arsimore të cilat mund të kompensojnë ata që vuajnë nga

“tregtia e lirë” dhe “fleksibiliteti” i tregut të punës? Në këtë rast, optimaliteti Paretit nuk është aspak i përshtatshëm për shoqërinë në fakt. Në vend të kësaj, politikat që rrisin konkurrencën, qoftë në tregti, në tregjet e punës apo në prodhimin vendas, mund të jenë shoqërisht të dëmshme dhe politikisht të vrullshme.

Kjo nxjerr në pah një tjetër arsye për dështimin e politikave ekonomike që nga viti 2007. Teoria dominuese e mosndërrhyrjes së qeverisë rrit natyrshëm rezistencën për ndryshim midis humbësve nga globalizimi dhe teknologjia, dhe krijojnë probleme të mëdha në vazhdimësinë e reformave ekonomike. Për të pasur sukses, politikat monetare, fiskale dhe strukturore duhet të zbatohen së bashku, sipas një rendi të përforcuar logjik të përbashkët. Por nëse fundamentalizmi i tregut bllokon politikat makroekonomike ekspansioniste dhe pengon rishpërndarjen e taksave ose shpenzimeve publike, atëherë do të kemi rritje të rezistencës popullore ndaj tregtisë, liberalizimit të tregut të punës dhe reformave të pensioneve. Në të kundërt, nëse opozita popullore i bën reformat strukturore të pamundura, ky fakt inkurajon rezistencën e konservatorëve ndaj shpërndarjes makroekonomike.

Supozojmë nga ana tjetër, se ekonomia “progresive” e punësimit të plotë dhe rishpërndarjes mund të kombinohet me ekonominë “konservatore” të tregtisë së lirë dhe liberalizimit të tregut të punës. Në këtë mënyrë të dyja politikat makroekonomike ashtu edhe ato strukturore do të shpjegoheshin politikisht me thjeshtë dhe do të rriteshin gjasat për të pasur sukses.

A mund të ndodhë kjo në Evropë? Presidenti i ri i Francës, Emmanuel Macron, e bazoi fushatën e tij zgjedhore në një sintezë të reformave “të krahut të djathtë të punës” dhe lehtësimin e kushteve fiskale dhe monetare të “krahut të majtë të punës” - idetë e tij po fitojnë mbështetje në Gjermani dhe në mesin e politikbërësve të Bashkimit Evropian. Nëse “Macronomia” - përpjekja për të kombinuar politikat strukturore konservatore me politikat makroekonomike progresive - do të ketë sukses në zëvendësimin e fundamentalizmit të tregut që dështoi në vitin 2007, dekada e humbur e “ngërçit” ekonomik së shpejti do të mbarojë - të paktën për Evropën.

Konkluzione

Revolucioni i Katërt Industrial po ndryshon mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe komunikojmë.

Ai është duke riformësuar qeverisjen, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe tregtinë - pra pothuajse çdo aspekt të jetës.

Në të ardhmen, ai gjithashtu mund të ndryshojë përmbajtjen dhe mënyrën tonë të vlerësimit. Ky revolucion mund të ndryshojë marrëdhëniet tona, mundësitë tona dhe identitetet tona duke ndryshuar botën fizike dhe virtuale ku banojmë dhe madje, në disa raste edhe trupat tanë.

Teknologjitë e reja mund të jenë agentë të fuqishëm në të mirë të shoqërisë. Edukimi dhe akses në informacion mund të përmirësojë jetën e miliarda njerëzve. Nëpërmjet pajisjeve dhe rrjeteve gjithnjë e më të fuqishme kompjuterike, shërbimeve dixhitale dhe pajisjeve celulare, këto arritje mund të bëhen realitet për njerëzit në mbarë botën, përfshirë edhe ata në vendet e pazhvilluara.

Revolucioni i mediave sociale i mishëruar nëpërmjet Facebook, Twitter dhe Tencent i ka dhënë të gjithëve një zë dhe një mënyrë për të komunikuar menjëherë në të gjithë planetin. Sot, më shumë se 30% e njerëzve në botë përdorin shërbimet e mediave sociale për të komunikuar dhe për të qëndruar në kontakt të drejtpërdrejtë me ngjarjet botërore. Këto risi mund të krijojnë një fshat të vërtetë global, duke sjellë miliarda njerëz më shumë në ekonominë globale. Ato mund t'u krijojnë akses në produkte dhe shërbime për tregje krejtësisht të reja. Ata mund t'u japin njerëzve mundësi të mësojnë mënyra të reja fitimi duke i dhënë kështu identitete të reja në sajë të potencialeve personale që më parë nuk i njihnin.

Revolucioni i Katërt Industrial, më në fund, do të ndryshojë jo vetëm atë që ne bëjmë, por edhe atë që jemi. Ai do të ndikojë në identitetin tonë dhe në të gjitha çështjet që lidhen me të: në ndjenjën tonë të privatësisë, në nocionet tona të pronësisë, në modelet tona të konsumit, në kohën që i kushtojmë punës dhe kohën e lirë, dhe mënyrën se si zhvillojmë karrierën, si kultivojmë aftësitë tona, si njohim njerëz dhe si zhvillojmë marrëdhëniet njerëzore.

Blerjet në internet dhe shërbimi i shpërndarjes - duke përfshirë edhe dronin tashmë janë duke ripërcaktuar lehtësinë dhe përvojën e shitjes me pakicë. Lehtësia e shpërndarjes mund të transformojë komunitetet, edhe ato

në vende të largëta, dhe t'i japë hov ekonomive të zonave të vogla ose rurale.

Në fushën fizike, përparimet në shkencat bio-mjekësore mund të çojnë në një jetë më të shëndetshme dhe në jetëgjatësi më të madhe. Ato mund të drejtohen në risitë në fushën e neurologjisë, si lidhja e trurit të njeriut me kompjuterë për të rritur inteligjencën ose përvojën e një bote të simuluar.

Imagjinoni gjithë fuqinë e robotit e bashkuar me aftësitë e zgjidhjes së problemeve njerëzore.

Përparimet në sigurinë e automjeteve nëpërmjet teknologjive të Revolucionit të Katërt Industrial mund të zvogëlojnë fatkeqësitë në rrugë, të ulin kostot e sigurimit, si dhe nivelin e emetimit të karbonit. Mjetet e pavarura të transportit mund të riformësojnë hapësirën e jetueshme të qyteteve, arkitekturën dhe rrugët në vetvete, dhe të lirojnë apo zgjerojnë hapësirën sociale dhe humane.

Teknologjia digjitale çliron punëtorët nga komandat që tashmë janë automatike, duke iu dhënë më shumë liri dhe pavarësi për t'u përqendruar në çështjet më komplekse të biznesit. Ajo gjithashtu i pajis punëtorët me mjete dhe njohuri tërësisht të reja në mënyrë që të projektojnë zgjidhje më kreative për problemet e pakapërcyeshme të së shkuarës.

Megjithatë, ndërsa vlerësojmë se Revolucioni i Katërt Industrial ka fuqinë për të ndryshuar botën pozitivisht, duhet të jemi të vetëdijshëm se teknologjitë mund të kenë rezultate negative nëse nuk marrim parasysh ndikimet e këtyre ndryshimeve mbi ne.

Ne ndërtojmë atë që vlerësojmë. Kjo do të thotë që ne duhet të kujtojmë vlerat tona, ndërsa po i ndërtojmë me këto teknologji të reja. Për shembull, nëse i vlerësojmë paratë me tepër se kohën kushtuar familjes, mund të ndërtojmë teknologji që na ndihmon të fitojmë para duke shpenzuar nga koha e familjes. Në të kundërt, këto teknologji mund të krijojnë stimuj që e bëjnë më të vështirë ndryshimin e kësaj vlere themelore.

Njerëzit kanë një marrëdhënie të ngushtë me teknologjitë. Teknologjitë janë ashtu si ne i krijojmë në botën tonë dhe prandaj duhet t'i zhvillojmë ato me kujdes. Më shumë se kurrë, është e rëndësishme që të fillojmë në rrugën e drejtë. Ne duhet ta fitojmë këtë garë midis fuqisë në rritje të teknologjisë dhe rritjes së vizionit me të cilin duhet ta menaxhojmë atë. Nuk kemi pse të mësojmë nga gabimet Bio-teknologjia mund të çojë në arritje të debatueshme

siç janë krijimi i embrioneve, transformim të gjeneve (duke ndryshuar tiparet e trashëguara të një lloji tjetër), ose transformimet e nevojshme për t'u bërë kandidatë konkurrues për shkollat ose pozicionet e punës.

Inovacionet në robotikë dhe automatizim mund të çojnë në humbjen e punëve ose së paku në punë që janë shumë të ndryshme dhe kërkojnë aftësi të veçanta. Inteligjenca artificiale, robotika, bio-inxhinieria, mjetet e programimit dhe teknologjitë e tjera mund të përdoren të gjitha për krijimin dhe shpërndarjen e armëve.

Mediat sociale mund të zhdukin kufijtë dhe të sjellin njerëzit me afër, por gjithashtu mund të rrisin përçarjen shoqërore. Dhe kjo i jep shtysë ngacmimit kibernetik, gjuhës së urrejtjes dhe përhapjes së ngjarjeve të rreme. Ne duhet të vendosim se çfarë lloj rregullash të mediave sociale duam të krijojmë, por gjithashtu duhet të pranojmë se mediat sociale po riformojnë vlerat tona dhe mënyrën se si i krijojmë dhe shpërndajmë këto norma. Përveç kësaj, kontakti i vazhdueshëm me të tjerët mund të kthehet në formën e një detyrimi të vazhdueshëm, si pasojë e mbingarkesës me të dhëna dhe kontakte.

Risitë në inteligjencën artificiale, bio-teknologji, robotikë dhe teknologji të tjera në zhvillim do të ripërcaktojnë kuptimin e qenies njerëzore dhe lidhjet që ne krijojmë me njëri-tjetrin dhe me planetin. Aftësitë tona, identitetet tona dhe potencialet tona do të evoluojnë së bashku me teknologjitë që vetë ne krijojmë.

Në dekadat e ardhshme, duhet të krijojmë barriera mbrojtëse për të ruajtur përparësitë e Revolucionit të Katërt Industrial në mënyrë që të përfitojë i gjithë njerëzimi. Ne duhet të njohim dhe menaxhojmë ndikimet e mundshme negative që mund të ketë ai, veçanërisht në fushat e barazisë, punësimit, privatësisë dhe besimit. Me vetëdije duhet të ndërtojmë vlera pozitive nëpërmjet teknologjive që krijojmë, të mendojmë se si do të përdoren dhe t'i projektojmë ato duke pasur parasysh standardet etike dhe frymën e bashkëpunimit për të ruajtur atë çka është e rëndësishme për ne.

Kjo përpjekje kërkon që të gjithë aktorët - qeveritë, politikbërësit, organizatat ndërkombëtare, rregullatorët, organizatat e biznesit, akademika dhe shoqëria civile - të punojnë së bashku për të orientuar fuqinë e zhvillimit teknologjik në drejtime që kufizojnë rrezikun dhe krijojnë një botë që përputhet me qëllimet e përbashkëta të së ardhmes.

Ju, si një individ, qytetar, punonjës, investitor dhe influencues social, jeni një aktor vendimtar në Revolucionin e Katërt Industrial. Ndarja e mendimeve tuaja mbi teknologjitë dhe ajo që vlerësoni në shpalosjen e këtij revolucioni është thelbësore. Bota që krijojmë përmes teknologjive mund të formësojë jetën tonë dhe kjo është ajo që përcjellim në brezin e ardhshëm.

Revolucioni i Katërt Industrial mund të komprometojë perceptimin mbi burimet tradicionale të njerëzimit, si: puna, komuniteti, familja dhe identiteti ose mund ta drejtojë njerëzimin drejt një ndërgjegjeje të re morale dhe kolektive të bazuar në një ndjenjë fati të përbashkët. Zgjedhja është e jona!

Bibliografia

1. Butler. E.(2011. Milton Friedman: Një udhëzues i përpiktë mbi idetë dhe ndikimin e ekonomisë së tregut të lirë. HEE.
2. <https://www.economist.com/>
3. <https://www.project-syndicate.org/>
4. <https://www.worldbank.org/>
5. Kaletsky, A. 2011. Kapitalizmi 4.0 Lindja e ekonomisë së re. Bloomsbury London.
6. Magone, A. Mazali, T. 2016. Industria 4.0. Njeriu është makineri ne fabrikën dixhitale.
Goware IT
7. Schwab, K. 2017. Revolucion i Katërt Industrial. WEF.
8. Sharma, K. M. 2007. Globalizimi, Privatizimi dhe Ekonomia e tregut. Jaipur.
9. Tegmark, M. 2017). Life 3.0: Të jesh njeri në epokën e inteligjencës artificiale. NY.

Summary

Neoliberal economics has reached a breaking point. As a result, the traditional left-right political divide is being replaced by a split between those seeking forms of growth that are less inclined toward extreme concentration of wealth and opportunity and those seeking to end such concentration by closing open markets and societies. Since the Agrarian Revolution, technological progress has always fueled opposing forces of diffusion and concentration.

Diffusion occurs as old powers and privileges corrode; concentration occurs as the power and reach of those who control new capabilities expands. The so-called Fourth Industrial Revolution will be no exception in this regard. The Fourth Industrial Revolution that is underway can compromise humanity's traditional sources of meaning – work, community, family, and identity – or it can lift humanity into a new collective and moral consciousness based on a sense of shared destiny. Which outcome emerges is up to us. The Fourth Industrial Revolution builds on the Third Industrial Revolution, also known as the Digital Revolution, which entailed the proliferation of computers and the automation of record keeping; but the new wave of transformation differs from its predecessors in a few key ways. First, innovations can be developed and diffused faster than ever. Second, falling marginal production costs and the rise of platforms that aggregate and concentrate activity in multiple sectors augment returns to scale.

Third, this global revolution will affect – and be shaped by – all countries, and have a systems – level impact in many areas. In this work we aim to give answers by referring to some analyzes made by some economists. Is it possible that Neoliberal economics is actually the end of the beginning? Trying to understand the future prospective of this system in global economic relations in accordance with the opinions of the various American and world economists. It does also introduce some of the main debates about the Economic Liberalism and its effects in the global economy.

Keywords: *liberalization, Capitalism, protectionism, Globalization.*

KRIMI KOMPJUTERIK DHE SHOQËRIA SHQIPTARE

Ph.D. Bledar Ilia^a

M.Sc. Gazmend Sulaj^b

^aKolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Menaxhim Turizëm

^bRepublika e Shqipërisë

Gjykata e Krimeve të Rënda

Drejtuues i Oficerëve të Policisë Gjyqësore

Abstrakt

Është e qartë se krimi kompjuterik është një problem që prevalon në shoqëri. Aksesit në Internet është lehtësuar duke u lehtësuar gjithashtu edhe mundësia për të kryer vepra penale kompjuterike. Me rritjen e numrit të personave që frekuentojnë Internetin, kriminelët kanë një numër më të madh viktimash potenciale. Faktorë të tjerë si lehtësia e aksesit në të dhënat kompjuterike, kanë ndikuar në përhapjen e një sërë veprash penale të reja. Ndërkohë veprat tradicionale, dikur lehtësisht të kontrollueshme, aktualisht kanë marrë përmasa ndërkombëtare.

Natyra e Internetit ka bërë që individët të sillen në mënyra që në botën fizike nuk do të ndodhnin kurrë, duke cenuar standardet morale të botës fizike. Kufijtë e teknologjisë janë zgjeruar duke cenuar konceptin e pronës private dhe të së drejtës për jetën private.

Individët sillen ndryshe në botën teknologjike, duke mos i konsideruar këto veprime si imorale apo kriminale.

Kjo mungesë e moralit konsensual në botën virtuale është quajtur si katalizator toksik, si pasojë e ndërveprimit të individit me teknologjinë.

Lidhja individ-teknologji çon në një botë ku rregullat morale konvencionale nuk aplikohen. Mungesa e njohurive dhe e familjarizimit me teknologjinë, si dhe lehtësia e përdorimit të saj kanë sjellë si pasojë faktin që shumë individë nuk e kuptojnë rrezikun potencial që përbëjnë për veten.

Hapësira midis përdoruesit ekspert dhe jo-ekspert, e zgjeruar më tej nga lehtësimi teknologjik, ka qenë shënjestra e krimit kompjuterik. Njohuritë e ulëta në lidhje me rreziqet dhe mjetet mbrojtëse, konsiderimi i sjelljeve kriminale si nonnale bëjnë që autorët e veprave penale kompjuterike të mos arrijnë të ndëshkohen.

Fjalë Kyçe:

Kuptimi i krimit kompjuterik

Përgjithësisht, kompjuterët në krime mund të shërbejnë si objekte, subjekte dhe mjete. Janë objekte të krimeve kur ato sabotohen ose vidhen. Në shumë raste, kompjuterët janë goditur, djegur ose janë nxjerrë jashtë përdorimit me instrumente të caktuar.

Janë në rolin e subjekteve kur ato janë mjediset në të cilat zbatimet teknologjike kryejnë krime.

Në këtë kategori përfshihen për shembull, sulmet me viruse kompjuterike. Kur ndodhin krime kompjuterike, kompjuterët mund të jenë dhe subjekt i sulmeve.

Roli i tretë i kompjuterëve në krime është përdorimi i tyre si mjet për të prodhuar informacion të rremë apo për të planifikuar dhe kontrolluar krime të cilat, mund të kryhen në një të ardhme.

Sipas disa përcaktimeve ndërkombëtare, termi krim kompjuterik, është i ndarë në dy kategori:

a) Në një kuptim të ngushtë, me krim kompjuterik, do të kuptohet çdo sjellje e kryer nëpërmjet veprimeve elektronike, të cilat drejtohen ndaj sigurisë së sistemeve kompjuterike dhe të dhënave të përpunuara prej tyre; dhe.

b) Në një kuptim më të gjerë, me krim kompjuterik, do të kuptohet çdo sjellje e paligjshme e kryer me mënyra apo nëpërmjet një kompjuteri apo sistem kompjuterik, përfshirë krime të tilla si përpunimi i paligjshëm, ofrimi

apo shpërndarja e informacionit nga një kompjuter apo rrjet, për të abuzuar dhe tërhequr vëmendjen me forma të tilla si ato për përkrahje të grupeve si për shembull, terroriste, neonaziste, pornografia dhe pedofilia. Këtu do të përfshihen edhe llojet e krimeve të mashtrimeve, duke shkelur sigurinë e rrjeteve si, bixhozi i paligjshëm, skemat piramidale, mashtrimi me karta krediti dhe lloje të tjera të aktiviteteve të paligjshme. Në cybercrime, komponenti “cyber”, zakonisht i referohet për të kualifikuar shkeljet e reja të mundësuar nga teknologjia e informacionit apo ndërveprimi të hapësirës kompjuterike, në shumë aktivitete tradicionale.

Legjislacioni penal shqiptar kundër krimit kompjuterik

Në Shqipëri, Kodi Penal është miratuar me ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 dhe hyri në fuqi më 01.06.1995, i ndërtuar sipas modeleve të kodeve penale perëndimore. Ky kod është amenduar disa herë me ligjin nr.8204 datë 10.04.1997, ligjin nr.8279 datë 15.01.1998, ligjin nr.8733 datë 24.01.2001, ligjin nr.9086 datë 19.06.2003, ligjin nr. 9275 datë 16.09.2004, ligjin nr. 9686 datë 26.02.2007. ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008 dhe së fundmi me ligjin nr.10023 datë 27.11.2008, objekt i këtij kapitulli.

Në Kodin Penal parashikohen ato figura të veprave penale që ndeshen më tepër në praktikë, të cilat janë më të qëndrueshme dhe më të njohura gjatë zhvillimit historik të shoqërisë, si dhe figura të reja që diktohen nga situata shoqërore. Megjithatë, edhe pse i pasuruar vazhdimisht që prej miratimit të tij në vitin 1995, sërish Kodi nuk ka mundur të parashikojë të gjitha veprat penale që ndodhin në shoqëri. Deri në ndryshimet e fundit të vitit 2008, nuk kanë qenë të parashikuara vepra penale në fushën kompjuterike, edhe pse sistemet kompjuterike ishin bërë pjesë e shoqërisë shqiptare.

Republika e Shqipërisë, në vitin 2002, ratifikoi Konventën për Krimin Kibernetik të Këshillit të Evropës, e cila pas 5 ratifikimesh hyri në fuqi më 01.07.2004. Kjo konventë, hyri në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, por de facto mbetej e pazbatueshme, pasi nuk ishin miratuar instrumentet ligjore të nevojshëm për zbatimin efektiv të saj.

Deri në ndryshimet e ligjit nr. 9859, datë 21.1.2008, të vetmet nene në Kodin Penal kanë qenë:

-Neni 192/b “Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike”, i cili parashikonte në vija të përgjithshme çdo formë ndërhyrjeje në çdo transmetim dhe program kompjuterik, pavarësisht se në asnjë dispozitë nuk përcaktohej se çfarë do të quhej “program kompjuterik” dhe “transmetim kompjuterik”;

-Neni 286/a “Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë”, i cili parashikonte përdorimin e sistemeve telematike, mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë në rastet e veprave penale të parashikuara në nenet 283-286/a. Këto nene u shtuan në Kod, me ligjin nr. 8733 datë 24.01.2001, përpara ratifikimit dhe hyrjes në fuqi të Konventës, dhe përfaqësojnë një vizion për zhvillimin e legjislacionit penal dhe një përpjekje për t’iu përafuar sadopak ritmit të zhvillimit teknologjik.

Ligji nr. 9859 datë 21.01.2008 parashikoi një paragraf shtesë në nenin 117 “Pornografia”, i cili parashikon:

“Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në Internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë”.

Ky paragraf është në përputhje me nenin 9 të Konventës për Krimin Kibernetik, Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1989 mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventën e Organizatave Ndërkombëtare të Punës mbi Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve.

Neni 117, paragrafi i dytë parashikon si vepër penale prodhimin e materialeve pornografike, shpërndarjen dhe publikimin, por nuk parashikon ofrimin, vënien në dispozicion ose prokurimin për veten ose për të tretët.

Prokurimi i materialeve pornografike me të mitur është lehtësuar me përdorimin e sistemeve kompjuterike dhe komunikimit mes tyre. Lehtësia e kërkimit dhe shkarkimit bëjnë të mundur edhe kryerjen e veprës penale të shpërndarjes së këtij materiali pornografik nëpërmjet Internetit ose në forma të tjera (nëpërmjet pajisjeve të memorizimit si CD ose USB ose në formë të printuar).

Kërkimi në Internet ose hapja e materialit me përmbajtje pornografike me të mitur në Internet, nuk përbën vepër penale, sipas nenit 117 të Kodit Penal.

Ky nen, në ndryshim nga Konventa, përdor termin “Internet”, një term i cili nuk përkufizohet në asnjë akt ligjor; si dhe termin evaziv “në çdo formë tjetër”. Në çdo formë tjetër mendoj se mund të përfshijë dërgimin e materialeve pornografike me anë të e-mail, duke i shpërndarë në formë të printuar ose fotokopje, në format kasetash video ose CD, si dhe nëpërmjet teknologjisë wireless në telefonat celularë.

Plotësimi i këtij neni edhe me mbajtjen e materialit pornografik do të përbënte një garanci më shumë për mbrojtjen e interesave të të miturit nga çdo formë abuzimi fizik dhe psikologjik. Pasi shpesh materiali pornografik me të mitur shkarkohet (download) nga faqet e aksesuara, me qëllim mbajtjen personale, por autori mund të ketë për qëllim shpërndarjen e mëtejshme të tyre.

Akresi në këto materiale dhe shkarkimi për qëllime personale i tyre, favorizon veprën penale të prodhimit të materialeve pornografike me të mitur dhe nxit shpërndarjen ose publikimin në Internet ose në çdo formë tjetër.

Ndryshimet e legjislacionit penal shqiptar kundër krimit kompjuterik pas vitit 2008.

-Ligji nr. 10023 datë 27.11.2008 plotëson më tej Kodin Penal dhe parashikon 11 vepra penale të veçanta dhe një pikë shtesë në paragrafin e dytë të nenit 7 “Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj”.

Nenet e tjera të këtij ligji plotësojnë pjesën e posaçme të Kodit, në kapituj të ndryshëm, në varësi të objektit të veprave penale, të cilat janë:

“Neni 74/a, shpërndarja kompjuterike e materialeve pro genocidit ose krimeve kundër njerëzimit”;

“Neni 84/a, kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”;

“Neni 119/a, shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”;

“Neni 119/b, fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”;

Elementet e veprës penale të mashtrimit janë të njëjtë me mashtrimin si veprë penale tradicionale, por ndryshon mënyra e kryerjes së veprës penale.

Mashtrimi kompjuterik kryhet: duke futur të dhëna në një sistem kompjuterik, duke ndryshuar të dhënat ekzistuese në sistemin kompjuterik, duke fshirë të dhënat ekzistuese në sistemin kompjuterik ose duke hequr këto të dhëna nga sistemi kompjuterik. Heqja e të dhënave, në ndryshim nga fshirja, nuk i zhduk në mënyrë të pakthyeshme të dhënat nga sistemi kompjuterik, por bën të pamundur përdorimin e tyre nga personat e autorizuar. Ndërhyrja në funksionimin e sistemit kompjuterik është çdo veprim që cenon funksionimin normal të këtij sistemi.

Përkufizimi i sistemit kompjuterik dhe të dhënave jepet në nenin 1 të Konventës, i cili parashikon:

“Të dhëna kompjuterike” do të thotë përfaqësim i fakteve, informacioneve apo konceptesh në një formë të përshtatshme për procesim në një sistem kompjuterik, që përfshijnë një program të përshtatshëm për punën e një sistemi kompjuterik për të kryer një funksion.

Qëllimi për përfitim ekonomik të padrejtë për vete ose për të tretë, ose për të pakësuar pasurinë e personave të tretë, është element i veprës penale.

Paragrafi i dytë i këtij neni parashikon rrethanat cilësuese, të cilat janë: kryerja e veprës në bashkëpunim, kryerja në dëm të disa personave, kryerja më shumëse njëherë dhe kur nga vepra kanë ardhur pasoja të rënda materiale. Rrethanat cilësuese të mësipërme interpretohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha veprat e tjera penale të parashikuara në kod. Rëndësia e kësaj veprë penale ka sjellë sanksionin e dyfishtë dhe me burgim dhe me gjobë për autorët.

Neni 18 i ligjit nr.10023 parashikon shtimin e një neni në seksionin VIII

“Falsifikimi i dokumenteve”, nenin 186/a, i cili parashikon:

Falsifikimi kompjuterik;

“Futja, ndryshimi, fshirja apo heqja e të dhënave kompjuterike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtpërdrejt të

lexueshme apo të kuptueshme, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet.”

“Kur kjo vepër kryhet nga personi, që ka për detyrë ruajtjen dhe administrimin e të dhënave kompjuterike, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për interesin publik, dënohet me burgim tre deri në dhjetë vjet.”

Ky nen është mbështetur në nenin 7 të Konventës. Interpretimi i këtij neni bazohet në përkufizimin e të dhënave kompjuterike, i cili është dhënë në nenin 1 të Konventës.

Falsifikimi kompjuterik nga vetë emërtimi i neni, realizohet në të dhënat kompjuterike, të cilat mund të jenë drejtpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme. Ky falsifikim kryhet nëpërmjet futjes së të dhënave të rreme, ndryshimit të të dhënave ekzistuese me qëllim krijimin e të dhënave të rreme, fshirjes së të dhënave ekzistuese ose heqjes së të dhënave. Ndryshimi midis fshirjes së të dhënave dhe heqjes së tyre, u paraqit gjatë analizës së veprës penale të mashtrimit kompjuterik.

Terminologjia e përdorur në të dy rastet është e njëjtë me Konventën.

Qëllimi i paraqitjes së këtyre të dhënave të rreme si autentike është element i veprës penale.

Dy janë format kryesore të kryerjes të falsifikimit:

a) Përdorimi i sistemit kompjuterik për të falsifikuar dokumente shkresore, dhe b) Përdorimi i sistemit kompjuterik për të falsifikuar dokumente elektronike.

Me “të dhëna drejtpërdrejt të lexueshme ose të kuptueshme” në një interpretim të mbështetur në përkufizimin e dhënë në Konventë, do të kuptojmë të dhëna kompjuterike të cilat nuk kanë nevojë për një procesim të mëtejshëm në një sistem kompjuterik.

Paragrafi i dytë i këtij neni, parashikon rrethanat cilësuese të cilat janë: kryerja e veprës nga subjekti i posaçëm, i cili ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë të dhënat; kryerja e veprës në bashkëpunim, kryerja e veprës më shumë se një herë ose kur nga kryerja e veprës kanë ardhur pasoja të rënda për interesin publik.

Interesi publik është një koncept i lidhur ngushtë me ekzistencën e shtetit dhe bën fjalë për “mirëqenien e përgjithshme” të shoqërisë. Interesi publik

vendoset përballë interesit privat dhe interesit të një individi të caktuar, por nuk ka një përkufizim të vetëm. Këndvështrimet janë të ndryshme në lidhje me konceptin e interesit publik. Në rastin konkret, interesi publik është mirëqenia e shoqërisë në tërësinë e vet, jo mirëqenia e çdo individi konkret, pjesë e kësaj shoqërie. Interesi publik në disa raste bie ndesh me interesat private të personave të veçantë, veçanërisht në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, ku fillon diskutimi se cili prej këtyre interesave është mbizotërues.

Pas ratifikimit të Konventës, neni 192/b ishte një parashikim shumë i përgjithshëm dhe jo në përputhje me parashikimet e Konventës. Për këtë arsye neni 192/b, u ndryshua nga neni 19 i ligjit nr. 10023, si vijon:

Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterike

“Hyrja e paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cenimit të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”

Ndryshimi i këtij neni është mbështetur në nenin 2 të Konventës parashikon hyrjen në një sistem kompjuterik ose në një pjesë të sistemit kompjuterik, sipas përkufizimit të sistemit kompjuterik të dhënë në Konventë.

Neni 192/b i vjetër parashikonte ndërhyrjen në transmetime ose programe kompjuterike. Hyrja në sistemin kompjuterik, duhet të jetë e paautorizuar ose duke tejkaluar autorizimin. Autorizimi mund të jetë i përcaktuar me ligj, me marrëveshje të palëve ose me lejen dhe pëlqimin e personit që ka të drejta mbi sistemin kompjuterik. Kjo vepër kërkon cenimin e masave të sigurisë së sistemit për të hyrë në mënyrë të paautorizuar, por mund të paraqitet një rast praktik kur mungesa e masave të sigurisë në një sistem kompjuterik, e ardhur nga pakujdesia ose nga një gabim njerëzor, të ketë lehtësuar hyrjen e paautorizuar të autorit të veprës penale. Kjo do të sillte mungesën e përgjegjësisë penale të autorit, pasi nuk parashikohet rasti kur nuk ka cenim të masave të sigurisë.

Mjafton konstatimi i veprimit të hyrjes së paautorizuar për të pasur vepër penale. Rëndësia e pasojave të ardhura përbën rrethanat cilësuese, të cilat parashikohen në paragraf e dytë të këtij neni. Pasojat kanë karakter ushtarak, shëndetësor, mbrojtja civile si dhe në çdo sistem me rëndësi publike, ku mund të shtojmë infrastrukturën, telekomunikacionet etj.

Në seksionin III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, pas nenit 293, shtohen nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/cc, me këtë përmbajtje:

Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike

“Përgjimi i paligjshëm me mjete teknike i transmetimeve jopublike, i të dhënave kompjuterike nga/ose brenda një sistemi kompjuterik, përfshirë emetimet elektromagnetike nga një sistem kompjuterik, që mbart të dhëna të tilla kompjuterike, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet nga/ose brenda sistemeve kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik të mbrojtjes civile apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 293 Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

“Dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në të dhënat kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo të dhënë tjetër kompjuterike, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”

Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike

“Krijimi i pengesave serioze dhe të paautorizuara për të cenuar funksionimin e një sistemi kompjuterik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimit, ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi

publike, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. “

Neni 293/c Keqpërdorimi i pajisjeve

“Prodhimi, mbajtja, shitja, dhënia në përdorim, shpërndarja apo çdo veprim tjetër, për vënien në dispozicion të një pajisjeje, ku përfshihen edhe një program kompjuterik, një fjalëkalim kompjuterik, një kod hyrjeje apo një e dhënë e tillë e ngjashme, të cilat janë krijuar ose përshtatur për hyrjen në një sistem kompjuterik ose në një pjesë të tij, me qëllim kryerjen e veprave penale, të parashikuara në nenet 192/b, 293/a, 293/b e 293/c të këtij Kodi, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet”.

Këto katër nene, së bashku me nenin 192/b, të ndryshuar përfshihen në titullin e parë të Konventës, “Vepra penale kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave dhe sistemeve kompjuterike.”

Struktura e neneve 293/a, 293/b dhe 293/c është e njëjtë. Këto nene parashikojnë veprën penale në paragrafin e parë dhe në paragrafin e dytë parashikojnë rrethanat cilësuese. Rrethanat cilësuese janë rastet kur veprat e sipërpërmendura kanë si objekt të tyre sistemet kompjuterike ushtarake dhe të sigurisë kombëtare, sistemet kompjuterike të mbrojtjes civile, shëndetësisë ose çdo sistem tjetër me rëndësi publike. Lista nuk është shteruese, duke mundësuar përfshirjen e çdo sistemi kompjuterik i cili mund të paraqesë rëndësi për rendin publik.

Neni 293/a parashikon përgjimin e paligjshëm të të dhënave, me qëllim mbrojtjen e të fshehtësisë “së komunikimit në analogji në përgjimin telefonik”. Garancitë që jepen për përgjimin e të dhënave kompjuterike duhet të mbrojnë të drejtën për jetë private të personave. Ky përgjim përfshin të dhënat, përkufizimi i të cilave është dhënë në Konventë si dhe emetimet elektromagnetike të çfarëdo forme. Emetimet elektromagnetike janë shtuar tek përgjimi i të dhënave për të garantuar mbrojtjen e të drejtës për jetë private nga ndërhyrjet abuzive me anë të pajisjeve të teknologjisë së lartë si wireless ose bluetooth. Duke ndjekur të njëjtin arsyetim si në Konventë, për cilësimin si transmetim jopublik, nuk nënkuptohet shqyrtimi i përmbajtjes të të dhënave të transmetuara, por mënyra e transmetimit të këtyre të dhënave.

Neni 293/b parashikon ndërhyrjen në të dhëna, kur kjo ndërhyrje nuk përbën veprë tjetër penale. Për të analizuar format e kryerjes së kësaj veprë

penale do të bazohemi në nenin 4 “Interferenca e të dhënave”, të Konventës.

-Fshirja do të thotë zhdukja e të dhënave në mënyrë përfundimtare dhe të parikuperueshme.

- Ndryshimi është paraqitja e të dhënave, të cilat nuk janë të njëjta me të dhënat ekzistuese.

Dëmtimi është cenimi i integritetit të të dhënave në tërësinë e tyre. Shtrembërimi është një formë e ndryshimit negativ të të dhënave. Suprimimi është cenimi i disponueshmërisë së të dhënave, të dhënat ekzistojnë, por nuk mund të aksesohen ose të jenë të disponueshme.

Mjafton një nga veprimet e mësipërme që vepra penale të quhet e kryer, nuk kërkohet motivi ose qëllimi si element i veprës penale.

Neni 293/c parashikon rastet kur dëmtimet, ndryshimet, fshirja ose suprimimi i të dhënave kryhen për të cenuar funksionimin e sistemit kompjuterik. Format e kryerjes të kësaj vepre janë të njëjta me format e ndërhyrjes në të dhënat kompjuterike, të parashikuara në nenin 293/b.

Paragrafi i dytë, analog me nenet 293/a dhe 293/b parashikon rastet kur pasojat e rënda të ardhura nga vepra penale përbëjnë rrethana cilësuese. Këto rrethana cilësuese u analizuan më sipër. Këto nene bëjnë të mundur kualifikimin e veprave penale të tilla si: “hacking”, shpërndarje virusesh, krimbash, trojanesh ose lloje të tjera malore.

Neni 293/g penalizon prodhimin, mbajtjen, shitjen, dhënien në përdorim, shpërndarjen ose çdo veprim tjetër për vënien në dispozicion të pajisjeve të krijuara ose të përshtatura për hyrjen në sisteme kompjuterike me qëllim kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 192/b, 293/a, 293/b e 293/c. Përveç formave të listuara më sipër, termi “çdo veprim tjetër për vënien në dispozicion” përfshin edhe vendosjen për shitje në një faqe web të pajisjeve të mësipërme. Me pajisje do të kuptojmë edhe programet kompjuterike (software), fjalëkalimet kompjuterike ose kodet e hyrjes si dhe çdo e dhënë tjetër e ngjashme. Sërish kemi një liste jo shteruese duke dashur të mos e kufizojë veprimin e dispozitës në një sferë të caktuar. Pajisjet, kodet e hyrjes, fjalëkalimet dhe çdo e dhënë tjetër duhet të jenë krijuar me qëllim hyrjen në një sistem kompjuterik ose pjesë të tij, dhe në rast se kanë funksion të ndryshëm, të jenë përshtatur për të kryer ndërhyrjen në sistemet kompjuterike.

Problemi i provueshmërisë së funksionit të këtyre pajisjeve ose të dhënave qëndron në rastin kur pajisja e dhënë ka funksion të dyfishtë: funksionin bazë për të cilin është krijuar dhe funksionin për të hyrë në një sistem kompjuterik.

Në një rast të tillë, do të shihet funksioni primar dhe qëllimi i përdorimit, mbajtjes, prodhimit, shitjes ose vënies në dispozicion të pajisjes.

Nenet 192/b dhe nenet 293/a, 293/b, 293/c dhe 293/c, në ndryshim nga nenet e tjera ku sistemet kompjuterike janë mjet i ri për kryerjen e veprave penale ekzistuese në shoqëri, përmbajnë vepra penale që janë shfaqur me zhvillimin e teknologjisë, dhe varen ekskluzivisht nga ekzistenca e sistemit kompjuterik.

Këto ishin ndryshimet e bëra në Kodin Penal në lidhje me veprat penale në fushën kompjuterike.

Dispozitat e shtuara janë pak a shumë një përshtatje e dispozitave të Konventës për Krimin Kibernetik. Dispozitat shtesë janë një hap në drejtim të azhurnimit të legjislacionit penal shqiptar me zhvillimin e teknologjisë. Problem paraqet mungesa e përkufizimeve precize, të cilat do të ndihmonin në zbatimin e drejtë të këtyre dispozitave. Për shkak tek periudhës kohore të shkurtër në fuqi, nuk ka ende një praktikë gjyqësore shqiptare, praktikë, e cila do të interpretonte dhe do të zgjidhte problemet që mund të sjellin këto dispozita.

Konkluzione

Përmbajtja komplekse, kapaciteti më i madh dhe lehtësia e përdorimit të sistemeve kompjuterike po zhvillojnë “Internetin e së ardhmes”. Kriza e ekonomisë botërore nuk ka ndikuar në krimin kompjuterik. Nëse mendoni se duke mos hapur faqe web ose e-maile të panjohura do të jeni të sigurt, ka ardhur koha të rimendoheni sërish. Kërcënimet e sotme nuk janë vetëm e-mailet, faqet web, pop-up të papritura, por rrjetet sociale. Nga kompjuterët, tashmë shënjestra janë bërë telefonat celularë dhe “iPhone” i Apple. Pavarësisht sasisë së kufizuar në treg, duket se trajektorja e evolucionit të telefonisë celulare po ndjek të njëjtën linjë si kompjuterët.

Gjatë vështirimit të masave kombëtare dhe ndërkombëtare, vihet re se nuk ekziston një përkufizim i saktë i konceptit “krim kompjuterik”, ose përkufizime të njëjta të veprave penale.

Mungesa e përkufizimit dhe elementeve përbërës të veprave penale kompjuterike, pavarësisht përpjekjeve ndërkombëtare, nuk kanë pasur rezultat. Përmasat ndërkombëtare të veprave penale kompjuterike, kërkojnë një analizë më të hollësishme të parimeve për përcaktimin e juridiksionit kombëtar dhe ekstra territorial. Moderimi i përdorimit të këtyre parimeve do të sjellë bashkëpunim efektiv ndërkombëtar.

Hetimi i veprave penale në hapësirë kompjuterike kërkon veprime të shpejta, për të qenë efektive. Kërkimi i të dhënave në një shtet tjetër dhe përdorimi i këtyre të dhënave në cilësinë e provës, duhet të zgjidhet për të mos u konsideruar si cenim i sovranitetit shtetëror. Ekstradimi është një tjetër problem, i cili duhet të merret parasysh, pasi vendndodhja fizike e autorit jodomosdoshmërisht është shteti, i cili ka juridiksion për gjykimin e veprës penale. Transferimi i procedimeve është një mundësi për harmonizimin e përpjekjeve për të luftuar kriminalitetin kompjuterik dhe një zgjedhje efektive në rastet e konflikteve juridiksionale. Kryesore është fryma e bashkëpunimit dhe vullneti i nevojshëm për një administrim të efektshëm të drejtësisë.

Interneti është një fenomen i ri, i cili duhet të inkorporohet ndër institucionet e shoqërisë dhe duhet të kontrollohet dhe normohet efektivisht nga legjislacioni shqiptar. Si format tradicional të veprave penale, edhe veprat penale kompjuterike janë pjesë e shoqërisë njerëzore dhe nuk mund të zhduken plotësisht. Shpejtësia me të cilën po ecin veprat penale kompjuterike është shqetësuese. Nuk mund të presim me vetëbesim se legjislacioni ekzistues është i mjaftueshëm për të mbajtur situatën nën kontroll. E rëndësishme është zbatimi i legjislacionit aktual dhe plotësimi i mëtejshëm i tij. Standardet e vendosura për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nuk janë më të mjaftueshme për të rregulluar situatat e lindura nga zhvillimet teknologjike. Interneti është njëkohësisht një mjet për promovimin e të drejtave të njeriut, duke zbuluar rastet e shkeljeve të këtyre të drejtave, dhe mjeti më i fuqishëm për ndërhyrjen dhe shkeljen të drejtave të njeriut.

E ardhmja pritet të sjellë rekrutimin e specialistëve nga organizatat kriminale. Një zhvillim më të madh të teknikave për realizimin e veprave penale. Teknologjia e informacionit në ndryshim nga legjislacioni, ka karakter fleksibël dhe rezervon mundësinë e ndryshimit, azhurnimit dhe perfeksionimit shpejt dhe në mënyrë sa më efektive. Legjislacioni është i ngadaltë në krahasim me

teknologjinë dhe procesi i gjatë hartues dhe miratues sjell hyrjen në fuqi të një ligji tashmë “të vjetërsuar”. Në fillim ndryshimi duhet të vijë nga vetë shoqëria, e cila duhet të kuptojë se pavarësisht zhvillimit dhe mundësive që teknologjia ofron, sjellja kriminale nuk ka ndryshuar.

Mungesa e ndalimeve ligjore nuk do të thotë se çdo sjellje lejohet. Morali i shoqërisë dhe morali personal nuk kanë ndryshuar, pavarësisht “tundimit të lirisë” të ofruar nga teknologjia. Të jesh një *hacker* nuk është krenari, as inteligjencë dhe profesionalizëm. Të krijosh një *software* të dëmshëm nuk është një veprim me të cilin mund të mburresh duke u dalluar nga të tjerët, dallohesh vetëm për sjelljen kriminale! Të shkarkosh filma dhe muzikë, pavarësisht se nuk parashikohet si vepër penale, i shkakton një dëm dikujt duke u fshehur pas lirisë së aksesit në informacion. Përdoruesit duhet të nxiten për të pasur një sjellje korrekte dhe të përdorin me kujdes teknologjinë e informacionit.

Edukimi duhet të ndodhë në shoqëri. që të nxitet raportimi i krimeve kompjuterike. Viktima duhet të përkrahet dhe të respektohen të gjitha të drejtat e saj në proces. Figura e errët e krimit rritet, pasi vetë shoqëria nuk i konsideron vepra penale disa veprime dhe nuk raporton disa të tjera pasi nuk i kupton. Mungesa e profesionalizmit nga organet proceduese dhe kohëzgjatja e procesit ndikon në raportim. Bashkëpunimi shoqëri-organe shtetërore është çelësi i luftës kundër veprave penale kompjuterike.

Ndërgjegjësimi i profesionistëve ligjorë duhet të fillojë me faktin se veprat penale kompjuterike nuk janë analoge me veprat penale reale. Mungesa e njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit sjell nevojën për bashkëpunim me specialistët e teknologjisë së informacionit, për hartimin e legjislacionit që adreson në mënyrën e duhur veprat penale kompjuterike në hetimin dhe gjykimin efektiv të autorëve të veprave penale dhe në parandalimin e veprave penale të ardhshme. Bashkëpunimi, shpejtësia dhe efektiviteti janë faktorët që do të ndikojnë në politikën penale kompjuterike.

Koordinimi ndërshtetëror duke përcjellë informacionin ndërmjet shteteve është një hap në luftën kundër veprave penale kompjuterike, nga vetë natyra e tyre, të pakufizuara gjeografikisht.

Shtetet duhet të shkëputen nga konceptet “mesjetare” të sovranitetit dhe territorit, duke hartuar parashikime të afta për të lehtësuar dhe përsheptuar

bashkëpunimin ndërkombëtar.

Lufta kundër kriminalitetit duhet të respektojë standardet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të ndjekë kriterin e proporcionalitetit për ndërhyrjen në këto të drejta. Duhet të ndërgjegjësohemi se zhvillimi teknologjik nuk ofron liri të pakufizuar, por as mbrojtje të pakufizuar nga ndërhyrja në liritë personale, jo vetëm e autoriteteve shtetërore por dhe subjekteve private.

Në përfundim, duhet të kemi parasysh se zhvillimi teknologjik për të cilin po flasim, në thelb është vetëm një pajisje, një kompjuter. Janë njerëzit, të cilët e krijuan, zhvilluan dhe përsosën më tej teknologjinë e informacionit.

Janë po të njëjtët njerëz, që zbuluan të metat, të fshehtat e sistemeve dhe abuzojnë me to. Kompjuterët dhe informacioni i ruajtur në to, pa ekzistencën e njeriut, janë thjesht makineri. Veprat penale janë të njëjtat, vetëm mjetet e realizimit të tyre janë zhvilluar. Zhvillimi teknologjik nuk është një hapësirë e re, e shkëputur nga realiteti, është realiteti, i cili është revolucionarizuar.

Bibliografia

- 1.Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- 2.Konventa për Krimin Kibernetik të Këshillit të Evropës.
- 3.Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve.
- 4.Kodi i Procedurës Penale të Republikës të Shqipërisë.
- 5.Kodi Penal i Republikës të Shqipërisë (i ndryshuar). Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008, ligji nr. 10023 i datës 27.11.2008.
- 6.Ligji nr. 10054, datë 29.12.2008
- 7.Praktika Penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Summary

It is clear that computer crime is an occurrence in society. Access to the Internet has been facilitated, and the likelihood of computer fraud is also facilitated. With the increasing number of people who attend the Internet, criminals have a greater number of potential victims. Other factors such as ease of access to computer data have influenced the spread of a number of new criminal offenses. In the meantime, traditional, sometimes easily controllable works have now received international dimensions. The nature

of the Internet has caused individuals to behave in ways that would never occur in the physical world, violating the moral standards of the physical world. Technological boundaries have been expanded, violating the concept of private property and the right to privacy.

Individuals behave differently in the technological world, not considering these actions as immoral or criminal.

This lack of moral consensus in the virtual world has been termed as a toxic catalyst and a direct result of the technological interaction. Individual-technology connectivity leads to a world where conventional morality rules are not applied. Lack of knowledge and familiarity with technology and ease of use has led many individuals to not realize the potential risk they pose to themselves.

The space between expert and non-expert users, further enhanced by technological easing, has been the target of cybercrime. Low knowledge about dangers and safeguards, consideration of criminal behavior causes perpetrators of criminal offenses not to be punished.

FAKTORËT PËRCAKTUES TË PËRFITUESHMËRISË SË BANKAVE: SHQIPËRIA

M.Sc. Klejda Gabeshi ^a

M.Sc. Iva Sulaj ^b

^a Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Financë-Kontabilitet

^b Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Financë-Kontabilitet

Abstrakt

Ka shumë aspekte të bankave të cilat mund të analizohen, por ky studim fokusohet në mënyrë specifike në përfitueshmërinë e bankave. Përfitimi është një reflektim se si drejtohen bankat, duke pasur parasysh mjedisin në të cilin ato veprojnë. Më saktë, ai pasqyron cilësinë e menaxhimit të një banke dhe sjelljen e aksionarëve, strategjitë konkurruese të bankës, efikasitetin dhe aftësinë e menaxhimit të rrezikut. Përcaktuesit e performancës së bankave kanë tërhequr interesin e hulumtimeve akademike, si dhe të drejtimit të bankës, tregjeve financiare dhe mbikëqyrësve bankarë.

Studimi ka disa objektiva specifike si më poshtë:

- Identifikimin e përcaktuesve të përfitimit të të gjitha bankave tregtare që operojnë në vend përmes analizave të posaçme empirike.
- Kontrollin e efekteve të përcaktuesve të jashtëm të përfitueshmërisë së bankave tregtare.

- Identifikimin e sjelljes së strukturës së tregut të sektorit bankar shqiptar gjatë dekadës së fundit.
- Rekomandimet në lidhje me përcaktuesit kryesorë të përfitueshmërisë duke u bazuar në gjetjet empirike.

Modeli ekonometrik i përdorur është ai i regresit linear ku si variabël i varur është marrë kthimi nga kapitali ROE dhe si variabël i pavarur është trajtuar një tregues makroekonomik si dhe tregues të aktiveve dhe pasiveve të vetë sistemit. Metoda e zbatuar është metoda e zakonshme e katrorëve më të vegjël dhe para përfundimeve finale, modeli është testuar paraprakisht me anë të programit kompjuterik Eviews për supozimet bazë të metodës.

Fjalët kyçe: Faktorët Makroekonomikë dhe Bankarë, Përfitueshmëria e Bankave, Sistemi Bankar

Hyrje

Objekti kryesor i këtij studimi është identifikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm (specifikë bankarë dhe makroekonomikë) që ndikojnë përfitueshmërinë e të gjitha bankave tregtare që operojnë në Shqipëri. Fitimet ndikojnë koston e bankës për rritjen e kapitalit në dy mënyra, si një kontribuues i drejtpërdrejtë për financimin e kapitalit dhe si tregues për vlerësimin e investitorit të jashtëm si një fuqi financiare potenciale e bankës. Për më tepër, edhe në qoftë se aftësia paguese është e lartë, përfitimi i varfër ndikon në dobësimin e kapacitetit të bankës për të absorbuar goditjet negative, të cilat eventualisht do të ndikojnë në aftësinë paguese.

Përgjithësisht, përfitimi i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm është jetik në ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar dhe kontribuon në gjendjen e sistemit financiar.

Struktura e sistemit financiar të ekonomisë shqiptare është ndërtuar dhe orientuar nga sektori bankar pasi ai zë peshën kryesore në të. Referuar literaturës, modeli është i ngjashëm me atë Gjermano-Japonez dhe i ndryshëm nga ai Anglo-Sakson, struktura financiare e ekonomisë të

së cilëve është e ndërtuar mbi tregjet e kapitalit dhe parasë. Allen (2008)¹, nga shqyrtimi i 93 vendeve të ndryshme për të gjetur lidhjen e strukturës financiare me atë të ekonomisë, doli në përfundimin se ato vende, firmat e të cilave kanë aktive materiale - të prekshme dhe financohen nga burime të jashtme, kanë tendencë të orientohen drejt sektorit bankar. Vendet që kanë industri të teknologjive të larta, firma që operojnë bazuar në dije, punë kërkimore – shkencore dhe aktive jo-materiale, kryesisht të orientuara drejt shërbimeve, synojnë tregjet financiare. Performanca e aktivitetit bankar si term do të thotë përzgjedhje e një bashkësie treguesish të cilët pasqyrojnë situatën aktuale të tij dhe përmasat e aftësive që banka ka për të realizuar objektivin e synuar.

Sektori bankar i shëndetshëm nxit zhvillim dhe garanton qëndrueshmëri të ekonomisë në afat të gjatë. Ai është njëkohësisht mbartës dhe mund të jetë përhapësi kryesor i rreziqeve për shkak të peshës që zë në ekonominë e vendit. “Infektimi” i ndërmjetësit kryesor të ekonomisë sonë, do të shkaktonte çrregullim të gjithë sistemit financiar në vend. Për këtë arsye, sektori bankar merr vëmendjen kryesore të institucioneve rregullatore dhe konsiderohet segmenti më i kontrolluar i sistemit financiar.² Monitorimi i vazhdueshëm dhe matja e treguesve të performancës së aktivitetit bankar përbëjnë nevojë për të ndjekur ecurinë e sektorit, për të evidentuar problemet dhe për të gjetur mënyra për zgjidhjen e tyre. Por, matja e këtyre treguesve është konsideruar proces i vështirë për shkak të natyrës që kanë shërbimet dhe produktet që ato ofrojnë, duke qenë jo-materiale.

Shqyrtimi i Literaturës

Sipas përfundimeve të Sanni (2009)³, përfitueshmëria pasqyron një situatë ku të ardhurat e krijuara gjatë një periudhe të caktuar tejkalojnë shpenzimet e bëra gjatë të njëjtit interval kohor, me të vetmin qëllim,

1 Allen, F., dhe Carletti, E., 2008. The Roles of Banks in Financial Systems”, Përgatitur për librin: Oxford Handbook of Banking, redaktuar nga: Allen Berger, Phil Molyneux and John Wilson. Mundësohet në: <http://fic.wharton.upenn.edu/fic/papers/08/0819.pdf>

2 Varesi L. 2016. Roli i Sektorit Bankar ne Sistemin Financiar, Durrës.

3 Sanni, M.R. 2009. The effects of the 2006 consolidation on profitability of Nigerian Banks. Nigerian Research Journal of Accountancy (NRJA), a Publication of The Institute of Chartered Accountants of Nigeria (ICAN), Lagos, 1(1): 107-120.

gjenerimin e të ardhurave. Përfitueshmëria në sektorin bankar është një temë që ka marrë shumë vëmendje në vitet e fundit në botë. Por, nuk mund të lihet pa përmendur fakti se shumica e studimeve janë realizuar për vendet e zhvilluara; në të kundërt pak studime janë kryer për vendet në zhvillim.

Molyneux dhe Thornton (1992)⁴ ishin të parët që eksploruan përcaktuesit e përfitueshmërisë bankare në një sërë vendesh. Ata mblodhën të dhëna nga 18 vende evropiane gjatë periudhës 1986 - 1989, nga të cilat rezultoi një lidhje pozitive e rëndësishme midis kthimit nga kapitali dhe nivelit të normave të interesit në çdo vend si dhe përqendrimit bankar.

Guru et al., (2002)⁵ analizoi përcaktuesit e përfitueshmërisë bankare në Malajzi. Ata studiuin të dhënat e 17 bankave tregtare gjatë periudhës 1986 - 1995. Përcaktuesit e përfitueshmërisë i ndanë në dy kategori kryesore, përkatësisht përcaktuesit e brendshëm (likuiditeti, mjaftueshmëria e kapitalit dhe menaxhimi i shpenzimeve) dhe përcaktuesit e jashtëm (pronësia, madhësia e firmës dhe kushtet ekonomike). Gjetjet treguan se menaxhimi eficient i shpenzimeve ishte një nga më të rëndësishmit në shpjegimin e përfitueshmërisë bankare. Ndër treguesit makroekonomikë, norma e lartë e interesit ishte e lidhur me një nivel të ulët të përfitueshmërisë bankare dhe inflacioni kishte një efekt pozitiv në performancën bankare.

Staikouras dhe Wood, (2003)⁶ hulumtuan mbi përcaktuesit e përfitimit në 685 banka evropiane.

Analiza e tyre u përqendrua në variabla si: rreziku i kredisë, mjaftueshmëria e kapitalit, norma e interesit, efikasiteti operacional, madhësia e bankës, norma e rritjes së PBB-së dhe të ardhurat bruto për frymë për secilin vend evropian. Autorët dolën në përfundimin se mjaftueshmëria e kapitalit dhe madhësia e bankës ndikonin pozitivisht në përfitimin bankar (ROA), ndërsa rreziku i kredisë ishte i lidhur negativisht

4 Molyneux, P. dhe Thornton, J. 1992. Determinants of European Bank Profitability: A Note. *Journal of Banking and Finance*, 16: 1173-1178.

5 Guru, B. K., Staunton, J. dhe Balashanmugam, B. 2002. Determinants of Commercial Bank Profitability in Malaysia. Working Paper. Multimedia University.

6 Staikouras, Ch. dhe Wood, G. 2003. The determinants of bank profitability in Europe, European Applied Business Research Conference, Venice.

me përfitimin e bankës.

Athanasoglou et al., (2005)⁷ hetuan përfitueshmërinë e bankave greke midis 1985 - 2001 dhe arritën në rezultatin se rreziku i kredisë dhe shpenzimet operative kanë një ndikim negativ në përfitueshmëri, ndërsa inflacioni ishte i lidhur pozitivisht me performancën financiare.

Athanasoglou et al., (2008)⁸ studiuan sjelljen e përfitueshmërisë në industrinë bankare të Evropës Juglindore gjatë periudhës 1998 - 2002.

Rezultatet empirike treguan se efekti i përqendrimit të tregut ishte pozitiv, ndërsa rezultatet në lidhje me variablat makroekonomikë ishin të përziera.

Deger dhe Adem (2011)⁹ shqyrtuan përcaktuesit specifikë bankarë dhe makroekonomikë të përfitimit të bankave në Turqi gjatë periudhës kohore 2002 - 2010. Përfitueshmëria e bankave u mat me kthimin nga aktivet (ROA) dhe kthimin nga kapitali (ROE), si një funksion i faktorëve specifikë bankarë dhe makroekonomikë. Rezultatet treguan se madhësia e bankës kishte një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm statistikisht në përfitimin e bankave. Megjithatë, madhësia e portofolit të kredive kishte një ndikim negativ dhe të rëndësishëm statistikisht në përfitimin e bankave. Për sa i përket variablave makroekonomike, vetëm norma reale e interesit ndikonte në performancën e bankave pozitivisht.

Wasiuzzaman et al., (2013)¹⁰ studiuan ndikimin e komponentëve specifikë bankarë dhe makroekonomikë ndaj kthimit nga kapitali (ROE) në dhjetë banka të Malajzisë për 2004 - 2012.

Rezultati i vlerësimit tregoi se raporti i efikasitetit operacional, raporti i likuiditetit, indeksi i çmimeve të konsumit dhe kriza financiare ishin të lidhura në mënyrë të zhdrejtë me përfitueshmërinë e bankave në Malajzi.

7 Athanasoglou, P.P., Sophocles, N.B. dhe Matthaïos, D.D. 2005. Bank-specific, industry-specific and macroeconomic determinants of bank profitability. Working paper, Bank of Greece.

8 Athanasoglou, P. Brissimis, S. dhe Delis, M. 2008. Bank-specific. Industry-specific and macroeconomic determinants of bank profitability. Journal of International Financial Markets. Institutions and Money.

9 Deger, A. dhe Adem, A. 2011. Bank-Specific and Macroeconomic Determinants of Commercial Bank Profitability: Empirical Evidence from Turkey. Business and Economic Research Journal, Vol.2, No. 2, 139-152.

10 Wasiuzzaman, S. and Gunasegavan, U. N. 2013. Comparative study of the performance of Islamic and conventional banks. The case of Malaysia, Humanomics, vol.29 (1), p.43-60.

Studimet e kryera mbi përfitueshmërinë e bankave, kryesisht, kanë përdorur si matës dy tregues:

ROA (kthimin nga aktivet) dhe ROE (kthimin nga kapitali). Pas hulumtimeve paraprake ndaj përcaktuesve të përfitimit të bankave, variablat e pavarur janë klasifikuar në variabla specifike bankare, të industrisë dhe makroekonomike. Variablat bankare specifike janë faktorë të brendshëm dhe të kontrollueshëm për menaxherët e bankave ndërsa variablat makroekonomike janë të pakontrollueshme dhe kështu të jashtëm.

Të dhënat dhe Metodologjia e Studimit

Me anën e një modeli regresioni, shqyrtohet hollësisht lidhja ndërmjet kthimit nga kapitali ROE, si tregues për përfitueshmërinë bankare dhe disa faktorëve bankarë, si dhe një faktori makroekonomik.

Modeli ekonometrik i përdorur është ai i regresit linear ku si variabël i varur është marrë ROE (kthimi nga kapitali) dhe variabla të pavarur janë trajtuar një tregues makroekonomik dhe tregues të aktiveve dhe pasiveve të vetë sistemit. Metoda e zbatuar është metoda e zakonshme e katrorëve më të vegjël dhe përpara se të jepen përfundimet, modeli është testuar paraprakisht me anë të programit kompjuterik EvIEWS për supozimet bazë të metodës.

Ky punim për mbledhjen e të dhënave sasiore ka shfrytëzuar raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë¹¹ dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) të cilat më pas janë analizuar me anë të një programi kompjuterik të quajtur EvIEWS sipas një modeli ekonometrik. Të dhënat e përdorura për ndërtimin e modelit ekonometrik në këtë studim janë për një periudhë 10 vjeçare, nga viti 2007 në vitin 2016 dhe me frekuencë tremujore. Pra, për secilën variabël kam marrë 40 të dhëna.

Siç u përmend dhe më sipër **modeli ekonometrik i përdorur është ai i regresit linear të shumëfishtë ku si variabël i varur është marrë kthimi nga kapitali ROE. Arsyeja kryesore e zgjedhjes së variablit të varur lidhet me faktin e rëndësisë së madhe që ka ky tregues për përcaktimin e përfitueshmërisë bankare. Ky tregues shprehet në përqindje dhe tregon nivelin e kthimit nga**

11 Raportet e Stabilitetit Financiar, Raportet Vjetorë të Mbikëqyrjes

kapitali i vet. Ky tregues llogaritet si raporti i fitimi neto ndaj kapitalit të aksionarëve dhe mat përfitueshmërinë. Ai tregon sa fitim prodhon banka me paratë që kanë investuar aksionarët.

Në lidhje me variablat e pavarur në modelin tonë ato do të klasifikohen në dy grupe: a) Faktori makroekonomik; b) Faktorët bankarë.

Si faktor makroekonomik pas një analize të kërkimeve në këtë fushë kemi përzgjedhur një tregues me interes edhe për kontekstin në të cilin ndodhet vendi ynë. Ky faktor është: ***Norma e Inflacionit INF*** - tregues i ndryshimit të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në një ekonomi. Ai matet si ndryshimi i indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), i cili mat ndryshimin e çmimit të një shporte artikujsh që përfaqëson ato mallra që konsumohen zakonisht nga një familje.

Në grupin e faktorëve bankarë përfshihen shumë tregues, por nga rishikimi i hollësishëm e literaturës si dhe në kontekstin korent do të përdoren treguesit bankarë të mëposhtëm: ***Treguesi i kredive me problem NPL*** – ky tregues është llogaritur si raport i kredive me probleme ndaj tepricës së total kredive, ***Madhësia e Bankave SIZE*** - është një tregues që matet me logaritmin natyror të aseteve totale, që pritet të ketë një ndikim pozitiv në përfitueshmërinë e bankave, pasi tregon nivelin e aktivitetit bankar në vend dhe ***Norma e Kredive ndaj Depozitave LTD*** - paraqet një raport i cili tregon se sa mirë i menaxhojnë fondet e depozitave bankat në dhënien e kredive, tregues i masës së investimit në kredi nga bankat.

Të gjithë variablat e pavarura njësoj si variabli i varur konsiderohen për një periudhë dhjetëvjeçare me të dhëna tremujore, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2007 deri në tremujorin e katërt të vitit 2016. Kjo periudhë është marrë në konsideratë pasi duke filluar nga viti 2007 të dhënat për sistemin bankar kanë qenë më të plota dhe më të sakta.

Ky studim mbështetet në ngritjen e disa hipotezave të cilat priten të vërtetohen me anën e modelit të regresionit që do të përdoret.

Hipoteza zero e studimit tonë është: asnjë nga variablat e pavarur të marrë në shqyrtim nuk ndikon në nivelin e kthimit nga kapitali ROE.

Hipoteza alternative, të paktën njëri nga variablat e pavarur ka ndikim në nivelin e ROE.

Teorikisht pritet të kemi lidhje të zhdrejtë midis nivelit të treguesit ROE

dhe nivelit të kredive me probleme. Një rritje e nivelit të kredive me probleme do të çonte bankat në një reduktim të nivelit të ROE-s. Në rastin e kredive me probleme bankat kanë vështirësi në kthimin e këtyre kredive dhe si pasojë kjo do të çonte në një përqejësim të performancës së tyre, që si përfundim do të përkthehej në një tregues ROE më të ulët.

Analiza Empirike dhe Interpretimi i Rezultateve të Studimit

Ekuacioni final i modelit ekonometrik ka formën e mëposhtme:

$$\text{ROE} = -0.267700943 + 0.669078358 \cdot \text{INF} + 0.112317985 \cdot \text{SIZE} - 0.5678927203 \cdot \text{LTD} - 0.4831178688 \cdot \text{NPL}$$

Dependent Variable: ROE				
Method: Least Squares				
Date: 01/27/18 Time: 15:11				
Sample: 1 40				
Included observations: 40				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.267700	0.287382	-0.887673	0.3813
INF	0.669078	0.503552	1.334416	0.0315
SIZE	0.112317	0.046270	2.203795	0.0214
LTD	-0.567892	0.060720	-9.191204	0.0000
NPL	-0.483117	0.123492	-3.991457	0.0002
R-squared	0.897575	Mean dependent var	0.107185	
Adjusted R-squared	0.885754	S.D. dependent var	0.077527	
S.E. of regression	0.026320	Akaike info criterion	-4.320509	
Sum squared resid	0.024246	Schwarz criterion	-4.109399	
Log likelihood	91.41018	F-statistic	75.84453	
Durbin-Watson stat	1.857483	Prob(F-statistic)	0.000000	

Fig. Nr. 1: Output-i i vlerësimit në Eviews

Ndërsa output-i i modelit të regresionit jepet në figurën e mëposhtme: Koeficienti përcaktueshmërisë ($R^2=0.8975$) tregon se variablat e pavarur në regresion shpjegojnë 89.75% të ndryshimit të variablilit të varur, pra të nivelit të kthimit nga kapitali ROE. R^2 i korrigjuar është 0.8857. Në lidhje me rëndësinë statistikore të modelit ekonometrik marrim në shqyrtim treguesin F-statistic, i cili ka një vlerë $F = 75.84$ me nivel probabiliteti $p = 0.000$

çka konfirmon se modeli është i rëndësishëm statistikisht pasi kemi një vlerë të lartë të F-së dhe një probabilitet mjaft të vogël se niveli i gabimit $\alpha = 0.05$.

Treguesi statistikor që tregon autokorelacionin e gabimeve DW është i barabartë me 1.857. Kjo vlerë e treguesit është afër vlerës 2, që do të thotë se gabimet nuk shprehin autokorrelacion midis tyre, duke evidentuar pavarësinë e mbetjeve si një kusht i metodës së katrorëve më të vegjël.

Analizojmë me radhë të gjitha hipotezat e studimit sipas vlerës së p-së dhe shenjës së koeficientit për secilin varibël.

- **H0,1.** Treguesi NPL nuk ka ndikim në nivelin e ROE;
- **Ha,1.** Treguesi NPL ka ndikim në nivelin e ROE;

Koeficienti beta i treguesit NPL është - 0.4831, duke treguar se kemi një lidhje të zhdrejtë midis treguesit ROE dhe nivelit të kredive me probleme.

Pra, $p = 0.002$ (më e vogël se 0.05) tregon se vërtetohet hipoteza alternative, NPL ka ndikim në nivelin e përfitueshmërisë bankare ROE.

Faktikisht kjo lidhje është e diskutueshme pasi këto dy variabla kanë ndërvarësi të ndërsjellët: niveli i kredive me probleme ndikon në përfitueshmërinë e bankave duke ulur më pas nivelin e treguesit ROE.

(Shingjergji 2014)¹². Koeficienti beta i treguesit NPL interpretohet në këtë mënyrë: një rritje prej 1 njësi e treguesit NPL do të shkaktonte zvogëlimin me 0.4831 njësi të nivelit të ROE.

- **H0,2.** Norma e inflacionit nuk ka ndikim në nivelin e ROE;
- **Ha,2.** Norma e inflacionit ka ndikim në nivelin e ROE;

Koeficienti beta i normës së inflacionit (INF) është pozitiv 0.6690, duke treguar se kemi një lidhje të drejtë midis normës së inflacionit dhe nivelit të kthimit të kapitalit ROE. Pra, $p = 0.0315$ (më e vogël se 0.05) tregon se vërtetohet hipoteza alternative, INF ka ndikim në nivelin e përfitueshmërisë bankare ROE. Koeficienti beta i treguesit INF interpretohet në këtë mënyrë: një rritje prej 1 njësi e treguesit INF do të shkaktonte rritjen me 0.6690 njësi të nivelit të ROE.

- **H0,3.** Madhësia e bankave nuk ka ndikim në nivelin e ROE;
- **Ha,3.** Madhësia e bankave ka ndikim në nivelin e ROE;

Koeficienti beta i madhësisë së bankës është 0.1123, duke treguar se

12 Shingjergji A. 2014. Ndikimi i faktorëve makroekonomikë dhe bankarë në nivelin e kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar, Tiranë.

kemi një lidhje të drejtë midis madhësisë së bankës dhe nivelit të kthimit te kapitalit ROE. Pra, $p = 0.0214$ (më e vogël se 0.05) tregon se vërtetohet hipoteza alternative, SIZE ka ndikim në nivelin e përfitueshmërisë bankare ROE. Koeficienti beta i treguesit SIZE interpretohet në këtë mënyrë: një rritje prej 1 njësi e treguesit SIZE do të shkaktonte rritjen me 0.1123 njësi të nivelit të ROE.

- **H0,4.** Norma e kredive ndaj depozitave nuk ka ndikim në nivelin e ROE;
- **Ha,4.** Norma e kredive ndaj depozitave ka ndikim në nivelin e ROE;

Koeficienti beta i treguesit LTD është -0.5678, duke treguar se kemi një lidhje të zhdrejtë midis treguesit ROE dhe LTD. Pra, $p = 0.000$ (më e vogël se 0.05) tregon se vërtetohet hipoteza alternative, LTD ka ndikim në nivelin e përfitueshmërisë bankare ROE. Koeficienti beta i treguesit LTD interpretohet në këtë mënyrë: një rritje prej 1 njësi e treguesit LTD do të shkaktonte zvogëlimin me 0.5678 njësi të nivelit të ROE.

Ndikimi i faktorëve makroekonomikë dhe bankarë në nivelin e kredive me probleme për sistemin bankar shqiptar mund të përmbledhet në tabelën e mëposhtme:

Faktorët	Ka/S'ka Ndikim në nivelin e TKP	Shenja e Ndikimit
NPL	Ka ndikim	Negative (-)
INF	Ka ndikim	Pozitive (+)
SIZE	Ka ndikim	Pozitive (+)
LTD	Ka ndikim	Negative (-)

Tabela Nr 1: Përmbledhje e Ndikimit të Faktorëve në ROE

Përfundime

Në bazë të rishikimit të studimeve të mëparshme dhe teorive bankare, ky studim hetoi ndikimin e disa faktorëve të ndarë në faktorë specifike bankarë dhe një faktor makroekonomik në bankat tregtare shqiptare gjatë periudhës 2007-2016. Faktorët specifike bankarë që janë përdorur në këtë studim përfshijnë variabla të tilla si madhësia e bankës, treguesi i kredive me probleme dhe raporti kredi/depozita. Nga ana tjetër në këtë studim është marrë në konsideratë vetëm një faktor makroekonomik, i cili është norma e inflacionit.

Rezultatet e modelit ekonometrik treguan se kemi një lidhje të drejtë statistikisht të rëndësishme ndërmjet kthimit nga kapitali si tregues i përfitueshmërisë bankare ROE dhe faktorëve si madhësia e bankave SIZE dhe norma e inflacionit INF. Kjo do të thotë që me rritjen një njësi të secilit prej këtyre variablave, do të kemi një rritje me β njësi (koeficienti përkatës për secilin variabël) të nivelit të ROE. Kjo marrëdhënie e drejtpërdrejtë midis madhësisë së bankës dhe përfitimit tregon se bankat tregtare të mëdha performojnë më mirë se bankat tregtare të vogla për shkak se bankat e mëdha mund të përfitojnë nga ekonomitë e shkallës dhe gjithashtu me rritjen e madhësisë disa shpenzime mund të reduktohen. Ndryshe, thuhet se bankat e mëdha kanë avantazh madhësinë e tyre për të prodhuar më shumë kthim. Ndërsa ndikimi pozitiv i normës së inflacionit në ROE mund të sugjerojë se bankat tregtare arrijnë të parashikojnë nivelet e inflacionit dhe shfrytëzojnë mundësinë për të përfituar nga mjedisi inflacionist për të rritur fitimet.

Nga ana tjetër, rezultatet e modelit ekonometrik treguan se kemi një lidhje të zhdrejtë statistikisht të rëndësishme ndërmjet nivelit të ROE dhe faktorëve si treguesi i kredive me probleme dhe raporti kredi/depozita. Kjo do të thotë që me rritjen një njësi të secilit prej këtyre variablave, do të kemi një rënie me β njësi (koeficienti përkatës për secilin variabël) të ROE.

Shtimi i nivelit të kredive me probleme do të çonte bankat në një reduktim të nivelit të ROE-s.

Të dhënat e sistemit bankar shqiptar tregojnë se përfitueshmëria e matur sipas treguesit ROE ka pësuar një rënie të madhe sidomos pas viteve të krizës globale financiare të vitit 2008. Sa më shumë kredi të këqija të ketë banka aq më shumë do të reduktohet përfitueshmëria e saj.

Bibliografia

1. Allen, F., dhe Carletti, E., 2008. The Roles of Banks in Financial Systems, Përgatitur për librin: Oxford Handbook of Banking, redaktuar nga: Allen Berger, Phil Molyneux and John Wilson. Mundësohet në: <http://fic.wharton.upenn.edu/fic/papers/08/0819.pdf>
2. Athanasoglou, P. Brissimis, S. dhe Delis, M. 2008. Bank-specific. Industry-specific and macroeconomic determinants of bank profitability. Journal of International Financial Markets. Institutions and Money.

3. Athanasoglou, P.P., Sophocles, N.B. dhe Matthaïos, D.D. 2005. Bank-specific, industry-specific and macroeconomic determinants of bank profitability. Working paper, Bank of Greece.
4. Banka e Shqipërisë www.bankofalbania.org
5. Deger, A. dhe Adem, A. 2011. Bank-Specific and Macroeconomic Determinants of Commercial Bank Profitability: Empirical Evidence from Turkey. *Business and Economic Research Journal*, Vol.2, No. 2, 139-152.
6. Guru, B. K., Staunton, J. dhe Balashanmugam, B. 2002. Determinants of Commercial Bank Profitability in Malaysia. Working Paper. Multimedia University.
7. INSTAT www.instat.gov.al
8. Molyneux, P. dhe Thornton, J. 1992. Determinants of European Bank Profitability: A Note. *Journal of Banking and Finance*, 16: 1173-1178.
9. Sanni, M.R. 2009. The effects of the 2006 consolidation on profitability of Nigerian Banks. *Nigerian Research Journal of Accountancy (NRJA)*, a Publication of The Institute of Chartered Accountants of Nigeria (ICAN), Lagos, 1(1): 107-120.
10. Shingjergji A. 2014. Ndikimi i faktorëve makroekonomikë dhe bankarë në nivelin e kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar, Tiranë.
11. Staikouras, Ch. dhe Wood, G. 2003. The determinants of bank profitability in Europe, European Applied Business Research Conference, Venice.
12. Varesi L. 2016. Roli i sektorit bankar ne sistemin financiar; Durrës.
13. Wasiuzzaman, S. and Gunasegavan, U. N. 2013. Comparative study of the performance of Islamic and conventional banks. The case of Malaysia, *Humanomics*, vol.29 (1), p.43-60.

Summary

There are so many aspects of banks that can be analyzed, but this study focuses specifically on bank's profitability. The latter is a reflection of how banks are run, taking into consideration the environment in which they operate. More accurately, it reflects the quality of bank's management and stakeholder's behavior, bank's competitive strategies, efficiency and risk management capability. The determinants of bank profitability have attracted the interest of academic research, as well as that of the financial markets and bank supervisors.

The main objective of this study is to identify the internal and external factors (bank specific and macroeconomic factors) that affect the profitability of all commercial banks operating in Albania, through adequate empirical analysis. The econometric model used is that of multiple linear regression where as the dependent variable used as proxy for bank performance is obtained the Return on Equity (ROE) ratio and as independent variables are chosen a number of macroeconomic indicators and indicators of assets and liabilities of the Albanian banking system.

The results of the econometric model showed that there is a direct statistically significant link between ROE as determinant of bank profitability and factors such as Bank Size and the Inflation Rate. On the other hand, the results of the econometric model showed that there is an indirect statistically significant correlation between the level of ROE and the indicators of non-performing loans ratio and the loan to deposit ratio.

The results of the econometric model showed that there is a direct statistically significant link between ROE as determinant of bank profitability and factors such as Bank Size and the Inflation Rate. On the other hand, the results of the econometric model showed that there is an indirect statistically significant correlation between the level of ROE and the indicators of non-performing loans ratio and the loan to deposit ratio.

KOMUNIKIMI MARKETING NË KONTEKSTIN NDËRKULTUROR

M.Sc. Enxhi Marku
Kolegji Universitar “Logos”
Fakulteti Ekonomik
Departamenti Menaxhim Turizmi

Abstrakt

Për të pasur sukses në biznes dhe për të pasur një markë produkti ose shërbimi të njohur dhe të pranuar ndërkombëtarisht, duhen zhvilluar disa aftësi efektive të komunikimit ndërkulturor. Kjo vjen për shkak të arsyes se individët në varësi të kulturave të ndryshme, ndryshojnë në mënyrën se si i bëjnë dhe shohin gjërat, si mendojnë, dhe si ata sillen. Ky punim synon të diskutojë zhvillimin e një strategjie marketingu duke u bazuar tek aspektet e komunikimit ndërkulturor (duke aplikuar studimet e Hofstede dhe Hall).

Ai diskuton mbi elementët e një reklame që e bëjnë atë të ketë sukses në tregjet e huaja, elementet e ndryshme të mediave reklamuese, problemet me të cilat marketerët përballen në vende të huaja dhe diferencat ndërmjet vendeve në lidhje me kulturat e kontekstit të lartë dhe të ulët.

1. Hyrje

Ndërsa një vend zhvillohet, tregtia e tij ndërkombëtare rritet. Gjithmonë e më shumë firma po hyjnë në tregje të huaja. Dimensionet e Hofstede për kulturën janë shumë të dobishme për një organizatë kur ajo hyn në marrëdhënie tregtare me vende të huaja. Është thelbësore të kuptohen diferencat ndërmjet vendeve dhe kulturave kur bëhet biznes në tregjet

ndërkombëtare.

Dimensionet kulturore janë gjithashtu të rëndësishme në fushën e marketingut sepse ato ndihmojnë në krijimin e një strategjie të duhur marketingu. Kështu që, është e rëndësishme që një marketer të kuptojë se aspektet që janë të pranueshme në kulturën e tij mund të mos jenë të pranueshme në kultura të tjera.

Koncepti i marketingut thotë se individët në një organizatë duhet të punojnë së bashku për të kënaqur konsumatorët në këmbim të fitimit. Megjithatë, koncepti i marketingut mund të aplikohet edhe në organizatat jo fitimprurëse ku synimi nuk është fitimi por arritja e një objekti social.¹

Disa studiues besojnë tek standardizimi i marketingut, ofrimin e produkteve standarde në çdo vend ku një firmë operon, duke përfshirë edhe standardizimin e reklamave. Studiues të tjerë mendojnë se kultura ndikon në mënyrën se si individët i perceptojnë reklamat. Sipas DeMooij:

“nëse duam të dimë se si reklamimi funksionin përgjatë kulturave të ndryshme, duhet fillimisht të mësojmë se si funksionin komunikimi”². Ajo që e dallon komunikimin marketing nga llojet e tjera të komunikimit është se komunikimi marketing synon të informojë dhe të bindë.

2. Planifikimi i strategjisë marketing në një treg të huaj

“Një firmë që operon në dy tregje të ndryshme duhet të zhvillojë dy strategji marketingu të ndryshme.”³ Planifikimi i strategjisë së marketingut ka të bëjë me gjetjen e mundësive dhe zhvillimin e një strategjie marketingu.

Një strategji marketingu përmban një treg të synuar, që ka të bëjë me konsumatorët të cilëve firma do t’i shërbejë, dhe një marketing miks specifik (produkt, çmim, promocion, shpërndarje).

Vlerësimi i oportuniteteve në tregjet ndërkombëtare

Shumë firma e shohin futjen në një treg të ri ndërkombëtar si një mënyrë për të shfrytëzuar anët e tyre të forta. Mundësitë që përfshijnë tregjet ndërkombëtare përmbajnë disa sfida më specifike. Për shkak të vështirësisë

1 Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*, fq. 34.

2 DeMooij, M. 2010. *Consumer Behavior and Culture: Consequences for Global Marketing and Advertising*.

3 Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*, fq. 68.

në njohjen e variablave të mjedisit operimi në një treg ndërkombëtar mund të përbëjë më tepër risk. Ndikimi që vlerat kulturore kanë tek mënyra se si individët reagojnë ndaj marketingut miks të një firme varet edhe nga lloji i produktit. Në përgjithësi produktet e biznesit, kanë më pak nevojë që t'i përshtaten mjedisit kulturor të vendit ku ato tregtohen në krahasim me produktet e konsumit. Ato produkte mund të marketohen duke përdorur standardizimin, pra të kenë një marketing të njëjtë në të gjitha vendet ku ai tregtohet me disa ndryshime të vogla.⁴

Për shembull, disa veshje femrash shumë të përhapura në vendet perëndimore do të ishin të papranueshme në vendet arabe, ku femrat pritet që të mbulojnë kokën në disa raste edhe fytyrën. E njëjta gjë mund të thuhet në lidhje me produktet dietike, të tilla si "Diet Coke" të cilat në disa vende konsiderohen të pashëndetshme.⁵

Për vlerësimin e oportuniteteve një menaxher duhet të mbështetet tek kërkimi marketing. Mbledhja e informacionit të saktë mund të kushtojë shumë dhe të kërkojë kohë, veçanërisht në tregjet ndërkombëtare ku ai mund të jetë i paplotë ose i vështirë për t'u mbledhur. Aspektet kulturore duhen pasur parasysh edhe gjatë kërkimit marketing ku në disa kultura individët nuk janë të gatshëm të japin informacion kur intervistohen. Probleme të tilla shfaqen zakonisht në vendet e Amerikës Latine dhe në disa zona me të ardhura të ulëta në SHBA. Nëse rreziqet e hyrjes në një treg të ri janë të vështira për t'u vlerësuar, është më mirë që një firmë të hyjë në atë treg si eksportues, pra pjesa më e madhe e riskut t'i lihet ndërmjetësve.⁶

Marketingu ndërkombëtar kërkon më tepër segmentim

Ekzistojnë rreth 228 kombe të cilët ndryshojnë nga gjuha, zakonet, etika e biznesit, qëndrimet dhe trendet e shpërndarjes së të ardhurave. Kjo është një arsye që sugjeron se kur një firmë operon në tregje të huaja ajo duhet të vendosë menaxherë vendas për ata territore, për shkak se ata i njohin më mirë aspektet e kulturës së një vendi. Një individ vendas mund të dallojë një problem shumë të thjeshtë që edhe një analizë e kujdesshme e mjedisit

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, fq. 120.

⁶ Po aty.

mund mos ta nxjerrë në pah, për shkak të njohjes që ai ka ndaj tregut të synuar, eksperiencës, qëndrimeve dhe interesave të tij.⁷

Çdo treg i huaj duhet të konsiderohet si një treg i veçantë i cili ka nëntregjet e veta. Kur një firmë operon në një treg të huaj ajo duhet së pari të segmentojë tregun e saj të synuar duke u bazuar në aspektet që lidhen me vendin, ndër të cilat dhe kultura dhe më pas të përdorë dimensionet e tjera të segmentimit.⁸

3. Ndikimi i kulturës në sjelljen konsumatore

Marketingu i suksesshëm kërkon që marketerët të kenë një kuptim të plotë të konsumatorëve të tyre. Marketerët duket të krijojnë një profil 360 gradë të konsumatorëve të tyre në mënyrë që produktet e duhura të marketohen ndaj konsumatorëve të duhur. Marketerët duhet të kuptojnë të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në sjelljen konsumatore, pra faktorët që ndikojnë tek produktet dhe markat që konsumatorët zgjedhin.

“Sjellja konsumatore është studimi se si individët, grupet, dhe organizatat zgjedhin, blejnë dhe përdorin të mirat, shërbimet, idetë ose eksperiencat për të kënaqur nevojat ose dëshirat e tyre.”⁹

Një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në sjelljen konsumatore janë faktorët kulturorë. Ata shfaqin ndikimin më të gjerë dhe më të thellë në zgjedhjet që konsumatorët bëjnë. *“Kultura është një set besimesh, qëndrimesh dhe mënyrash të të bërit të gjërave të një grupi relativisht homogjen njerëzish”.*¹⁰ Faktorët kulturorë përfshijnë kulturën, nënkulturën dhe klasën sociale.

Kultura është përcaktuesi kryesor i dëshirave të një personi dhe sjelljes së tij.¹¹ Për shembull, kulturat perëndimore si ajo e SHBA karakterizohen nga vlera të tilla si arritjet dhe suksesi, individualizmi, komforti material, të qenit praktik dhe efikas, rinia dhe liria personale.¹² Një fëmijë i rritur në një kulturë perëndimore do t'i reflektojë këto vlera në sjelljen e tij. Vlerat e një kulture përkatëse reflektohen padyshim edhe në produktet që ne si konsumatorë

7 Po aty.

8 Po aty.

9 Kotler, P., & Keller, K. L. 2009. *Marketing management*.

10 Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*.

11 Kotler, P., & Keller, K. L. 2009. *Marketing management*

12 Kotler, P., & Keller, K. L. 2009. *Marketing management*

zgjedhim të blejmë. Për shembull, nuk është çudi që ekzistojnë një numër shumë i madh librash të shkruara nga amerikanë me temë “si të bëhesh i pasur”.

Marketerët duhet t’i kushtojnë rëndësi vlerave kulturore për të kuptuar se si t’i marketojnë sa më mirë produktet e tyre ekzistuese dhe për prezantimin e produkteve të reja. Injorimi i normave kulturore të një vendi gjatë përpjekjeve marketing të një firme mund të shkaktojë probleme të mëdha.

Një shembull i ndikimit të kulturës në sjelljen konsumatore është përdorimi i çajit në Angli. Tradicionalisht në kulturën britanike çaji është një element shumë i përdorur, por çuditërisht asnjë nga kompanitë që ofrojnë çajin e ftohtë nuk ka pasur sukses në këto vende. (Lipton, Nestea). Një arsye kryesore për këtë fakt është se britanikët e lidhin çajin e ftohtë me mbetjet në fund të filxhanit pasi çaji është konsumuar dhe ftohur. Një lidhje i tillë i bën ata që mos ta konsumojnë çajin e ftohtë.¹³

Shumë nevoja janë të mësuara nga kultura

Shumë nevoja të konsumatorëve janë të mësuara nga kultura. Për shembull, shumë japonezë e pëlqejnë sushin, kështu që edhe fëmijët e tyre brez pas brezi kanë mësuar ta pëlqejnë atë. Shumë kritikë besojnë se jo vetëm përpjekjet e marketingut duhet të ndikohen nga kultura e një vendi, por edhe anasjelltas, shpesh përpjekjet marketing ndikojnë në krijimin e disa normave kulturore në lidhje me preferencat rreth disa produkteve. Ata argumentojnë se marketerët i bindin individët për të shpenzuar para për produktet që nuk lidhen me nevojat e tyre bazë, por janë të mësuara gjatë jetës së individit nga kultura dhe shoqëria. Për shembull, evropianët nuk i përdorin produktet e antidjersës aq sa amerikanët. Reklama e një marke deodoranti në tregun amerikan (Ban) ka si mesazh të saj “Heq shqetësimin e të qenit pranë”. Por a është ky ndryshim kulturor i krijuar nga përpjekjet e marketingut?¹⁴

Sjellja blerëse e konsumatorëve biznese dhe kultura

Një firmë mund të vendosë që t’i ofrojë produktet e saj konsumatorëve biznese në një treg të huaj. Në këtë rast duhen studiuar zakonet e të bërit

¹³ *The Wall Street Journal*. 1994.

¹⁴ Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*.

biznes në tregun specifik. Përveç diferencave të dukshme në gjuhë, ekzekutivët e biznesit që vijnë nga vende të ndryshme përballen me disa barriera për të komunikuar në mënyrë efektive për shkak se ritmi i negocimit mund të ndryshojë midis vendeve. Për shembull, negociatat e bëra nga amerikanët shpesh janë të përsheptuara, ndryshe nga stili i negocimit në disa vende të tjera ku theksi vihet tek ndërtimi i marrëdhënieve përpara se të mbyllet një marrëveshje biznesi.¹⁵ Zakonet e biznesit mund të jenë të ndryshme në vende të ndryshme. Për shembull, japonezët e konsiderojnë si të pasjellshme mbajtjen e shënimeve pas kartës së biznesit të një firme apo individit apo futjen e saj në çantë përpara se ai të largohet.¹⁶

Në përgjithësi, kultura ndikon më pak tregjet e biznesit në krahasim me ato të konsumit. Kjo do të thotë se marketingu miks i një firme që ofron produkte biznesi në tregje ndërkombëtare mund të jetë më i ngjashëm midis vendeve.¹⁷

4. Komunikimi marketing në kontekstin ndërkulturor

I njëjti mesazh mund të interpretohet në mënyra të ndryshme

Sloganet dhe elementët e markës së një firme ndërkombëtare i ndihmojnë marketerët që të krijojnë një identitet marke të njohur ndërkombëtarisht.

Gjatë komunikimit marketing, i njëjti mesazh mund të shihet dhe interpretohet në mënyra të ndryshme nga audienca të ndryshme, gjë e cila është më e zakonshme në marketingun ndërkombëtar, ku shfaqen probleme kulturore dhe probleme që kanë të bëjnë me përkthimin. Veçanërisht është e vështirë që sloganet të përkthehen në gjuhë të ndryshme dhe të përmbajnë të njëjtën nuancë kuptimore. Ekzistojnë disa shembuj të dështimeve të marketingut për shkak të problemeve të kësaj natyre. Për shembull slogani i Pepsi, ishte «Pepsi iu bën të ndiheni të gjallë», ndërsa në Taivan kur u përkthye në gjuhën e këtij vendi ai kishte kuptimin «Pepsi ngre paraardhësit tuaj nga varri»¹⁸

Mediat e komunikimit

15 Brian, B. 2017. *What Are Some Challenges That Firms Face for International Marketing?*

16 Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*.

17 Po aty.

18 Po aty.

Në disa tregje ndërkombëtare mediat tradicionale të komunikimit mund të jenë të kufizuara kështu që kompanitë duhet të gjejnë një mënyrë të përshtatshme për të komunikuar mesazhet e tyre. Për shembull, Coca-Cola në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme përdori disa reklama në formë tullumbacesh. Një shembull tjetër është Ariel, i cili vendosi një bluzë në një ndërtesë në Kinë për të komunikuar mesazhin e tij.



Reklama e Coca-Cola në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme dhe Ariel në Kinë – forma origjinale të komunikimit marketing

Reklama dhe vendimet e strategjisë marketing

Krijimi i një reklame efektive kërkon një kuptim të thellë të audiencës së synuar. Gjithashtu, në një treg të huaj, duhen marrë parasysh rregullat qeveritare në lidhje me reklamimin. Tipi i mesazheve që do të transmetohen mund të kufizohet nga faktorët kulturorë, prandaj është e këshillueshme që për krijimin e reklamave të një treg të huaj të bashkëpunohet me një agjenci reklamash vendase e cila i njeh mirë zakonet kulturore të vendit specifik.¹⁹

Shpesh përdoret humori në reklama për të tërhequr vëmendjen e konsumatorëve dhe prospektëve. Megjithatë, ekzistojnë diferenca për sa i përket elementëve që konsiderohen humoristikë në kultura të ndryshme. Një element që konsiderohet gazmor në një kulturë ka një probabilitet të lartë që të konsiderohet ngatërrues, në disa raste edhe ofendues në një kulturë tjetër. Në mënyrë që prodhimi i reklamave të jetë efektiv, përkthimi i mesazhit të

¹⁹ Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*.

reklamës nga një gjuhë në një tjetër duhet të jetë i përshtatshëm dhe kjo kërkon një kuptim të thellë të normave morale, zakoneve dhe kulturës që dominon në një vend specifik.²⁰

Promocioni i shitjes

Promocioni i shitjes ka të bëjë me të gjitha metodat promocionale që synojnë të nxisin shitjet afatshkurtra, të tilla si dhënia e mostrave dhe kuponëve falas, çmimet promocionale dhe ofertat e ndryshme të cilat synojnë të nxisin provën ose blerjen e menjëhershme. Promocioni i shitjeve mund të bëhet ndaj konsumatorëve finalë, ndërmjetësve ose punonjësve të një firme.

Në tregjet ndërkombëtare mund të lindin disa probleme përse i përket promocionit të shitjeve për shkak të diferencave ndërmjet vendeve. Për shembull, në Japoni dyqanet e shitjes me pakicë kanë një sipërfaqe shumë të vogël, kështu që krijohet më pak mundësi për ekspozimin e produkteve në anët e rafteve të super-marketeve, ku ata janë më të dukshëm.

Për shkak të diferencave kulturore mund të lindin probleme edhe tek promocioni ndaj tregjeve të konsumatorëve. Një shembull, i këtyre problemeve është rasti i konsumatorëve polakë të cilët nuk e shohin pozitivisht dhënien e mostrave falas gjatë një promocioni për shkak se ata mendojnë se çdo gjë e dhënë falas mund të jetë defekte.

Shitja personale

Edhe teknikat e shitjes personale ndryshojnë nga një vend në një tjetër. Shitësit mund të përshtatin mesazhin e tyre ndaj kulturës dhe aspekteve të tjera që ndikojnë në sjelljen blerëse të konsumatorëve. Për shembull, një japonez dhe një arab mund të presin sjellje të ndryshme nga një person shitjesh. Arabët në përgjithësi mbajnë vetëm një distancë të vogël fizike gjatë komunikimit. Ndërsa një japonez do ta konsiderojë këtë si të pasjellshme. Gjithashtu, gjatë shitjes personale duhen marrë parasysh diferencat ndërmjet kulturave në lidhje me stilin e negocimit dhe mënyrën se si mesazhe interpretohen në kultura të ndryshme.²¹

20 Brian, B., 2017. *What Are Some Challenges That Firms Face for International Marketing?*

21 Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*.

Paketimi dhe etiketimi i produktit

Paketimi i një produkti është elementi që bën lidhjen ndërmjet produkti dhe promocionit. Tek paketimi i produkteve janë të pranishme edhe elementët e markës madje shpesh edhe elementë nga reklamata e saj. Sot gjithmonë e më shumë po vihet theksi tek paketimi me materiale që nuk ndotin mjedisin. Edhe detajet e paketimit duhet të theksohen në reklama. Është e këshillueshme që për një produkt ka një markë ndërkombëtare etiketimi i produkti të jetë në disa gjuhë.²²

Shitja e emrit të markës është shpesh e vështirë

Shitja e emrit të markës është një nga sfidat më të mëdha kur zhvillohet një strategji marketingu për një treg të huaj. Për shembull, fakti se markat amerikane janë të njohura në të gjithë botën për shkak të filmave dhe Internetit nuk do të thotë se produktet amerikane do të jenë popullore sapo futen në tregje të huaja. Fitimi i besimit të konsumatorëve që përdorin produktet vendase mund të jetë një proces i gjatë dhe i kushtueshëm për shkak se ata e perceptojnë si një përpjekje për të zënë vendin e kompanive vendase nga kompanitë e huaja.²³

Dimensionet e Hosftede për kulturën dhe komunikimi marketing

Distanca e pushtetit

Distanca e pushtetit përkufizohet si “niveli në të cilin anëtarët më pak të fuqishëm të shoqërisë pranojnë dhe presin që fuqia të shpërndahet në mënyrë jo të barabartë”.²⁴ Në kulturat me distancë të lartë të pushtetit ndër motivet kryesore që motivojnë sjelljen konsumatore është nevoja për status. Kjo mund të shprehet në reklamimin e mallrave të luksit, modës dhe në elementin e respektit në reklama.

Vlerat mashkullore ndaj vlerave femërore

Mashkulloriteti i referohet faktit nëse vlerat mashkullore si ambicia, suksesi, performanca, arritjet janë dominante në një kulturë.²⁵ Në kulturat

22 FAO, F. 2017. *Chapter 8: Product Decisions*.

23 Brian, B. 2017. *What Are Some Challenges That Firms Face for International Marketing?*

24 DeMooij, M., 2010. *Consumer Behavior and Culture: Consequences for Global Marketing and Advertising*.

25 Hofstede G. 1998. *Masculinity and Femininity: The Taboo Dimension of National Cultures*.

me dominancë të vlerave mashkullore reklamat kanë tendencë të theksojnë arritjet, të shprehura tek markat e luksit, ndërsa ato me theks në vlerat femërore theksojnë sigurinë dhe mbrojtjen.²⁶

Kulturat e ndryshme dallohen edhe nga roli i grave në shoqëri dhe aspekte që lidhen me barazinë gjinore. Për shembull, japonezët janë një popull që i përdorin shumë pajisjet teknologjike, por vetëm 7% e shtëpive japoneze kanë një lavastovilje, krahasuar me 50% të amerikanëve. Një arsye për këtë fakt është se japonezët kanë shtëpi me ambiente më të vogla. Një arsye tjetër është se ushqimet tradicionale japoneze kanë tendencë të jenë shumë ngjitëse gjë që i bën ato të vështira për t'u pastruar nga një lavastovilje e zakonshme. Për këto arsye kompanitë që janë futur në këtë treg kanë zhvilluar lavastovilje më të vogla dhe që pastrojnë më mirë këto lloj ushqimesh. Por ka edhe një pengesë tjetër që lidhet me kulturën: për shumë japonezë është detyrë e gruas që të lajë enët dhe gratë në Japoni ndiheshin në faj që një makineri do të bënte «punën e tyre». Shumë firma të huaja nuk e kishin kuptuar këtë fakt, por kjo u vërtetua kur Matsushita, një firmë japoneze rriti shitjet e saj duke e fokusuar promocionin jo tek kursimi i kohës por tek kursimi i ujit të nxehtë dhe higjiena.²⁷ Një shembull tjetër i ngjashëm në tregun japonez ka të bëjë me pelenat e bebeve. Kur P&G hyri në tregun japonez produktet e saj të kësaj kategorie nuk patën sukses megjithëse ishin shumë të përshtatshme në përdorim dhe i kursenin kohë nënës. Megjithatë gratë japoneze e kishin shumë të theksuar ndjenjën ndaj përkushtimit total ndaj fëmijës dhe kishin një ndjenjë faji nëse përdornin këto produktet. Firmat që u futën më pas në këtë treg nuk vinin më theksin tek lehtësia në përdorim dhe kursimi i kohës gjatë promocionit por tek fakti se ato ishin më të shëndetshme për bebet.

Shmangie e pasigurisë

Shmangja e pasigurisë ka të bëjë me “nivelin në të cilin njerëzit ndihen të kërcënuar nga pasiguria dhe dykuptimësia dhe përpiqen të shmangin situatat me pasiguri të lartë”.²⁸ Vendet me nivel të lartë të këtij variabli kanë

26 DeMooij, M., & Hofstede. 2010. *The Hofstede model: Applications to global branding and advertising strategy and research*.

27 The Wall Street Journal. 2000. Overcoming the Stigma of Dishwashers in Japan.

28 DeMooij, M. 2010. *Consumer Behavior and Culture: Consequences for Global Marketing and Advertising*.

një komunikim më formal dhe kanë tendencë të shmangin konfliktet dhe konkurrencën. Reklamata që i drejtohen këtyre kulturave duhet të japin një informacion më teknik dhe demonstrime të shumta.

Ndërsa vendet të cilat kanë nivele të ulëta të këtij variabli pranojnë më mirë produktet inovative. Reklamata që i drejtohen këtyre kulturave përdorin më tepër humorin në reklama (DeMooij). Individët në këto vende i kushtojnë më tepër rëndësi rezultateve që vijnë nga përdorimi i produktit se sa aspekteve teknike të tij.

Individualizmi ndaj kolektivizmit

Ky element i një kulture është veçanërisht i rëndësishëm sepse sjelljet individualiste mund të shihen si shprehje të egoizmit në kulturat kolektivistë. Sipas DeMooij, ndryshimi ndërmjet kulturës kolektivistë dhe asaj individualiste është se “njerëzit që kujdesen për veten dhe vetëm për familjen e tyre të afërt, ndaj njerëzve që bëjnë pjesë në grupe që kujdesen për ta në këmbim të besnikërisë”.²⁹

Në kulturat kolektivistë individët janë të integruar në grupe që u sigurojnë atyre mbrojtje në këmbim të besnikërisë. Ata përdorin “ne” në vend të «unë» më tepër gjatë komunikimit. Ndërsa kulturat individualiste përdorin më tepër «ti» dhe «unë».

Në kulturat individualiste, theksi në reklama duhet vendosur më tepër tek privatësia individuale, ndërsa në kulturat kolektivistë theksi duhet vendosur tek vlera të tilla si familja, përfitimet e përbashkëta dhe harmonia.

Diferencat ndërmjet vendeve në lidhje me informacionin me kontekst të ulët dhe të lartë

Studimet e Hall kanë eksploruar gjerësisht konceptet e kontekstit të lartë dhe të ulët. Konceptet e kontekstit të ulët dhe të lartë përcaktojnë se si individët e zhvillojnë komunikimin në kultura të ndryshme. Diferencat kanë të bëjnë me nivelin në të cilin mesazhi transmetohet nëpërmjet fjalëve ose implikimeve të tyre në një kontekst të caktuar. Konteksti i lartë do të thotë se shumica e informacionit të pashprehur hapur, mund të kuptohet nga kuptimi

²⁹ DeMooij, M., & Hofstede. 2010. *The Hofstede model: Applications to global branding and advertising strategy and research*.

i fshehur simbolik i fjalëve. Njerëzit që ndodhen në kulturat me kontekst të lartë për shembull në Arabinë Saudite shpesh i japin rëndësi të madhe besnikërisë dhe marrëdhënieve afatgjata dhe gjithashtu kanë tendencë të kenë më pak strukturë dhe rregulla.³⁰

Nga ana tjetër, në kulturat me kontekst të ulët të tilla si Mbretëria e Bashkuar, shkëmbimi i informacionit është në pjesën më të madhe i shprehur. Njerëzit në një kulturë të tillë rrallë shprehin informacion ose bëjnë ndonjë shkëmbim të fshehur të informacionit. Për më tepër, njerëzit në kulturat me kontekst të ulët ndjekin rregullat në mënyrë korrekte dhe zbatojnë me kujdes dhe saktësi standardet. Ata gjithashtu kanë tendencë të vlerësojnë më pak marrëdhëniet afatshkurtra dhe janë shumë të orientuar nga detyrat.

Kështu që është e domosdoshme për një marketer që të kuptojë ndryshimet që lidhen me kontekstin në një kulturë të huaj për shkak se kjo do tëndihmojë në ndërtimin e marrëdhënieve dhe lidhjeve shumë të forta me individët e asaj kulture dhe do të jetë në gjendje për të përshtatur stilin e komunikimit të tij shpejt dhe në mënyrë efektive.³¹

Disa nga problemet me të cilat një marketer mund të përballët kur bën biznes në një kulturë me një kontekst të lartë si Lindja e Mesme, Japoni ose Meksika përfshijnë keqkuptimet gjatë shkëmbimit të informacionit, një sasi të madhe informacioni të dhënë jo verbalisht për shembull pauzat, shprehjet e fytyrës dhe mimikën.³² Nga ana tjetër, kur bëhet biznes në kultura me kontekst të lartë si SHBA, Zvicër dhe Gjermani, marketeri do të përballët me aspekte të tilla si dhënia e gjithë informacionit në mënyrë të shprehur, dhënia me fjalë të një gane të gjerë shpjegimesh dhe informacionesh, ndërsa kontratat kanë tendencë të jenë shumë të detajuara dhe të gjata.

Stereotipat dhe ndryshimi

Pavarësisht normave dominuese të një kulture duhet pasur parasysh që mos të bihet në kurthin e stereotipave gjatë profilizimit të konsumatorëve dhe një marketer duhet të jetë gjithmonë i informuar përsa i përket ndryshimeve të mund të ndodhin në tregjedhe normave apo zakoneve kulturore që mund të konsiderohen të vjetërsuara. Për shembull, mund të mendohet se

30 Mathew, M. 2010. *Cross-Cultural Communication Styles: High and Low Context*.

31 Mathew, M. 2010. *Cross-Cultural Communication Styles: High and Low Context*.

32 Po aty.

një ekzekutiv tipik japonez punon me orë të gjata dhe nuk i kushton shumë kohë familjes, megjithatë kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë. Zhvillimi i një marketingu miks kërkon një kuptim real të tregut të synuar dhe forcave që ndikojnë tek sjellja e tij.³³

5. Zhvillimi i planeve marketing inovative për tregjet ndërkombëtare

Në rastet kur diferencat kulturore ndërmjet vendeve ku një firmë synon të tregtojë produktet e saj janë shumë të mëdha, ajo duhet t'i delegojë një pjesë të madhe të punës së planifikimit menaxherëve lokalë, ose edhe ndërmjetësve. Atyre duhet t'i lihet mjaftueshëm lirshmëri në planifikim pasi në disa raste, menaxherët lokalë krijojnë plane marketing të cilat kuptohen me vështirësi nga drejtimi qendrori firmës. Planet që ata krijojnë duhet të maten rreptësisht nga rezultatet që ato sjellin. Atyre duhet t'u kërkohej respektim të kufizimeve buxhetore dhe rezultatetë planit të krijuar nga vetë ta.³⁴

Konkluzione

Sjellja konsumatore ndikohet nga faktorët kulturorë (kultura, nënkultura dhe klasa sociale). Kërkimi marketing në lidhje me aspektet kulturore të konsumatorëve mund të sigurojë të dhëna në lidhje me arritjen dhe shërbimin sa më të mirë ndaj konsumatorëve.

Ky punim diskutoi aspektet e krijimit të një strategjie marketingu në kontekstin ndërkulturor duke u bazuar në studimet e Hofstede për kulturën. Komunikimi ndërkulturor luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një strategjie marketingu në çdo vend. Mesazhet e reklamave duhet të jenë të vështira për t'u injoruar dhe harruar veçanërisht nëse ato janë realizuar saktë. Për këtë arsye, për t'u siguruar që reklama është efektive, duhet të ketë një kuptim të duhur kulturor të vendeve. Komunikimi ndërkulturor luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një strategjie marketingu në çdo vend.

Kuptimi i komunikimit ndërkulturor i siguron një biznesi krijimin e një strategjie që është e pranueshme dhe e gjerë, duke krijuar në këtë mënyrë një markë ndërkombëtare.

33 Robert M. March. *The Honourable Customer: Marketing and Selling to the Japanese in the 1990s*.

34 Perreault, W. D. & McCarthy, E. J. 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*.

Bibliografia

1. "Overcoming the Stigma of Dishwashers in Japan," *The Wall Street Journal*, May 19, 2000
2. "Will the British Warm Up to Iced Tea? Some Big Marketers Are Counting on It," *The Wall Street Journal*, August 22, 1994
3. Brian, B., 2017. *What Are Some Challenges That Firms Face for International Marketing?* [ONLINE] E disponueshme: <http://smallbusiness.chron.com/challenges-firms-face-international-marketing-3356.html>. [Aksesuar 28 mars 2017].
4. *Business Studies*, 41, 1339-46
5. Cóbhan, C., 2017. *What is a Marketing Strategy? Definition, Best Practices, Tactics*. [ONLINE] E disponueshme: <http://www.docurated.com/knowledge/marketing-strategy-definition-best-practices-tips>. [Aksesuar 28 Mars 2017].
6. DeMooij, M., 2010. *Consumer Behavior and Culture: Consequences for Global Marketing and Advertising*
7. FAO, F., 2017. *Chapter 8: Product Decisions*. [ONLINE] E disponueshme: <http://www.fao.org/docrep/w5973e/w5973e0c.htm>. [Aksesuar 28 Mars 2017].
8. Hofstede G., 1998. *Masculinity and Femininity: The Taboo Dimension of National Cultures*
9. Hofstede, G. (2010). The GLOBE debate: Back to relevance. *Journal of International*
10. Jason, J., 2015. *Why TV Is Still the Most Effective Advertising Medium – Adweek*. [ONLINE] E disponueshme: <http://www.adweek.com/tv-video/why-tv-still-most-effective-advertising-medium-165247/>. [Aksesuar 28 Mars 2017].
11. Kotler, P., & Keller, K. L. (2009). *Marketing management*
12. Lars, L., 2017. *International Marketing*. [ONLINE] E disponueshme: https://www.consumerpsychologist.com/international_marketing.html. [Aksesuar 28 Mars 2017].
13. Mai, M., 2015. *Global Retail: The Biggest Challenges to Overcome When Selling Internationally - CPC Strategy*. [ONLINE] E disponueshme: <http://www.cpcstrategy.com/blog/2015/04/global-retail-biggest-challenges-overcome-selling-internationally/>. [Aksesuar 28 Mars 2017].
14. Mathew, M., 2010. *Cross-Cultural Communication Styles: High and Low Context*. [ONLINE] E disponueshme: <https://www.communicaid.com/cross->

cultural-training/blog/high-and-low-context/. [Aksesuar 28 Mars 2017].

15. Novagraaf, N., 2017. *Protecting your brand identity: slogans, phrases and other taglines*. [ONLINE] E disponueshme: <http://www.novagraaf.com/en/services/trademarks-are-an-important-part-of-our-daily-lives/slogans-and-taglines-increasing-brand-name-recognition>. [Aksesuar 28 Mars 2017].

16. Perreault, W. D. & McCarthy, E. J., 2002. *Basic Marketing: a managerial approach*. Homewood, Ill: R.D. Irwin.

17. Queensland, Q., 2016. Types of advertising | Business Queensland. 2016. *Types of advertising*. Business Queensland. [ONLINE] E disponueshme: <https://www.business.qld.gov.au/running-business/marketing-sales/marketing-promotion/advertising/types>. [Aksesuar 28 Mars 2017].

18. Robert M. March, *The Honourable Customer: Marketing and Selling to the Japanese in the 1990s* (Melbourne, Vic.: Longman Professional, 1990).

19. Tronvig, T., 2017. *What is marketing strategy?*. [ONLINE] E disponueshme: <http://www.tronviggroup.com/marketing-strategy/>. [Aksesuar 28 Mars 2017].

Summary

Customer behaviour is affected by cultural factors (culture, subculture and social class). Marketing research about the cultural factors of the customer behaviour can provide with data about the reaching and serving customers in the best way possible.

This study discussed the aspects of creating a marketing strategy in the intercultural context while using as reference the studies of Hofstede about culture. Intercultural communication plays an important role in the development of a marketing strategy in any country.

The messages of the ads need to be understood the right way by the audiences. For this reason, in order to assure that an ad is effective, the right understanding of local cultures is needed. The understanding of intercultural communication enables a business to create a strategy which is acceptable and comprehensive, as a result creating an international brand.

ZBATIMI I PARIMIT TË KUJDESIT NËPËRMJET NJOHJES SË PROVIZIONEVE NË SHQIPËRI

M.Sc. Enida Abazi^a

Dr. Rezart Demiraj^b

^a Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Menaxhim Biznesi

^b Universiteti i Tiranës

Fakulteti Ekonomik

Abstrakt

Kompanitë shqiptare kanë prirjen të zbatojnë një kontabilitet të orientuar më shumë ndaj kërkesave të legjislacionit fiskal dhe jo sipas standardeve kombëtare apo ndërkombëtare të kontabilitetit. Shkaqet e një prirjeje të tillë lidhen me një traditë të gjatë shumëvjeçare të profesionit kontabël, i cili i raportonte kryesisht shtetit, ishte pronari i ekonomisë së centralizuar dhe rrjedhimisht edhe përdoruesi kryesor i informacionit kontabël. Edhe sot, pavarësisht ndryshimit të realitetit politik, tendenca për të raportuar kryesisht për shtetin, apo për ta konsideruar shtetin si përdoruesin kryesor të informacionit është ende e fortë. Kjo bën që elementë mjaft të rëndësishëm për cilësinë e informacionit kontabël, por që jo detyrimisht konsiderohen si të tillë nga autoritetet tatimore, të neglizhohen nga njësitë ekonomike e të trajtohen si të dorës së dytë.

Elementë të tillë mund të gjenden mjaft, por më së shumti ato që preken në radhë të parë janë aspekte të trajtimit kontabël që kanë të bëjnë me gjykimin dhe në veçanti me kujdesin. Shembuj të këtyre aspekteve janë

provizionet dhe zhvlerësimet e aktiveve. Meqenëse për një kohë të gjatë provizionet dhe zhvlerësimet e aktiveve nuk janë marrë në konsideratë nga autoritetet tatimore për efekt të llogaritjes së rezultatit të tatueshëm, shumë prej njësive ekonomike e kanë parë të udhës të mos i njohin fare ato.

Nisur nga një konstatim i tillë, kemi zgjedhur të hetojmë sesa zbatohet parimi i kujdesit në Shqipëri, veçanërisht lidhur me këta dy elementë, provizionet dhe zhvlerësimin e aktiveve (kryesisht të llogarive të arkëtueshme).

Hyrje

Qëllimi kryesor i kontabilitetit është dhënia e informacionit kontabël të besueshëm dhe transparent për të gjitha palët e interesuara (përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm), duke qenë se ky informacion ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në vendimmarrjen ekonomike. Për të dhënë një pamje sa më të vërtetë e të sinqertë të situatës financiare të njësive ekonomike janë hartuar një sërë parimesh të cilat udhëheqin profesionistin kontabël në punën e tij. Një ndër këto parime është *parimi i kujdesit*. Që nga viti 2008 hartimi i pasqyrave financiare në Shqipëri i nënshtrohet kërkesave të Ligjit Nr.9228 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”. Ky ligj përcakton si të detyrueshme për zbatim Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për shumicën e njësive ekonomike, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për kategori të caktuara të njësive ekonomike. Duke qenë se përdorimi i standardeve në kontabilitet është një eksperiencë e re për realitetin shqiptar dhe duke qenë se vijmë nga një trashëgimi shumëvjeçare kur kontabiliteti bazohet në rregulla të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme me ligj, atëherë natyrshëm lind pyetja se deri në ç’ masë njihen dhe zbatohen standardet në Shqipëri, e në veçanti parimi i kujdesit.

Provizionet janë detyrime aktuale, për të cilat koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Në përgjithësi, me pak përjashtime, provizionet shoqërohen me njohjen e shpenzimeve në periudhën raportuese në shumë të njëjtë me provizionin. Për njohjen e provizioneve lind nevoja e ushtrimit të gjykimit dhe e kryerjes së vlerësimeve, të cilat përgjithësisht bëhen duke iu referuar eksperiencës së periudhave të kaluara dhe, në disa raste, duke iu referuar raporteve të ekspertëve të pavarur të fushave përkatëse. Kur provizioni përfshin shumë elementë, vlerësimi merr në konsideratë koeficientët e

probabilitetit për të gjitha rezultatet e pritshme.

Nga ana tjetër, sipas standardeve një *zhvlerësim* i aktiveve konsiderohet se ka ndodhur kur vlera kontabël neto e tyre është më e madhe se shuma e rikuperueshme prejtyre. Faktorët që mund të çojnë në situata të tilla mund të jenë të shumtë e të larmishëm. Por standardet listojnë disa tregues që mund të jenë sinjali një zhvlerësim të tillë. Ngjashëm provizioneve, edhe zhvlerësimi në përgjithësi shoqërohet me njohjen e një shpenzimi në rezultatin e periudhës raportuese kur ka ndodhur kyzhvlerësim.

Duke qenë se përgjithësisht njohja e provizioneve dhe e zhvlerësimeve të aktiveve, lidhet me rëndimin e periudhës me shpenzime, kjo është dhe arsyeja pse autoritetet tatimore janë ngurruese në njohjen e tyre për efekte tatimore, ose të paktën jo para se të jenë plotësuar një sërë kushtesh mjaft rigoroze. Gjithsesi, gjykojmë se kjo kurrresi nuk mund të jetë arsye e mjaftueshme për mosnjohjen e tyre nga ana e njësive ekonomike. Kuptohet që një neglizhim në njohjen e një provizioni apo të një zhvlerësimi çon në mënyrë të pashmangshme në një paraqitje të nënvlerësuar të detyrimeve dhe të mbivlerësuar të aktiveve, gjë që bie ndesh me parimin e kujdesit dhe dëmton seriozisht cilësinë e informacionit kontabël.

Pra pyetja të cilës ky punim synon t'i japë përgjigje është: Sa zbatohet parimi i kujdesit nga njësitë ekonomike shqiptare? Çfarë na tregon lidhur me këtë një vëzhgim paraprak i pasqyrave financiare. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, kemi analizuar pasqyrat financiare vjetore të një numri njësish ekonomike shqiptare, për të hetuar nëse paraqitet në to zëri i provizioneve (në pasivet e BK) dhe i zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme (në aktivet e BK ose në shënimet shpjeguese).

Provizionet më të shpeshta dhe më të aplikuara në praktikë janë ato që lidhen me çështje gjyqësore dhe shitjet me garanci. Për këtë arsye kemi zgjedhur disa kompani të cilat kanë më shumë gjasa të realizojnë shitje me garanci si p.sh. tregtimi i pajisjeve elektro-shtëpiake, i pajisjeve elektronike, etj. Ndërsa për provizionimin nga çështje gjyqësore mund të preken të gjitha llojet e kompanive pavarësisht aktivitetit të tyre ekonomik. Kemi gjykuar që provizionet e tjera janë jashtë realitetit shqiptar dhe më të rralla, prandaj kemi vendosur të zgjedhim provizionet e përmendura më lart. Lidhur me zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme kemi qenë të vëmendshëm ndaj

vlerave të larta të këtij zëri në PF apo vlerave që vijnë në rritje nga viti në vit.

Rishikimi i literaturës

Parimi i Kujdesit është një nga parimet më të diskutuara nga kontabilistët pasi ka tendencën të pasqyrojë anën më pesimiste të zhvillimit ekonomik të një njësie ekonomike. Ka shumë diskutime përsa i përket zbatimit të këtij parimi dhe shumë kontabilistë mund të japin opinione në mbështetje të kontabilitetit konservator i cili zbaton këtë parim. Një literaturë e gjerë tenton të japë shpjegime dhe përgjigje përsa i përket përfitimeve dhe mangësive që ofron ky parim. Disa studiues thjesht kanë dhënë kontribut në zhvillimin e anës konceptuale të këtij parimi, ndërsa studiues të tjerë kanë mbledhur të dhëna empirike. Sterling (1970) e vlerëson konservatorizmin si një nga parimet me ndikimin më të madh në vlerësimin kontabël.

Parimi i kujdesit apo kontabiliteti konservator nënkupton që kur kontabilisti ndodhet përballë një situatë me disa rrugëzgjidhje, ai duhet të japi përparësi në zgjedhje asaj rruge që të çon në rezultate konservatore (Moore, 1972).

Sipas parimit të kujdesit kontabilistët duhet të mos synojnë njohjen e parakohshme të të ardhurave por duhet të jenë vigjilent në provizionimin e të gjitha humbjeve (Chambers, 1996). Kontabilisti duhet të verifikojë shumë më tepër njohjen e të ardhurave sesa të shpenzimeve (Basu 1997).

Tradicionalisht parimi i kujdesit është reflektuar në kontabilitet nga proverba: mos parashiko fitimin, por parashiko të gjitha humbjet (Bliss 1924). Të mos parashikosh fitimet do të thotë të mos njohësh të ardhurat përpara se të kesh një pretendim ligjor ndaj të ardhurave që do tasjellin këtë fitim. Pra, qasja konservative është asimetria në kërkimin e verifikimit të fitimit dhe të humbjeve (Ross L. Watts 2002).

Kuptimi i parimit të kujdesit në kontabilitet dhe zbatimi i tij sipas IFRS

Ky parim kërkon që shpenzimet dhe detyrimet të regjistrohen sa më shpejt që të jetë e mundur, ndërsa të ardhurat, kur ato të realizohen. Ky parim njihet ndryshe edhe si parimi i konservatorizmit. Pra, sipas këtij parimi nuk duhet mbivlerësuar njohja e të ardhurave dhe nuk duhet nënvlerësuar njohja e shpenzimeve. Gjithashtu duhet treguar kujdes në rivlerësimin në rritje të aktiveve dhe rivlerësimin në rënie të detyrimeve.

Një tjetër këndvështrim për parimin e kujdesit ka të bëjë me regjistrimin e të ardhurave kur është e sigurt që do të përfitohen dhe regjistrimin e shpenzimeve apo detyrimeve kur është e mundshme që do të realizohen. Gjithashtu ky parim kërkon rivlerësim të aktiveve nëse i ka rënë vlera dhe rivlerësim të detyrimeve nëse i është rritur vlera. Pra, tendenca e parimit të kujdesit është të shtyhet njohja e të ardhurave deri kur transaksioni për ndodhjen e tyre të jetë i sigurt.

Parimi i kujdesit gjen zbatim në mjaft situata. Kështu për shembull, borxhi i keq shfaqet në pjesën më të madhe të bizneseve, kështu që duke ndjekur parimin e kujdesit duhet krijuar një kundër llogari për llogaritë e arkëtueshme e quajtur Zbritje nga Llogaritë e Arkëtueshme ose Zhvlerësim i Llogarive të Arkëtueshme. Kjo kundërllogari e ul vlerën neto të llogarisë Llogari të Arkëtueshme duke paraqitur vetëm atë vlerë e cila është e sigurt se do të arkëtohet nga klientët dhe parandalon mbivlerësimin e kësaj llogarie. Nga ana tjetër, llogaria Shpenzime për Borxhine Keq ul të ardhurat neto që njihen për periudhën dhe nuk i paraqet ato të mbivlerësuar. Provizionet janë detyrime aktuale që mbartin pasiguri lidhur me kohën dhe shumën e shlyerjes duke qenë të kushtëzuara nga ngjarje të ardhshme si p.sh. vendimi përfundimtar i dalë nga një proces gjyqësor. Në raste të tilla vlerësohet probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes dhe nëse mundësia e ndodhjes është më e madhe se mundësia e mosndodhjes, njihet një detyrim dhe një shpenzim në të njëjtën vlerë. Edhe në këtë rast duke zbatuar parimin e kujdesit shpenzimet dhe detyrimet nuk nënvlerësohen. Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare e nënkuptojnë zbatimin e parimit të kujdesit në mjaft situata dhe raste, pavarësisht se jo gjithmonë e citojnë drejtpërdrejt këtë parim. Ky parim gjen zbatim në njohjen e të ardhurave në përgjithësi, dhe në veçanti të kontratave të ndërtimit që priten të përmyllen me humbje për njësinë ekonomike. Po në zbatim të këtij parimi-trajtim jo të njëjtë i bëhet aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara, ku përparësi i jepet pasiveve të kushtëzuara. Në modelin e njohjes së aktiveve me kosto të amortizuar, rëniet në vlerë mund të njihen menjëherë, ndërsa rritjet në vlerë lejohet të njihen vetëm nëse ato realizohen, pra në shitje. Por edhe në modelin e rivlerësimit të aktiveve afatgjata, rëniet në vlerë lejohet të njihen në rezultat, ndërsa rritjet në vlerë lejohet vetëm të njihen si plusvlerë kapitali.

Argumentet pro dhe kundër zbatimit të parimit të kujdesit në kontabilitet

Lidhur me zbatimin e parimit të kujdesit ka argumente pro dhe kundër:

Argumentet kundër

1. Zbatimi i parimit të kujdesit besohet se cenon cilësinë e neutralitetit dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare.
2. Disa mendojnë se, ndërkohë që transparenca në raportim është e rëndësishme, paraqitja e informacionit duhet të jetë neutrale si kundrejt pritshmërive pozitive ashtu edhe kundrejt atyre negative.
3. Në rastet kur përballen me pasiguri do të ishte e dëshirueshme që drejtimi të bënte një vlerësim sa më të mirë të mundshëm, jo detyrimisht pesimist, duke paraqitur edhe bazën për këtë vlerësim.
4. Kur vihen përballë argumentit se konservatorizmi në njohjen e përfitimeve të një periudhe është i dëshirueshëm, kundërshtarët e këtij parimi kundërpërgjigjen se kjo vetëm sa e shtyn njohjen e këtyre përfitimeve për periudha të tjera duke i mbivlerësuar ato në periudhat e ardhshme.

Argumentet pro

1. Ky parim shërben si frenues i zellit të tepëruar të drejtuesve për të njohur fitime në rezultatin e njësive ekonomike.
2. Shifrat e raportuara dhe të audituara duhet të jenë të besueshme dhe sigurisht që ushtrimi i kujdesit në kryerjen e vlerësimeve është shumë i rëndësishëm në këtë drejtim dhe duhet mbështetur nga standardet.
3. Investitorëve u intereson më shumë pikëpamja e mësipërme, sidomos kur bëhet fjalë për pagimin e bonuseve dhe dividendëve bazuar mbi përfitimet e raportuara.
4. Një kontabilitet më konservator nga ana e bankave mund t'i kishte kufizuar bonuset dhe dividendët e ekzagjeruara, duke i bërë bankat më të qëndrueshme dhe duke siguruar më shumë stabilitet financiar për sistemin ekonomik në përgjithësi.

Disa fusha specifike në të cilat përdoren provizionet

Provizionet për shitje me garanci – Janë detyrime aktuale për shpenzime që mund të ndodhin në të ardhmen, por që lidhen me një ngjarje të ndodhur

në periudhën aktuale, konkretisht shitja e mallrave dhe shërbimeve duke ofruar garanci nga njësia ekonomike. P.sh. provizione që rrjedhin nga detyrime konstruktive (morale) kur ndërmarrja ka deklaruar se do të riblejë produktet e saj të shitura brenda dy muajsh, nëse klienti nuk është i kënaqur me to ndonëse nuk ka detyrim ligjor për ta bërë këtë.

Provizionet për çështje gjyqësore – Janë detyrime aktuale të njësisë ekonomike në lidhje me çështjet e hapura gjyqësore që parashikohen se do të humben, por që vendimi përfundimtar pritet të jepet në periudhën/at në vijim dhe si pasojë njësia do të duhet të kryejë pagesat për shlyerjen e tyre. P.sh. provizionet që rrjedhin nga detyrime ligjore në rastin e shkeljes së një kontrate noteriale në bazë të së cilës duhet paguar një dëmshpërblim. Mosrespektimi i ligjit për taksat bën që Drejtoria e Tatimeve dhe Doganave të kërkojë pagesat e tatimeve shtesë ose gjobave (pavarësisht nëse kjo mund të jetë në proces ankimor).

Provizionet që lidhen me kontratat me kushte rënduese – Janë detyrime të cilat vijnë si pasojë e një kontrate, në të cilën kostoja e përfundimit të një kontrate i kapërcen përfitimet ekonomike që priten prej saj.

Provizionet për detyrimet mjedisore – Janë detyrime të ardhme që kërkojnë likuidimin apo kompensimin e një dëmispecifik mjedisor. P.sh. Hyrja në fuqi e një ligji për mjedisin, sipas të cilit kërkohet që ndërmarrja të likuidojë ose kompensojë për ndotje të caktuara.

Provizionet për kostot e ristrukturimit– Janë detyrime që lidhen me riorganizimin e veprimtarisë së njësisë ekonomike si rezultat i të cilit fusha e veprimit të biznesit të ndërmarrë, ose mënyra se si kryhet ky biznes, do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.

Provizionet për pensione– Janë detyrime që një njësi ekonomike t’u paguajë pensione ose përfitime të tjera punonjësve të saj.

Analiza e njohjes së provizioneve në Shqipëri

Zbatimi i parimit të kujdesit shpesh kërkon punë shtesë nga ana e

drejtuesve dhe kontabilistëve duke çuar në një tendencë të natyrshme për ta neglizhuar zbatimin e tij. Nga ana tjetër ekziston një konflikt ndërmjet asaj që synon të arrijë parimi i kujdesit dhe synimit të menaxherëve apo drejtuesit e kompanive të cilët janë të interesuar të paraqesin rezultate të rritura të cilat janë baza për vlerësimin e punës së tyre. Një pengesë tjetër është shpesh edhe legjislacioni tatimor, i cili shpenzimet e njohura në kuadër të zbatimit të parimit të kujdesit nuk i njeh si të zbritshme për efekt të tatimit mbi fitimin. Të gjitha arsyet e mësipërme, por jo vetëm, e bëjnë zbatimin e parimit të kujdesit të vështirë për t'u zbatuar.

Kompanitë që kemi marrë në analizë në këtë punim kanë në objektin e aktivitetit të tyre tregtimin e pajisjeve elektro-shtëpiake/elektronike të cilat shpesh shoqërohen me garanci nga ana e shitësit. Pra, në këtë lloj aktiviteti ekziston mundësia e kthimit të mallrave të shitura si pasojë e defekteve të lindura. Pritshmëria e arsyeshme është që këto shoqëri duhet të paraqesin në bilancet e tyre provizione për shitjet me garanci. Gjithashtu, për ato shoqëri që paraqesin vlera të konsiderueshme llogarish të arkëtueshme, kemi qenë të vëmendshëm lidhur me njohjen ose jo të zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme.

Ne morëm në analizë pasqyrat financiare të 31 subjekteve ekonomike të cilat kanë në objektin e aktivitetit të tyre tregtimin e pajisjeve elektro-shtëpiake/elektronike. Kemi hetuar PF të dorëzuara prej tyre që prej vitit 2015 për të parë nëse kanë njohur provizione dhe/ose zhvlerësim të aktiveve (kryesisht të LLA). Nga vëzhgimi ynë rezulton se nga 31 subjekte, vetëm njëri prej tyre ka njohur një provizion afatshkurtër. Në pasqyrat financiare të njësive të tjera nuk gjetëm asnjë gjurmë (të paktën jo të dukshme) të zbatimit të parimit të kujdesit gjatë hartimit të pasqyrave financiare. Nga ky vëzhgim mund të arrijmë në një konkluzion paraprak, ndonëse jo përfundimtar, se bizneset në Shqipëri në përgjithësi nuk e zbatojnë parimin e kujdesit. Sigurisht një studim i mëtejshëm më i thelluar është i nevojshëm dhe objektiv i autorëve të këtij punimi, për të dhënë konkluzione më të qëndrueshme lidhur me këtë çështje. Nuk mund të themi se parimi i kujdesit nuk njihet nga profesionistët kontabël në Shqipëri, por më shumë jemi të mendimit se zbatimi i këtij parimi neglizhohet në shumicën e rasteve nisur nga trajtimi fiskal që u bëhet shpenzimeve të njohura në kuadër të zbatimit të tij. Kjo është një

dëshmi më tepër se raportimi financiar në Shqipëri vazhdon të diktohet më shumë nga kërkesat ligjore për qëllime të llogaritjes së detyrimeve tatimore, sesa nga standardet e kontabilitetit për qëllime të vendimmarrjes ekonomike të drejtimit dhe palëve të tjera të interesuara.

Përfundime

Parimi i Kujdesit duhet të njihet dhe të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike dhe madje duhet të kërkohet zbatimi i tij edhe përmes IFRS.

Kontabilistët duhet të jenë më të kujdesshëm në njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi paraqitja e një rezultati të mbivlerësuar nuk i vjen në ndihmë as njësisë ekonomike, e as përdoruesve të tjerë.

Në realitetin e ekonomisë shqiptare parimi i kujdesit përdoret pak, gjë e cila ngre pikëpyetje edhe lidhur me shkallën e njohjes së tij. Kompanitë shqiptare pavarësisht se nuk kanë përfitime fiskale prej njohjes e shpenzimeve në kuadër të zbatimit të parimit të kujdesit gjithsesi duhet t'i njohin ato në Pasqyrat Financiare duke mbajtur parasysh edhe nevojat e përdoruesve të tjerë të informacionit kontabël.

Bibliografia

1. ACCA Global - Prudence and IFRS.
2. Alexander, D, Nobes, C., 2010. Financial accounting. An International Introduction, Prentice Hall.
3. BasuSudipta; Conservatism Research: Historical Development and Future Prospects, Fox School of Business, Temple University, USA.
4. Basu, S. 1997. "The conservatism principle and the asymmetric timeliness of earnings." Journal of Accounting and Economics.
5. Bliss, J.H. 1924. Management through accounts. New York, NY: The Ronald Press Co.
6. Chambers R.J. 1996. Ends, Ways, Means and Conceptual Frameworks.
7. DhanoSotiraq. M. 2010. KontabilitetFinanciar.
8. Feleagă Liliana, Voicu D. Dragomir*, FeleagăNiculae; National accounting culture and the recognition of provisions: an application of the prudence principle, The Bucharest Academy of Economic Studies, Romania*.
9. IFRS (International Financial Reporting Standards), IAS 37.

10. MăciucăGeanina, Elena Hlaciuca, AntonelaUrsachea; The role of prudence in financial reporting: IFRS versus Directive 34.
11. Marshall, D.H., McManus, W.W., Viele D.F., 2014. Accounting, What the Numbers Mean, McGraw-Hill Irwin.
12. OreshkovaHristina; *the* Debate on Prudence in Accounting.
13. QKR – Qendra Kombëtare e Regjistrimeve.
14. SKK (Standardet Kombëtare të Kontabilitetit), SKK 6.
15. Sterling, R. R. 1970. Theory of the Measurement of Enterprise Income: University of Kansas Press.
16. Watts Simon Ross L.; Conservatism in Accounting, School of Business, University of Rochester.

Summary

Albanian accounting practice tends to be guided more by fiscal law requirements rather than national or international accounting standards. The reasons for this tendency can be traced back to the not-so-distant tradition of accounting profession in Albania, which exclusively reported to the government, which was the owner of the centralized economy of the country, thus making it the sole user of accounting information.

Even today, decades after the big changes in political reality, the tendency to report primarily to the government is still strong. Due to this, many aspects that are important for the quality and usefulness of accounting information, but may not be so important to tax authorities, are often neglected by business entities.

There are a lot of such aspects, but probably the most notable ones are accounting treatments involving judgement and prudence. Typical examples of these aspects are the recognition of provisions and impairment of assets, like inventory, receivables and fixed assets. Because for a long time, provisions and impairment of assets, have not been acknowledged by tax authorities in Albania for the purpose of calculating taxable income, many business entities do not recognize them at all.

Based on this observation we decided to investigate the application of prudence principle in accounting practice in Albania, especially as related

to these two specific issues, provisions and impairment of assets (i.e. receivables).

Keywords: *Prudence Principle, Provisions, Impairment of assets, Tax Accounting.*

LIDHJA AFATGJATË NDËRMJET INFLACIONIT DHE ELEMENTËVE TË SISTEMIT FINANCIAR

M.Sc. Iva Sulaj^a

M.Sc. Klejda Gabeshi^b

^aKolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Financë-Kontabilitet

^bKolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Financë-Kontabilitet

Abstrakt

GJetjet empirike për një lidhje negative ndërmjet inflacionit dhe rritjes ekonomike reale (p.sh. Barro 1995) tërhoqën një interes të madh dhe punë të vazhdueshme. Një çështje padyshim e rëndësishme ishte të përcaktohej nëse kjo lidhje ekzistonte vërtetë dhe pasi të bëhej kjo, të shpjegohej edhe arsyeja. Një gjetje tjetër e rëndësishme empirike pothuajse në të njëjtën kohë ishte që ndërmjetësit financiarë (bankat dhe tregjet) kishin një rol kyç në zhvillimin ekonomik. (Levine dhe King 1993a, b, Levine dhe Zervos 1998). Lidhja e qartë ndërmjet dy gjetjeve është mundësia që inflacioni mund të ndikojë rritjen reale nëpërmjet tregjeve financiare, konkretisht duke dëmtuar tregjet financiare ose duke penguar veprimtarinë e tyre. Kryesisht vëmendja përqendrohet në studimin e bankave.

Studimet e ndryshme empirike sugjerojnë që një inflacion i lartë shkon paralelisht me një sektor të ndërmjetësimit financiar të vogël, të diskutueshëm dhe pak efikas. Për bankat, por jo për tregun e titujve financiarë, ka evidenca

për shkakësi që rrjedh nga inflacioni në tregjet financiare. Këto kombinime gjetjesh janë mjaft të rëndësishme për shkak të rëndësisë të ndërmjetësimit financiar në zhvillimin ekonomik.

Është e pamatur të dilet në përfundimin se inflacioni është (ose jo) një faktor madhor që i atashohet krizave bankare. Është e vështirë për t'u vërtetuar nga përvoja, sidomos për shkak të të dhënave dhe përcaktimeve për krizat bankare.

Rezultatet e studimeve të ndryshme sugjerojnë se marzhet nominale të bankave janë të lidhura pozitivisht dhe të ndikuara fuqimisht nga inflacioni, por marzhet reale të bankave janë të lidhura negativisht me inflacionin.

Fjalët kyçe: Inflacion, Krizë bankare, Ndërmjetës financiarë, Tregje financiare.

1. Hyrje

Ky prezantim studion lidhjen ndërmjet inflacionit dhe performancës së tregjeve financiare. Po pse ky interes për inflacionin dhe tregjet financiare? Gjetjet empirike për një lidhje negative ndërmjet inflacionit dhe rritjes ekonomike reale (p.sh. Barro 1995) tërhoqën një interes të madh dhe punë të vazhdueshme. Një çështje padyshim e rëndësishme ishte të përcaktohej nëse kjo lidhje ekzistonte vërtetë dhe pasi të bëhej kjo të arsyehet pse. Një gjetje tjetër e rëndësishme empirike pothuajse në të njëjtën kohë ishte që ndërmjetësit financiarë (bankat dhe tregjet) dukej se kishin një rol kyç në zhvillimin ekonomik. (Levine dhe King 1993a, b, Levine dhe Zervos 1998).

Kjo gjetje gjithashtu tërhoqi një interes të vazhdueshëm dhe kërkime të thelluara. Lidhja e qartë ndërmjet dy gjetjeve është mundësia që inflacioni mund të ndikojë rritjen reale nëpërmjet tregjeve financiare, konkretisht duke dëmtuar tregjet financiare ose duke penguar veprimtarinë e tyre. Dy janë arsyet që vëmendja përqendrohet në studimin e bankave dhe tregut bankar krahasuar tregun e aksioneve dhe obligacioneve. Arsyeja e parë janë punimet dhe studimet e shumta mbi bankat dhe tregun bankar, ndërsa arsyeja e dytë qëndron në faktin se në tepër aspekte, bankat janë një përbërës më substancial i sektorit financiar. Relativisht vendet e varfra shpesh kanë tregje primitive të pasurisë, me tregti pa shkëmbime të organizuara. Tregjet e obligacioneve janë gjithashtu të pazakonta. Vetëm në 25% të vendeve të

studiara ofrohen bono thesari nga qeveria dhe në një fraksion akoma më të vogël emetohen obligacione private. Sidoqoftë, të gjitha vendet të pasura apo të varfra kanë banka.

2. Rishikim i literaturës

2.1 Modele makroekonomike që nuk përfshijnë rolin e bankave

Smith (2002) argumenton se modelet ekonomike që nuk marrin në konsideratë bankat çojnë në «rezultate të qarta sikletosëse». Për më tepër këto modele prodhojnë një efekt Mundell-Tobin në të cilin një inflacion i lartë i qëndrueshëm çon në një aktivitet ekonomik real më të lartë ose në superneutralitet, ku inflacioni i lartë nuk ka efekt në normat reale të interesit ose në aktivitetin real. Këto rezultate janë kontradiktore me ato empirike të cilat tregojnë se mbi një nivel të caktuar, inflacioni dhe aktiviteti ekonomik real janë të lidhura negativisht.

Një rezultat tjetër që paraqitet nga modelet makroekonomike që nuk marrin në konsideratë ndërmjetësimin financiar është optimaliteti i rregullit të Friedman-it. Kjo gjetje nuk duket të jetë interesante nga pikëpamja empirike, meqenëse periudhat me norma nominale interesi të ulëta shpesh i bashkëngjiten performancës ekonomike nën-optimale. Çështja e Depresionit të Madh në Shtetet e Bashkuara vjen në mend në këtë rast. Për më tepër modelet që përfshijnë ndërmjetësimin shpesh performojnë nën-optimalitet të rregullit të Friedman-it.

2.2 Modele të ndërmjetësimit financiar dhe rritjes ekonomike

Gurley dhe Shaw (1955, 1960, 1967), vunë re se në nivele të ulëta të zhvillimit ekonomik shumë investime kapitale vetë-financohen. Vetëm në nivele të larta të ardhurash për kapital, dalin në pah bankat dhe luajnë një rol të rëndësishëm në investimin financiar. Me rritje të mëtejshme të të ardhurave për kapital, tregje financiare të sofistikuara si tregjet e aksioneve, lehtësojnë krijimin e kapitalit. Një përfundim i sugjeruar nga vëzhgimet e Gurley-Shaw është që pa zhvillimin e tregjeve dhe institucioneve financiare, shpërndarja e fondeve në investime produktive është i kufizuar. Si rrjedhim nivele më të ulëta të investimeve kapitale pengojnë rritjen ekonomike. Për më tepër vëzhgimet e tyre implikojnë se zhvillimi financiar dhe rritja ekonomike

janë të kufizuar nga njëra-tjetra. Literatura teorike e dekadës së kaluar dhe më tej, është përpjekur të paraqesë vëzhgimet e Gurley-Shaw në formën e modeleve që theksojnë rëndësinë e bankave në sigurimin e likuiditetit si një faktor që promovon rritjen ekonomike. Ka mundësi që politika monetare të luajë rol në zhvillimin e dobët financiar në vendet në zhvillim. Vendet në zhvillim tentojnë të kenë nivele relativisht të larta të normave nominale të interesit. Me një vështrim të shpejtë duket sikur normat e larta nominale të interesit, inkurajojnë zhvillimin e bankave. Gjithsesi kjo nuk merr në konsideratë faktin që bankat duhet të sigurojnë nevojën e depozituesve për likuiditet. Bencivenga dhe Smith (2003), prezantojnë një model sipas të cilit normat e larta nominale të interesit, të shkaktuara nga një normë e lartë e rritjes së parasë, bëjnë që bankat të mos kenë aftësinë e duhur të sigurojnë nevojat për likuiditet të agjentëve dhe prandaj nuk përdoren. Si rezultat vuan zhvillimi ekonomik. Ata mbështeten në episode historike në të cilat reformat monetare që kanë shkaktuar rënie të ndjeshme të normave të rritjes së parasë dhe normave nominale të interesit cenuan zhvillimin e bankave.

2.3 Ndikimi i normave nominale të interesit dhe inflacionit në zhvillimin financiar

Dy vërejtje të rëndësishme dalin në pah nga literature empirike:

a) norma nominale interesi të ulëta tentojnë të shoqërohen me nivele të ulëta të investimeve reale dhe norma të rritjes ekonomike të ulëta. Kjo mund të vendosë në pikëpyetje optimalitetin e rregullit të Friedman-it dhe

b) norma të qëndrueshme të larta të inflacionit, mbi një nivel të caktuar, ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike. Kjo duket sikur nuk përputhet me efektin Mundell-Tobin që ngrihet në shumë modele makroekonomike standarde.

Niveli i normave nominale të interesit ndikon vendimet e portofolit bankar. Normat nominale të interesit të ulëta, ulin koston oportune të bankave për të mbajtur kesh rezervë, duke rezultuar në më pak investime në kapital produktiv. Në thelb, me norma të ulëta interesi paraja bëhet “shumë e mirë” e një aktivi dhe bankat kanë pak iniciativë të bëjnë investime produktive. Kjo gjë pengon zhvillimin ekonomik. Në të tilla raste një politikë monetare që mbështetet në rregullin e Friedman-it mund të jetë nën-optimale.

Nivele të larta të inflacionit mund të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike.

N.q.s. sipas sugjerimeve të disa studimeve empirike, inflacioni i lartë nuk tenton të rezultojë në norma nominale proporcionale të larta interesi, ai rezulton në norma kthimi reale më të ulëta (Barnes, Boyd dhe Smith 1998).

Kjo rrit kërkesën për fonde të huaja por redukton ofertën e tyre. Në mënyrë më të rëndësishme, norma të larta të mjaftueshme të inflacionit mund të përkeqësojnë problemet e tregut të kreditit. Studimet empirike tregojnë se këto probleme janë më të mëdha në vendet në zhvillim krahasuar ato të zhvilluara. Në një botë me probleme të tregut të kreditit, inflacioni i lartë mund të çojë në shtimin e racionimit të kreditit dhe të pakësojë investimin e përgjithshëm.

Smith dhe Van Egteren (2003) sugjerojnë një mekanizëm tjetër nëpërmjet të cilit inflacioni mund të ndikojë outputin real. Në modelin e tyre inflacioni zvogëlon vlerën reale të fondeve të brendshme të përdorura nga firmat për të bërë investime dhe shtrembëron iniciativën e firmave për të grumbulluar fonde të brendshme. Kjo bën që firmat të mbështeten fuqimisht në burime të jashtme për fonde duke përkeqësuar problemet e informacionit në tregjet financiare. Kjo ndikon negativisht në nivelin dhe efikasitetin e investimeve duke rezultuar në një output real më të ulët. Këto efekte shfaqen jo vetëm me inflacionin e lartë, por dhe me lëkundjet e mëdha të inflacionit.

Efekti i inflacionit në aktivitetin ekonomik real rezulton të jetë jo-monoton.

P.sh. Bullard dhe Keating (1995) tregojnë se për ekonomitë me nivele inflacioni fillimisht të ulëta, një rritje e qëndrueshme në nivelin e inflacionit mund të stimulojë aktivitetin ekonomik në afat të gjatë. Por duke i qëndruar modelit të mësipërm, në ekonomitë me nivele fillimisht të larta të inflacionit, rritja e mëtejshme e tij redukton aktivitetin ekonomik.

2.4 Efekti i inflacionit në kriza dhe në paqëndrueshmërinë ekonomike

Literatura empirike vëren një marrëdhënie të rëndësishme ndërmjet inflacionit të lartë e të qëndrueshëm dhe krizave financiare. Friedman dhe Schwartz (1967), vunë re lidhjen e fortë ndërmjet krizave dhe recesioneve në ekonominë amerikane. Në disa raste, por jo gjithmonë, krizat kishin çuar në reduktime të rëndësishme dhe zgjatje në kohë të outputit. Literaturat e hershme për panikun bankar nuk ndërftunin ekonomitë monetare. Gjithsesi

shumë nga faktet empirike të shoqëruara me krizat bankare përfshijnë vëzhgime në lidhje me sjelljen e variablave monetare si depozitat dhe normat e rezervave të depozitave. Kjo argumenton futjen e parasë në modelet bankare në mënyrë që të shpjegohen saktë vëzhgimet empirike. Modelet në lidhje me konsideratat monetare shpesh kanë përfshirë problematikën e tregjeve financiare. Një tipar i zakonshëm i këtyre modeleve është prirja e ekonomive model për të shfaqur paqëndrueshmëri domethënëse. Për shembull Williamson (1987), Bernanke dhe Gertler (1989), Carlstrom dhe Fuerst (1997, 1998) tregojnë se problemet në tregjet financiare mund të amplifikojnë mangitudën e shokut nga faktorë të jashtëm. Gjithashtu këto probleme mund të rrisin paqëndrueshmërinë e faktorëve të brendshëm.

Modelet që përfshijnë problem të tregjeve të kreditit, shpesh implikojnë një vlerë kritike të normës së inflacionit, nën të cilën ekonomitë model shfaqin një dinamikë luhatëse jashtë gjendjes së qëndrueshme.

Smith (2002) prezanton një model në të cilin bankat që përballen me tërheqje stokastike, sigurojnë agjentët kundrejt zhvendosjeve tronditëse. Kur proporcioni (π) i zhvendosjes kalon një nivel kritik, panik bankar ndodh në ato banka ku rezervat janë ezauruar. Për nivele akoma më të larta të π -së bankat likuidojnë investimet e akumuluar, dhe marrin një nivel të ulët kthimi nga këto investime të mbetura. Në këtë model nivele më të larta të inflacionit shoqërohen me probabilitet më të lartë të krizave bankare. Ky model tregon se në ndjekje të rregullit të Friedman-it bankat duhet të mbajnë 100% rezerva.

Kjo implikon probabilitet për panik bankar zero. Vendosija e normës nominale të interesit zero në këtë model nuk është optimale. Rritja e normës nominale të interesit mbi zero, i drejton bankat të mbajnë më shumë akumulim të aktiveve produktive dhe të përmirësojnë gjendjen e qëndrueshme në ndihmë të agjentëve.

Smith (2002) gjithashtu prezanton një model verifikimi për situata të kushtueshme në rastet e problemeve të tregjeve të kreditit. Në këtë model ngrihen dy gjendje të qëndrueshme, njëra me gjendje kapitali të ulët dhe tjetra me gjendje kapitali të lartë. Secila nga gjendjet e qëndrueshme varet nga gjendja fillestare e kapitalit të ekonomisë. Shtigjet e ekuilibrit që përafrohen me gjendjen e qëndrueshme me kapital të lartë mund të shfaqin papërcaktueshmëri me një mori ekuilibrash. Për më tepër, mundësia

e paqëndrueshmërisë së faktorëve të jashtëm ngrihet në rastin e gjendjes me kapital të lartë, vetëm nëse gjendja e qëndrueshme e inflacionit është mjaftueshmërisht e lartë. Kjo implikon që inflacioni i lartë mund të shoqërohet me rritjen e paqëndrueshmërisë së inflacionit, një vëzhgim i bërë në literaturën empirike.

Tek Choi, Boyd, dhe Smith (1996), ndërmjetësit financiarë përballen me një problem të përzgjedhjes së pafavorshme, me një potencial të racionimit të kreditit. Për norma më të ulëta të inflacionit, racionimi i tregut të kreditit mund të mos ndodhë. Në këtë rast modeli çon në një efekt Mundell-Tobin. Gjithsesi me norma të larta të inflacionit, modeli çon në racionim të jashtëm të kreditit. Norma të larta reale të inflacionit reduktojnë normat reale të kthimit për kursimtarët dhe kur kreditimi racionohet, problemet e informacionit përkeqësohen. Në të tilla raste “vuan” aktiviteti ekonomik.

Inflacioni i lartë mund të rezultojë në leqe për zhvillimin. Kur inflacioni është mjaftueshmërisht i lartë, rezulton paqëndrueshmëri ekonomike dhe inflacioni bëhet më variabël ashtu si dhe normat e kthimit nga kursimet.

3. Metodat

(Qëllimi, pyetja kërkimore, të dhënat dhe zgjedhja, analiza e të dhënave dhe interpretimi i rezultateve)

Pjesa më e madhe e punimeve teorike të përmendura më lart kanë të bëjnë me inflacionin, bankat dhe ekonomitë. Efektet e inflacionit në tregun e titujve financiarë janë të rëndësishme potencialisht. Më poshtë do të prezantohen disa gjetje empirike të reja në lidhje me efektet e inflacionit.

3.1 Madhësia e tregut të aksioneve dhe performanca

Boyd, Levine, dhe Smith (2001) implikojnë të dhëna ndërmjet vendeve për të studiuar lidhjen ndërmjet inflacionit dhe katër përmasave të madhësisë e performancës së tregut të aksioneve.

- a) Kapitalizmi total i tregut të aksioneve si përqindje ndaj GDP-së;
- b) Vlera totale e tregtuar si përqindje ndaj GDP-së;
- c) Norma e vlerës së aksioneve të tregtuar ndaj kapitalizmit të tregut të aksioneve;
- d) Një mjet për paqëndrueshmërinë e kthimit.

Testet e tyre përfshijnë seksione ndërmjet vendeve, të dhëna të mesatarizuara për një periudhë 36-vjeçare, për 48 vende. Ideja e mesatareve për një periudhë të gjatë kohe është për të vëzhguar marrëdhëniet e gjendjeve të qëndrueshme. Ato përfshijnë variablat fillestare, GDP-në reale ndaj asaj kapitale, edukimin fillestar dytësor, rastet e befasive dhe revolucioneve dhe premiumin e monedhës në tregun e zi, si një mjet për deficitin fiskal qeveritar.

Ata kanë gjetur se inflacioni është i lidhur negativisht dhe në mënyrë domethënëse me këto katër përmasa të tregut të aksioneve, pas kontrollit të variablave të tjerë të përmendur. Gjithashtu ata raportojnë evidenca të forta të “efektit prag”, për të gjitha këto marrëdhënie me përjashtim të njërës, inflacion-paqëndrueshmëri të tregut të aksioneve. Konkretisht marrëdhënia inflacion-performancë tregu aksioni, sheshohet për nivele të larta të inflacionit (mbi 15%), kështu që rritje të mëtijshme të inflacionit nuk shoqërohen me keqësim të mëtijshëm të kapitalizmit të tregut të aksioneve, vlerën totale të tregtuar ose kthimin.

Boyd, Levine, dhe Smith (2001), gjetën se paqëndrueshmëria e tregut të aksioneve përfaqësohet më mirë nga një lidhje pozitive e thjeshtë lineare me inflacionin, e cila është e rëndësishme statistikisht. Të gjitha këto marrëdhënie janë shumë të forta dhe të rëndësishme statistikisht, megjithatë autorët nuk pretendojnë të kenë vërtetuar lidhje rastësore.

3.2 Inflacioni dhe kthimi nga aksionet

Në të njëjtin studim Boyd, Levine, dhe Smith (2001), shpjegojnë lidhjet ndërmjet inflacionit dhe kthimit nominal nga aksionet për 38 vende, duke përfshirë të njëjtin set të variablave të kontrollit. Për regresione të thjeshta lineare, inflacioni hyn me një koeficient pozitiv e të rëndësishëm dhe elasticitet diku më të madh se një. Gjithashtu ka një evidencë të “efektit të pragut”, në lidhjen inflacion-kthim nga aksioni. Për vende me inflacion vjetor mesatar më të ulët se 15%, nuk ka një lidhje domethënëse ndërmjet inflacionit dhe kthimit nominal nga aksioni për afat të gjatë. Ndërsa për ekonomi me norma inflacioni mbi 15%, rritjet marxhinale të inflacionit shoqërohen me rritje më të mëdha se një me një, të kthimeve nominale nga aksionet.


3.3 Inflacioni dhe kthimet nga aksionet - studimet e serive kohore

Disa studime për kthimet nga aksionet që përdorin seritë kohore kanë përfituar rezultate të ngjashme me Boyd, Levine, dhe Smith (2001), për vendet me inflacion të ulët, në kuptimin që kur normat e inflacionit janë relativisht të ulëta, kthimet nominale nga aksionet nuk janë të lidhura në mënyrë domethënëse me inflacionin. Kutan dhe Aksoy (2003) studiovan marrëdhënien ndërmjet inflacionit dhe kthimeve nga aksionet në Turqi duke përdorur të dhëna mujore dhe një model GARCH asimetrik. Këta autorë gjetën se kthimi mesatar i një indeksi aksionesh të përzier dhe një indeksi industrial aksionesh nuk ishin të lidhura me inflacionin në mënyrë thelbësore, përfaqësuar nga indeksi i çmimeve të konsumit për periudha kohore një, dy dhe tre muaj. Në fakt, ky është një rezultat befasues nisur nga fakti që inflacioni në atë kohë që atabënë studimin në Turqi, ishte mesatarisht 75% në vit. Kutan dhe Aksoy (2003) gjetën gjithashtu që kthimi i aktiveve në sektorin financiar ishte i lidhur pozitivisht dhe në mënyrë domethënëse me inflacionin në të gjitha specifikimet. Ata thanë se për aktivet financiare inflacioni i përshpejtuar ka impaktin më të rëndësishëm. Të gjithë koeficientët e vlerësuar të inflacionit janë pozitivë, si të veçuar ashtu edhe bashkërisht domethënëse. Dukshëm gjetjet e serive kohore janë në përputhje me evidencat ndërvendore. Sipas testeve të serive kohore, gjithsesi ka dhe raste të lidhjeve negative ndërmjet inflacionit dhe kthimit nominal nga aksionet, gjithmonë në vendet me inflacion të ulët. Ky është një avantazh i trajtimit të serive kohore sepse këto raste mund të lihen në hije nga procedura e mesatarizimit kohor në seksionet ndërmjet vendeve. Testet e serive kohore vuajnë në vetvete nga problemi i përdorimit të të dhënave me frekuencë të lartë për të vlerësuar atë që besohet një lidhje me gjendjene qëndrueshme. Për më tepër në testet e serive kohore ngrihet pyetja se ku dhe në çfarë shtrirje është përdorur inflacioni për të parashikuar pjesëmarrësit e tregut. Për qëllimet e momentit këto çështje janë nuk lidhen sepse si testet e serive kohore, ashtu edhe puna ndërmjet vendeve kanë çuar gjerësisht në të njëjtat përfundime.

3.4 Tregu i borxhit - Inflacioni dhe normat e interesit

Në studimet e tyre për tregjet financiare të Turqisë gjatë periudhës janar 1987- dhjetor 2000, Kutan dhe Aksoy (2003) nuk gjeten evidencë për

Figura 1: Kapitalizmi total i tregut të aksioneve/GDP sipas inflacionit për çdo tremujor



	Tremujori I		Tremujori II		Tremujori III		Tremujori IV	
N = 68	Mean	Median	Mean	Median	Mean	Median	Mean	Median
mcap	0.5551	0.4092	0.2473	0.1977	0.2475	0.1169	0.1165	0.0811
cpirate	1.0363	1.0366	1.0664	1.0656	1.1161	1.1140	1.3249	1.2466

ndonjë lidhje ndërmjet inflacionit dhe ndryshimit të normave të interesit për periudha kohore një, dy dhe tre mujore. Siç u shprehën ata: “Tregu i bonove nuk vepron si një pengesë e mirë ndaj inflacionit të përshpejtuar në Turqi”.

Barnes, Boyd, dhe Smith (1999) studiuin lidhjen ndërmjet inflacionit dhe normave nominale të interesit për 25 vende, duke përdorur seri kohore një-çerekshe, për periudha nga shkurti 1957 deri në mars 1996. Ata studiuin dy seri të normave të interesit, një normë e tregut monetar dhe një normë e huadhënies (marrjes) bankare, dhe vlerësuan të dy ekuacionet me diferencat e para dhe proceset ARMA (auto regressive moving average model). Kur norma e tregut monetar ishte e varur, në çdo specifikim, më pak se gjysma e vendeve shfaqën koeficientë të inflacionit pozitivë dhe statistikisht të rëndësishme. Rezultate të ngjashme u arritën dhe kur norma e huadhënies (marrjes) bankare ishte variabël i varur. Në të gjitha rastet dhe për të dyja normat koeficienti i inflacionit është kaq i ulët madje dhe kur është disi më domethënës, përsëri është më i vogël se një. Koeficienti i regresionit më i lartë që ata gjetën ishte 0.49 në tregun monetar të Izraelit, një vend me inflacion relativisht të lartë.

3.5 Inflacioni dhe treguesit e zhvillimit bankar

Boyd, Levine dhe Smith (2001) studiuhan lidhjen ndërmjet inflacionit dhe tre treguesve të zhvillimit bankar që janë përdorur gjerësisht në literaturë.

- a. Norma e pasiveve likuide të sektorit financiar ndaj GDP-së;
- b. Raporti i aktiveve totale të bankave depozituese ndaj GDP-së;
- c. Norma e huadhënies së bankave ndaj sektorit privat ndaj GDP-së.

Gjithsesi ka pasur evidenca të “efektit të pragut”. Në mënyrë thelbësore inflacioni ishte i lidhur negativisht me treguesit e zhvillimit financiar në të gjitha vendet me nivele të inflacionit nën 15%. Por ndërsa inflacioni kalonte pragu 15%, kishte një ndalim të dallueshëm të treguesit të zhvillimit dhe lidhja e tij me inflacionin zhdukej. Kjo është mjaft e ngjashme me pragu për treguesit e zhvillimit të tregut të aksioneve që u përmend më lart. Për të përmbledhur fjalët e studiuesve “duket se ka evidenca të pragut në lidhjen empirike ndërmjet inflacionit dhe aktivitetit financiar”. Për norma të ulëta të inflacionit ka një lidhje të fortë negative ndërmjet inflacionit dhe zhvillimit financiar. Për vende në të cilat inflacioni është mbi një nivel kritik, perceptimi i vlerësuar i zhvillimit bankar në lidhje me inflacionin është shumë më i ulët sesa për vendet me inflacion nën pragu. Për më tepër në ekonomitë ku norma e inflacionit tejkalon këtë prag, korrelacioni fillestar ndërmjet inflacionit dhe aktivitetit financiar në thelb zhduket.

3.6 Krizat bankare

Studime të ndryshme kanë ekzaminuar se çfarë forcash ekonomike shoqërojnë apo shkaktojnë krizat ekonomike. Në të paktën tre raste inflacioni megjithëse jo si variabël i interesit primar, është përfshirë si variabël kontrolli.

P.sh. Demirguc-Kunt dhe Detragiache (1998) ekzaminuan rolin e rrezikut moral ndaj sigurimit të depozitave në shkaktimin e paqëndrueshmërisë së sistemit bankar. Në kuadrin e një varieteti të specifikimeve të ndryshme, variabli i inflacionit pati një koeficient pozitiv, që ishte statistikisht i rëndësishëm (në nivele të larta të besueshmërisë) si një shpjegues i probabiliteteve të krizave bankare. Në rishikime të vonshme të studimit të tyre Demirguc-Kunt dhe Detragiache (2001), norma reale e interesit u shtua si një variabël kontrolli shtesë dhe modeli u zgjerua. Me këto ndryshime koeficienti i inflacionit ra në

parëndësi. Një studim tjetër më i vonshëm nga De Nicolo, Bartholomeo, Zaman, dhe Zephirin (2003), mori një përjasje tjetër për të përfaqësuar empirikisht ndodhjen e krizave bankare. Në vend që të datonin nisjen dhe përfundimin e krizës, ato ndërtuan një mjet të probabilitetit të krizës të vazhdueshëm për pesë bankat më të mëdha në vend. Në rezultatet e raportuara, inflacioni hyn si një variabël kontrolli sëbashku me një set variablash rajonalë, rritjen reale të GDP-së, dhe me një variabël të ndërhyrjes së qeverisë, që synon të kapë efektin e garantit nga ana e qeverisë në shpërndarjen e fitimeve bankare.

Në asnjërin nga specifikimet e ndryshme, inflacioni nuk hyri me koeficient domethënës, të ndryshëm nga zero. Gjithsesi gjashtë variablat rajonalë të lidhur me variablin e rritjes reale mund të shërbenin si një përfaqësues i mirë dhe i arsyeshëm për inflacionin.

Boyd, Gomis, Kwak, dhe Smith (2001) studiojnë karakteristikat e vendeve që ishin ndeshur me një sërë krizash bankare. Një tipar i zakonshëm veçanërisht në Amerikën Latine, është që këto vende kanë inflacion të lartë gjatë një krize bankare, që do të ndiqet nga një krizë tjetër bankare. Nuk ka një numër të mjaftueshëm të krizave të përsëritura bankare për të bërë analiza statistikore, por këto të dhëna janë mjaft goditëse.

3.7 Fitimet e bankave, marzhi neto i interesave dhe vlera e shtuar - Si janë të lidhura me inflacionin?

Një numër studimesh i kanë kushtuar rëndësi lidhjes që ekziston ndërmjet inflacionit dhe fitimeve të bankave, inflacionit dhe marzhit neto të interesave që përfaqësohet nga $(\text{të ardhura nga interesi} - \text{shpenzime nga interesi}) / \text{totali i aktiveve}$. Në shumë nga këto studime inflacioni është përfshirë si variabël kontrolli, por nuk ka qenë ai në vetvete variabli kryesor në studim.

Një shembull është studimi i Demirguc-Kunt, Laeven, dhe Levine (2003), që studion lidhjen ndërmjet përqendrimit të bankës dhe marzhit neto nga interesat. Këta autorë kanë përfshirë një panel të gjerë ndërmjet vendesh, me të dhëna për 1400 banka në rreth 72 vende, për periudhën 1995-1999. Inflacioni i brendshëm hyn si një variabël kontrolli së bashku me shumë variabla të tjerë. Këta autorë raportojnë për një lidhje pozitive domethënëse ndërmjet inflacionit dhe marzhit neto nga interesat të bankave, fuqizuar nga një varietet specifikimesh.

3.8 Rezervat ligjore dhe taksa e inflacionit mbi bankat

Ndoshta rezultatet më interesante të raportuara nga Honohan janë ato mbi inflacionin, rezervat e bankave dhe efekti i përbashkët i tyre në fitimet e bankave. Sipas një nocioni të hershëm të ekonomisë monetare, qeveria mund të taksojë në mënyrë efikase bankat duke i detyruar të mbajnë rezerva që nuk paraqesin interes. Një taksë e tillë, ashtu si taksa e inflacionit në paratë e mbajtura jashtë bankës, mund të jetë një burim i rëndësishëm të ardhurash në ekonominë në tranzicion apo në zhvillim, ku mbledhja e taksave të tjera është problematike. Gjithsesi Honohan nuk gjen evidencë për një rezervë takse të tillë në banka. Në fakt ai raporton se: “Inflacioni bashkëpunon fuqishëm me rezervat, jo për të reduktuar të ardhurat, por për ti rritur ato”! Më tepër se sa mbajtja e rezervave është e detyruar, në vende me nivele të larta të rezervës dhe inflacion të lartë bankat duket se marrin shpërblim të mjaftueshëm, të paktën në marzhin e mbajtjes së rezervave.

4. **Rezultate – gjetje – rekomandim:**

Ky prezantim teorik bën të paktën tre parashikime empirike:

1. Inflacioni “shumë i lartë” ose “shumë i ulët” mund të pengojë sektorin e ndërmjetësimit financiar dhe kështu të reduktojë outputin real;
2. Ekziston “efekti i pragut” në norma «mjaftueshmërisht» të larta të




Figura 2. Huadhënia e bankave tregtare për sektorin privat/GDP sipas inflacionit për çdo tremujor

	Tremujori I		Tremujori II		Tremujori III		Tremujori IV	
N = 68	Mean	Median	Mean	Median	Mean	Median	Mean	Median
rgovrate	1.0465	1.0507	1.0455	1.0449	1.0449	1.0473	0.9907	0.9921
cpirate	1.0230	1.0234	1.0293	1.0272	1.0563	1.0548	1.2094	1.1533

inflacionit. Në varësi të modelit, sjellja ekonomike është e ndryshme në anën e lartë të pragut. P.sh. mund të ndodhë racionimi i kreditimit;

3. Një parashikim tjetër i rëndësishëm i studimeve teorike është ai që pretendon se paqëndrueshmëria e kthimit nga aksionet, është e lidhur pozitivisht me inflacionin, ndoshta me një kërcim modest në kufirin e pragut.

Përqindja e kthimeve të tregut të aksioneve ndaj inflacionit paraqitet të varet në mënyrë të rëndësishme nga niveli i inflacionit. Në mjedise me nivele të ulëta të inflacionit testet ndërmjet vendeve, gjejnë se inflacioni dhe kthimet nominale të aksioneve nuk lidhen në mënyrë të rëndësishme. Në mjedise me inflacion të lartë, gjetjet janë mjaft të ndryshme. Rezulton se kthimet nominale rriten mjaftueshëm sa për të mos cenuar kthimet reale.

Një inflacion i lartë shkon paralelisht me një sektor të ndërmjetësimit financiar të vogël, të diskutueshëm dhe pak eficient. Për bankat, por jo për tregun e titujve financiarë, ka evidenca për shkakësi që rrjedh nga inflacioni në tregjet financiare. Këto kombinime gjetjesh janë mjaft të rëndësishme për shkak të rëndësisë të ndërmjetësimit financiar në zhvillimin ekonomik.

Është e pamatur dilet në përfundimin se inflacioni është (ose jo) një faktor madhor që i atashohet krizave bankare. Është e vështirë për t'u vërtetuar nga përvoja, sidomos për shkak të të dhënave dhe përcaktimeve për krizat bankare.

Rezultatet e studimeve të ndryshme sugjerojnë se marzhet nominale të bankave janë të lidhura pozitivisht dhe ndikuara fuqimisht nga inflacioni, por marzhet reale të bankave janë të lidhura negativisht me inflacionin.

Bibliografia

1. Barnes, Michelle, and Hughes, Anthony W. 2002. A quintile regression analysis of the cross section of stock market returns. FRB Boston Series, paper no. 02-2.
2. Barro, Robert J. 1995. Inflation and economic growth. Bank of England Quarterly Bulletin, pp. 166–176.
3. Beck, Thorsten, AsliDemirguc-Kunt and Maksimovic, Vojislav. 2003. Bank competition and access to finance, Manuscript, The World Bank.
4. Beck, Thorsten, Levine, Ross and Loayza, Norman. 2000. Financial intermediation and growth: Causes and causality. *Journal of Monetary Economics*, 46, pp. 31–77.
5. Boyd, John H., Levine, Ross, and Smith, Bruce D. 2001. The impact of inflation on financial market performance. *Journal of Monetary Economics*, 47, pp. 221–248.
6. Demirguc-Kunt, Asli and Levine, Ross. 2001. Financial Structure and Economic Growth: A Cross-Country Comparison of Banks, Markets, and Development, Cambridge, MA: MIT Press, December.
7. Demirguc-Kunt, Asli, and Detragiache, Enrica. 1998. The determinants of banking crises in developed and developing economies. *IMF Staff Papers*, 45, pp. 81–109.
8. Gurley, John G. and Shaw, Edward S. 1967. Financial structure and economic development. *Economic Development and Cultural Change*, 15 (3, April), pp. 257–268.
9. Honohan, Patrick. 2003. Avoiding the pitfalls in taxing financial intermediation. World Bank Policy Research Working Paper 3056.
10. Kutan, A.M. and Aksoy, Tansu. 2003. Public information arrival and the Fisher effect in emerging markets: Evidence in stock and bond markets in Turkey. *Journal of Financial Services Research*, 23.3, pp. 225–239.
11. Levine, Ross, Loayza, Norma, and Beck, Thorsten. 2000. Financial intermediation and growth: Causality and causes. *Journal of Monetary Economics*, August, 46, pp. 31–77.
12. Smith, Bruce D. 2002a. Monetary policy, banking crises, and the Friedman rule. *American Economic Association Papers and Proceedings*, 92 (2), pp. 128–134.
13. Smith, R. Todd, and van Egteren, Henry. 2003. Inflation, investment, and economic performance: The role of internal financing. Manuscript.
14. Williamson, Stephen D. 1993. Finance, entrepreneurship, and growth: Theory and evidence, *Journal of Monetary Economics*, 32 (December), pp. 513–42.

Summary

The empirical findings of a negative association between inflation and real economic growth (for example Barro 1995) generated enormous interest and much subsequent work. An obviously important issue was to determine if this association really existed and, after that had been done, to try to explain why. Another important empirical finding at about the same time was that financial intermediaries (banks and markets) seem to play a key role in economic development (Levine and King 1993a, b, Levine and Zervos 1998).

The obvious link between the two findings is the possibility that inflation might be affecting real growth through the financial markets, specifically by damaging financial markets or impeding their operation. Especially the focus is at banks investigation. Different empirical studies suggest that higher inflation goes hand in hand with a smaller and arguably less efficient intermediary sector. For banking (but not securities markets), there is evidence of causality running from inflation to financial markets. These combined findings are important given existing work on the importance of financial intermediation in economic development. It is probably premature to conclude that inflation is or is not a major factor associated with banking crises. This is difficult to ascertain empirically, especially given the problems in dating and defining banking crises.

Results of both these studies suggest that nominal bank margins are positively and significantly affected by inflation, but that real bank margins are significantly negatively affected.

Key words: Bank Crises, Financial Intermediary, Financial markets, Inflation.

MBI HUAZIMET E GJUHËS GREKE NGA AJO ANGLEZE

M.Sc. Aida Zoto

Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Ekonomik

Departamenti Menaxhim Turizmi

zotoaida@gmail.com

Abstrakt

Globalizmi, si dukuri sociale e kulturore e kohëve moderne, është kombinim i forcave ekonomike, teknologjike, socio-kulturore e politike që përfshin të gjitha fushat e veprimtarisë dhe si rrjedhojë edhe gjuhën. Huazimet gjuhësore lidhen drejtpërdrejt me procesin e ndryshimit dhe zhvillimit të gjuhës. Studimi i elementëve të huazimit të një gjuhe na ofron ndihmë për të përshkruar në mënyrë sinkronike procesin evolucionar, për të identifikuar faktorët politikë, kulturorë, socialë dhe ekonomikë të saj, por edhe për të regjistruar stilet dhe mënyrat e huamarrjes gjuhësore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është një shqyrtimi sistematik i fenomenit të huazimit në nivel ndër-gjuhësor të njësive leksikore të huazuara të gjuhës moderne greke nga ajo angleze.

Në përfundim vijon klasifikimi i këtyre huazimeve në dy kategori kryesore: a) në pjesët e ndryshueshme të ligjëratës dhe b) në pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Më tej, brenda këtyre dy kategorive, vijon dhe ndarja e tyre sipas: a) kriterëve morfologjike e semantike dhe b) burimeve disiplinore e stilistike.

Fjalë kyçe: huazime gjuhësore, zhvillime gjuhësore, klasifikimi i huazimeve gjuhësore

1. Huazimet

Mënyra më e rëndësishme e ripërtëritjes dhe pasurimit të fjalorit është përmes fenomenit të *huazimit gjuhësor*. Huazimi gjuhësor, lehtësisht më i dukshëm në pjesën e fjalorit, ndodh ose si rezultat i kontaktit gjuhësor apo i ndërveprimit kulturor mes popujve që flasin gjuhë të ndryshme, ose si rezultat i hyrjes së fjalëve nga përdorimi i përbashkët i një fjale të së njëjtës gjuhë (nga një periudhë më e hershme ose nga dialektet socialo-gjeografikë), dhe nënkupton pranimin e një elementi të ri, paralelisht me integrimin e tij në këtë sistem bashkëkohor gjuhësor. Përgjithësisht, huazimet ndodhin ose për të mbuluar nevojat e reja shprehëse, të cilat vazhdimisht shtohen, pasi kultura dhe teknologjia përparojnë, ose për të shprehur ndryshe, pra, me nuanca të reja semantike, koncepte ekzistuese. Tipari kryesor i fjalëve të huazuara është se me kalimin e kohës dhe gjatë përdorimit të tyre, ato përshtaten në sistemin e gjuhës së re dhe shndërrohen në elementë funksionalë, të përfshirë në ndjenjën gjuhësore të folësve amtarë dhe, më tej, ato bëhen pjesë e procesit të fjalëformimit¹.

Duke iu referuar veçanërisht gjuhës greke, mund të themi se në trungun e saj leksikor indoevropian, me kalimin e viteve, janë shtuar një numër i madh dhe një shumëllojshmëri fjalësh. Në terma sasiorë, huamarrja leksikore, haset kryesisht në pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (kategoria e emrave, mbiemrave, foljeve etj.) dhe, në fund, në pjesët e pandryshueshme të ligjëratës (kategoria e ndajfoljeve, lidhëzave, pasthirmave etj.).

2. Burimet, llojet dhe metodat e huazimit

Huazime popullore dhe librore

Kjo ndarje, si kanal transmetues i huazimeve, bazohet në individët apo në grupet e individëve nga të cilët realizohen huazimet. Në disa raste këto fjalë i përshtaten sistemit gjuhësor të Gj.1 (gjuha pritëse) dhe në disa raste ato qëndrojnë të pandryshuara². Kështu huazimet popullore, u referohen huazimeve të realizuara nga shtresat e popullsisë. Vërehet kryesisht shkëmbimi

1 Μήτσης, Σ. Ν., κ.ά. 2012. Το λεξιλόγιο. Θεωρητική προσέγγιση και διδακτικές εφαρμογές. Αθήνα: Gutenberg, 87-90 (διασκευή).

2 Παπαναστασίου, Γ. 2001. Γλωσσικός δανεισμός. Α.-Φ. Χριστίδης & Μ. Θεοδοροπούλου (επιμ.) Εγκυκλοπαιδικός Οδηγός για τη Γλώσσα. Θεσσαλονίκη: Κέντρο Ελληνικής Γλώσσας, 45-49. http://www.komvos.edu.gr/glwssa/Odigos/thema_a7/a_7_thema.htm.

i elementëve në gjuhën e folur dhe tendenca e folësve për t'i përshtatur ato në sistemin e tyre gjuhësor (fonologjikisht dhe morfologjikisht)³. Nga ana tjetër, huazimet librore⁴, të hyra në njëqind e pesëdhjetë vitet e fundit, u referohen huazimeve të realizuara nga një grup folësish të arsimuar (njerëzit e librave), të cilët zotërojnë shumë mirë gjuhën nga e cila vijnë huazimet. Vërehet kryesisht shkëmbimi i elementëve në gjuhën e shkruar, madje, në shumicën e rasteve, janë po ata të cilët përcaktojnë formën dhe mënyrën e përdorimit të këtyre fjalëve. Këto fjalë kanë hyrë në gjuhë për të shprehur kryesisht nocione të pedagogjisë, të shkencave e të arteve, për të cilat gjuha nuk dispononte fjalë. Madje në disa raste, këto fjalë kanë hyrë në sistemin gjuhësor me qëllim zëvendësimin e huazimeve laike, të cilat u quajtën elementë gjuhësorë të një cilësie të dobët⁵.

Huazime të brendshme dhe të jashtme

Kjo ndarje, si burim huazimi, lidhet me prejardhjen e fjalës së huazuar. Kështu, huazimet e brendshme ose të trashëguara, u referohen elementëve gjuhësorë të “huazuar” nga format e mëparshme gjuhësore ose nga dialektet e saj. P.sh. në gjuhën moderne greke fjalët “πατέρας” dhe “μητέρα”, janë të trashëguara nga fjalët “πατήρ” dhe “μήτηρ” të greqishtes së epokës bizantine. Me kalimin e viteve këto fjalë ndryshuan duke iu nënshtruar një transformimi për të arritur në formën e tyre aktuale⁶. Nga ana tjetër, huazimet e jashtme, u referohen përdorimit të elementëve gjuhësorë të Gj.2 (gjuha burim) në Gj.1 (gjuha pranuese). Pra, ato vijnë nga një gjuhë “e huaj”⁷. Këto fjalë ose kanë hyrë në Gj.1 të pandryshueshme/të paprekura, si p.sh. “αλκοόλ”, angl. “alkool”, ose i janë përshtatur sistemit fonologjiko-morfologjik të Gj.1 dhe janë zhvilluar më tej, si p.sh. “σοσιαλισμ-ός”, angl. “socialism”.

3 Πετρούνας, Ε. 2002. Νεοελληνική Γραμματική και Συγκριτική («αντιπαραθετική») Ανάλυση. 1^{ος} τόμ., Φωνητική και Εισαγωγή στη Φωνολογία. Μέρος Α΄ Θεωρία. Θεσσαλονίκη: Ζήτη, 56-61.

4 Triadafilidhis, M. A. 1995. Gramatikë evogëlegreqishtessë re. Përkth. Qiriaz, Dh. Universiteti Aristotelisi Selanikut. Instituti Studimeve Neohelenike. Selanik. 52.

5 Μπαμπινιώτης, Γ. 1998 Συνοπτική ιστορία της ελληνικής γλώσσας, Ι. Φωνολογία. Αθήνα, 1985.

6 Petrounias, E. 1997. Loan Translation and the etymologies of Modern Greek Στο Greek Linguistics '95. τ. 2, 791-801. Σάλτσμπουργκ: University of Salzburg, The Department of Linguistics.

7 Apostolou-Panara, A. 1991. *English Loanwords in Modern Greek: An Overview*. Terminologie et Traduction 1, 45-60.

Huazime të drejtpërdrejta dhe të përkthyer

Kjo ndarje, i referohet mënyrës me të cilën realizohet huazimi. Kështu, dallojmë huazimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta – realizohen duke u bazuar në përbërjen identike fonetike, pra, ato hyjnë në Gj.1 njësoj siç edhe shqiptohen⁸ – dhe huazimet e përkthyer. Huazimet e përkthyer (pjesë e huazimeve popullore), realizohen nga të arsimuarit (akademikët), të cilët edhe pse e huazojnë një fjalë nga Gj.2 në Gj.1, ata nuk e përshtatin atë sipas kriterëve fonetike të Gj.1 por e përkthejnë atë duke përdorur elementë gjuhësorë ekzistues të gjuhës amtare. P.sh. për fjalën “ουρανοξύστης”, ndërkohë që analizohet morfologjikisht në elementë grekë (<ουραν(ός) -o- + ξυσ- (ξύω -της), në realitet është një përkthim i huazuar nga gjuha angleze “sky-scraper”, pasi është përkthyer në gjuhën greke çdo element i fjalës angleze: sky “ουρανός”, scrap(e) “ξύω -της (morfemë që tregon mjet).

Përkthimi mund të përkohë totalisht, ose jo, dhe në rastin e dytë, bëhet fjalë për *huazime të një përkthimi të lira* (jo fjalë për fjalë)⁹. Në kategorinë e huazimeve të përkthyer duhet të përfshijmë dhe *huazimet semantike*. Bëhet fjalë për huazimet kur një fjalë merr një kuptim të ri nën ndikimin e një fjalë të huaj, e cila mbart dy kuptime. Pra, janë rastet kur Gj.1 përkthen fjalën e Gj.2 dhe rezultat i këtij përkthimi është një fjalë e cila tashmë ekziston në gjuhë, por me një kuptim të ndryshëm semantik. P.sh. sot, në gjuhën moderne greke hasim fjalën “ποντίκι” e cila sot përdoret dhe me kuptimin “pajisje e vogël e lidhur me një kompjuter elektronik”. Kjo fjalë përfaqëson një përkthim të fjalës së anglishtes “mouse”; a) “brejtës gri”; dhe b) “pajisje e vogël e lidhur me një kompjuter elektronik”. Si pasojë, fjala greke “ποντίκι”, e cila kishte vetëm kuptimin “brejtës gri”, tashmë ka marrë dhe një interpretim të ri.

Huazime të përshtatura dhe të papërshtatura

Përshtatja ose jo në sistemin gjuhësor e fjalëve të huazuara shpesh varet

8 Παπαναστασίου, Γ. 2001. Γλωσσικός δανεισμός. Α.-Φ. Χριστίδης & Μ. Θεοδοροπούλου (επιμ.) Εγκυκλοπαιδικός Οδηγός για τη Γλώσσα. Θεσσαλονίκη: Κέντρο Ελληνικής Γλώσσας, 51-53. http://www.komvos.edu.gr/glwssa/Odigos/thema_a7/a_7_thema.htm.

9 Χαλαραμπάκης, Χ. 1991. Μεταφραστικά δάνεια της Νέας Ελληνικής από Ευρωπαϊκές γλώσσες. Μελέτες για την Ελληνική γλώσσα. Πρακτικά της 11^{ης} Ετήσιας Συνάντησης του Τομέα Γλωσσολογίας της Φιλοσοφικής Σχολής του Αριστοτελείου Πανεπιστημίου Θεσσαλονίκης, 26-28 Απριλίου 1990. Θεσσαλονίκη. 81-102.

nga faktorë të ndryshëm si: koha, prejardhja, përdorimi i termit, ngjashmëritë dhe diferencat fonologjike midis dy gjuhëve apo nevoja dhe kërkesa semantike e Gj.1 (për shkak të mungesës së termave të caktuara). Përgjithësisht, fjalët të cilat kanë hyrë përmes kanalit transmetues popullor, përshtaten më shpejt, por paralelisht, duhet të theksohet se niveli i përshtatjes fonologjike, morfologjike dhe semantike nuk është i njëjtë pavarësisht burimeve apo metodave të huazimeve.

Si konkluzion mund të themi se një fjalë e huazuar quhet *e përshtatur* kur, ajo paraqet një shkallë integrimi në nënsistemet gjuhësore të një gjuhe (fonologji - morfologji - semantikë). P.sh. “ιδιωματικός, -ή, -ό” / angl. “idiomatic” ose “ολιστικός, -ή, -ό” / angl. “holistic”. Këto fjalë, për shkak të pajtueshmërisë morfologjike, janë të ndryshueshme. Në rastin e kundërt, pra në rastin e *mospërshtatjes*, u referohemi atyre huazimeve të cilat, kryesisht, në nënsistemet fonologjike dhe morfologjike, nuk janë integruar ende. P.sh. “έθνικ” / angl. “ethnic” ose “σούπερ” / angl. “super”. Këto fjalë, për shkak të përshtatjes në shkallë të ulët, mbeten të pandryshueshme edhe pse ato janë pjesë e ligjëratës (folje, emër, mbiemër etj.), p.sh. “μενού” / angl. “menu”¹⁰.

Huazime të shënjuara dhe të pashënjuara

Nevojat e menjëhershme të folësve për të mbuluar mungesën e një fjale nga sistemi gjuhësor midis shënjesit dhe fjalës së shënjuar, kryesisht në fushën e shkencës dhe teknologjisë, sollën huazimet e *shënjuara*. Bëhet fjalë për objekte, koncepte dhe shërbime të importuara nga një vend i huaj dhe që kanë nevojë të menjëhershme për emërtim. P.sh. “βίντεο” / angl. “video”; “βατ” / angl. “watt”. Shpesh, huazimet e shënjuara i hasim dhe në fushën emocionalo-psikologjike, si p.sh. “οκέι” / angl. “okey”; “ριλαξ” / angl. “relax” (në vend të “ξεκουράζομαι”)¹¹.

Huazime fluturake (të rikthyera)

Huazime fluturake, konsiderojmë ato njësi leksikore të cilat kanë depërtuar

Gjatë procesit të integritetit dhe përshtatjes së saj në gjuhën pritëse, fjala e huazuar, fiton karakteristikat e kategorisë gramatikore dhe më tej, ajo bëhet pjesë e strukturës morfologjike të fjalës, e sistemit fonetik dhe tipave të fjalëformimit duke u asimiluar përfundimisht në gjuhën pritëse. Megjithatë, shumë fjalë iu bashkuan relativisht kohët e fundit fjalorit të gjuhës greke dhe ende nuk janë asimiluar plotësisht në të. Kështu ato përbëjnë ende një trup të huaj dhe nuk janë përfshirë në sistemin e fjalëformimit.

Në përmbyllje mund të themi se fjalët e huazuara nuk tregojnë varësi intelektuale apo gjuhësore, në të kundërt, ato shprehin një përpjekje të folësve natyrorë për të përvetësuar koncepte të reja duke u bërë pjesë e njohurive botërore shkencore. Përmes ndërgjegjësimit apo vetëdijes mbi sfondin e përbashkët gjuhësor, vihet re se ekziston një mendim universal, i gjithëpushtetshëm, në të cilin nuk ka vend për paragjykime dhe frikë për kërcënimin apo humbjen e identitetit kombëtar dhe gjuhësor.

Bibliografia:

1. Apostolou-Panara, A. 1991. *English Loanwords in Modern Greek: An Overview*. Terminologie et Traduction 1, 45-60.
2. Petrounias, E. 1997. Loan Translation and the etymologies of Modern Greek Στο Greek Linguistics '95. τ. 2, 791-801. Σάλτσμπουργκ: University of Salzburg, The Department of Linguistics.
3. Triadafilidhis, M. A. 1995. Gramatikë e vogël e greqishtes së re. Përkth. Qiriazhi, Dh. Universiteti Aristotelis i Selanikut. Instituti i Studimeve Neohelenike. Selanik.
4. Αναστασιάδη-Συμεωνίδη, Α. 1985β. Πώς ορίζεται ο όρος 'αντιδάνειο;. Μελέτες για την Ελληνική Γλώσσα. Πρακτικά της 6^{ης} Ετήσιας Συνάντησης του Τομέα Γλωσσολογίας του Α.Π.Θ. (22-24 Μαΐου 1985). Θεσσαλονίκη: Κυριακίδης, 261-268.
5. Αναστασιάδη-Συμεωνίδη, Α. 1994. Νεολογικός δανεισμός της νεοελληνικής. Άμεσα δάνεια από τη γαλλική και την αγγλοαμερικανική. Μορφο-φωνολογική ανάλυση. Θεσσαλονίκη: Υπηρεσία Δημοσιευμάτων Α.Π.Θ.
6. Μήτσης, Σ. Ν., Παραδία, Μ., & Μήτση, Α. 2012. Το λεξιλόγιο. Θεωρητική προσέγγιση και διδακτικές εφαρμογές. Αθήνα: Gutenberg, 87-90 (διασκευή).
7. Μπαμπινιώτη, Γ. 2002. Λεξικό τής Νέας Ελληνικής Γλώσσας. Β' έκδοση.
8. Μπαμπινιώτη, Γ. 2012. Λεξικό τής Νέας Ελληνικής Γλώσσας. Δ' έκδοση.
9. Παπαναστασίου, Γ. 2001. Γλωσσικός δανεισμός. Α.-Φ. Χριστίδης & Μ. Θεοδοροπούλου (επιμ.) Εγκυκλοπαιδικός Οδηγός για τη Γλώσσα. Θεσσαλονίκη: Κέντρο Ελληνικής Γλώσσας, 45-49. http://www.komvos.edu.gr/glwssa/Odigos/thema_a7/a_7_thema.htm).
10. Σκιαδάς, Γ. 2014. Τα δάνεια της Νεοελληνικής από την Αγγλική Γλώσσα - Μορφολογική ανάλυση. Έρευνα, Επιθεώρηση Εκπαιδευτικών-Επιστημονικών Θεμάτων, Τεύχος 3^ο, σ. 159-176.
11. Χαραλαμπίδης, Χ. 1991. Μεταφραστικά δάνεια της Νέας Ελληνικής από Ευρωπαϊκές γλώσσες. Μελέτες για την Ελληνική γλώσσα. Πρακτικά της 11^{ης} Ετήσιας Συνάντησης του Τομέα Γλωσσολογίας της Φιλοσοφικής Σχολής του Αριστοτελείου Πανεπιστημίου Θεσσαλονίκης, 26-28 Απριλίου 1990. Θεσσαλονίκη. 81-102.

Summary

Globalization, as a social and cultural phenomenon of modern times, is a combination of economic, technological, socio-cultural and political forces spanning all fields of activity and, thus, language. Linguistic borrowings are directly related to the process of language change and development. Study borrowing elements of a language can help us to describe the synchronization evolutionary process in order to identify the political, cultural, social and economic aspects, but also to record the styles and methods of linguistic borrowing.

The main purpose of this paper is a systematic examination of the phenomenon of borrowing in cross-linguistic level of borrowed lexical units of the modern Greek language from English.

In conclusion, the classification of these borrowings is divided into two main categories: a) in the variable parts of speech and b) i in the unvariable parts of speech. Further, within these two categories, follows and their division according to: a) morphological and semantic criteria; and b) disciplinary and stylistic resources.

RAPORTI MIDIS LIRISË DHE BARAZISË SIPAS ALEXIS DE TOCQUEVILLE

Anila Kashnjeti

Abstrakt

Problemi i ekuilibrit midis lirisë individuale dhe fuqisë së shtetit është një nga problemet më të mëdha që shoqërisë i është dashur të përballojë në rrjedhën e jetës. Një nga autorët që në rrjedhën e historisë është përpjekur që të gjejë një zgjidhje për këtë problem është Alexis de Tocqueville. Tocqueville është një nga filozofët dhe studiozët më të rëndësishëm të mendimit liberal dhe ka dhënë gjatë jetës së vet një kontribut mjaft të rëndësishëm për shkencat sociale.

Barazia mund të mbretërojë në shoqërinë civile dhe mos të mbretërojë aspak në botën politike.

Mund të kesh të drejtën të kujdesesh vetëm për kënaqësitë e tua, të keni të njëjtat profesione, të takoheni të njëjtat vende, pra të jetoni në të njëjtën mënyrë dhe të ndiqni pasurinë me të njëjtat mjete, por pa pasur të gjithë të njëjtën të drejtë për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit. Një lloj barazie mund të vendoset edhe në botën politike megjithëse aty nuk ka aspak liri politike.

Fjalë kyçe: barazia, liria, demokracia

Problemi i ekuilibrit midis lirisë individuale dhe fuqisë së shtetit është një nga problemet më të mëdha që shoqërisë i është dashur të përballojë në rrjedhën e jetës. Një nga autorët që në rrjedhën e historisë

është përpjekur që të gjejë një zgjidhje për këtë problem është Alexis de Tocqueville. Tocqueville është një nga historianët dhe studiozët më të rëndësishëm të mendimit liberal dhe ka dhënë gjatë jetës së vet një kontribut mjaft të rëndësishëm për shkencat sociale. Në vitin 1831 zhvendoset në Shtetet e Bashkuara për të vëzhguar më mirë situatën politike franceze dhe në të njëjtën kohë për të studiuar parimet e demokracisë amerikane dhe prejardhjen e saj.

Përgjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara Tokëvili shkruan Demokracia në Amerikë që pati një sukses të madh dhe u bë pjesë e trashëgimisë formuese të një gjenerate të tërë aq sa u lexua edhe nga Cavour. Tokëvili përpiket të analizojë shoqërinë amerikane duke u përpjekur të zbulojë faktorët që bëjnë të mundur zbatimin e demokracisë në kontekstin amerikan. Autori adopton një metodë krahasuese duke bërë krahasime të herë pas herë midis situatës amerikane dhe situatës franceze. Tokëvili e vështroi me respekt shoqërinë amerikane, kjo në fakt është një shoqëri e hapur në të cilën çdo individ gëzon të drejta të barabarta, nuk ka dallime klasash dhe gjithësecili ka mundësi të afirmohet. Liberali francez më pas vë në pah lirinë që gjithësecili ka për të shprehur lirisht besimin e vet dhe kontributin që feja është në gjendje të japë për shoqërinë.

Gjithashtu Tokëvili tregon edhe për rreziqet që i kanosen demokracisë dhe që derivojnë nga tirania e mazhorancës dhe nga individualizmi, por autori shikon se sistemi amerikan ka qenë në gjendje të gjejë mjetet e duhura për ta mbrojtur demokracinë nga rreziqe të tilla. Këto mjete sipas tij janë teoria e interesit e kuptuar ashtu siç duhet nga decentralizimi administrativ dhe nga bashkimet e njerëzve.

Tokëvili e shkruajti Demokracinë në Amerikë në dy pjesë të parën në vitin 1835 dhe të dytën në vitin 1840 pasi kthehet në Francë. Disa besojnë se ka dy Demokraci sipas Tokëvilit përse kohë në veprën e parë ai përshkruan në mënyrë entuziaste të rejtat që vëzhgon në sistemin administrativ dhe gjyqësor që mund të ndikojë në rritjen e Francës, ndërsa në veprën e dytë ai përshkruan zakonet ose ndryshimet sociale që vijnë si rrjedhojë e barazisë së kushteve të cilat bëjnë që të lindin dyshime mbi potencialin pozitiv të tyre. Tokëvili analizon institucionet administrative dhe gjyqësore të Shteteve të Bashkuara për të kuptuar sesi demokracia ndikon tek idetë dhe zakonet e shoqërisë

amerikane. Ai zgjedh pikërisht Shtetet e Bashkuara meqënëse është i vetmi shtet që ka lindur demokratik dhe nuk ka prejardhje monarkike. Organizimi i demokracisë në botën e krishterë sipas Tokëvilit është problemi i madh politik i kohës sonë¹ . dhe vazhdon të analizojë ato që janë bazat e demokracisë amerikane dhe shkatërron idenë e 1700 sipas së cilës demokracia është një formë qeverisjeje e përshtatshme vetëm për shtetet e vogla.

Tokëvili e nis analizën me “skandalin e shkaktuar nga paaftësia e kombeve të botës së vjetër për të njohur dhe për të pranuar të ardhmen e pashmangshme demokratike.”² Për Tokëvilin demokracia është frut i një evolucioni historik që lind në Mesjetën e hershme nuk ka një karakter statik por është një proces evolues i drejtuar drejt eliminimit të pabarazive. Demokracia është një proces i pandalshëm dhe të gjithë kontribuojnë në suksesin e tij pasi të gjithë e përdorin ide e bashkëndarë edhe nga John Stuart Mill. Tokëvili pohon se “statusi social i amerikanëve është demokratik” kjo ka ardhur si rrjedhojë e barazisë që karakterizonte emigrantët e Amerikës së Veriut. Barazia i përket jo vetëm pasurive por edhe inteligjencave. Në fakt studiuesi mendon se arsimimi është e drejtë e të gjithëve. Parimi i sovranitetit popullor në Amerikë është i njohur nga zakonet dhe i stabilizuar nga ligjet.

Tokëvili krahason qeverinë aristokratike dhe demokracinë dhe zbulon sesi difektet e demokracisë shikohen menjëherë ndërsa avantazhet e saj shikohen vetëm në një periudhë të gjatë kohore. Ligjet demokratike midis të tjerave duke qenë frut i shumicës së njerëzve synojnë mirëqënien e popullit ndërsa aristokracia synon të favorizojë një minorancë njerëzish. Avantazhi i demokracisë ka të bëjë me faktin se synon të favorizojë mirëqënien e shumicës.

Demokracia bazohet mbi idenë e sovranitetit popullor që frymëzohet nga sovraniteti i një monarku të vetëm. Sovraniteti popullor në dallim nga ai i një personi të vetëm mund të ushtrohet vetëm në formë indirekte në fakt populli duhet të delegoj sovranitetin përfaqësuesve të zgjedhur prej tij dhe këtu lind problemi i zgjedhjes së përfaqësuesve. Tokëvili shikon sesi në Shtetet e Bashkuara në dallim nga Evropa ku besohet se demokracia dhe votimi

1 A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America, Scritti politici*, Utet, Torino 1968, vol. 2, p. 367.

2 M. GAUCHET, *Tocqueville, l'America e noi. Sulla genesi delle società democratiche*, Donzelli Editore, Roma 1996, p.6.

i përgjithshëm lejojnë që të jenë në krye të drejtimit të vendit njerëz me potencial dhe besim publik atje rradhë njerëzit më të shquar thirren për të drejtuar vendin. Ai beson se kjo vjen si rrjedhojë e rrethanave pasi në kohët e shkuara kur Shtetet e Bashkuara luftonin për t'u shkëputur nga pushteti anglez pushteti i ishte caktuar njerëzve me potencial superior, ndërsa tani populli i ndalon përfaqësuesit e tij që të largohen nga dëshirat e masës duke sjellë në këtë mënyrë largimin e njerëzve më të nderuar nga skena politike. Ata që thirren për të drejtuar punët publike në Shtetet e Bashkuara janë inferior në kapacitet nga ata që thirren për të drejtuar punët publike në aristokraci por kanë të njëjtat interesa të mazhorancës dhe si rrjedhojë megjithëse mund të bëjnë gabime ata nuk devijojnë nga interesat e shumicës. Tokëvili pohon se "kur armiq të e demokracisë pretendojnë se një i vetëm mund të qeverisë më mirë sesa qeverisja e të gjithëve mendoj se kanë të drejtë" ³Megjithatë nuk duhet të bëjmë gabimin për ta interpretuar këtë pohim sikur ai preferon një qeverisje vertikale nga një njeri i vetëm por autori do të thotë se ai që do të qëndrojë në krye të vendit duhet të ketë vazhdimësi në iniciativat e veta.

Populli merr pjesë në formimin e ligjeve duke zgjedhur legjislatorët e vet dhe ndikon mbi ta për të zgjedhur zbatuesit e ligjit që janë agjentet e pushtetit ekzekutiv dhe formon jurinë e cila ndëshkon shkelësit e ligjit.

Lind pyetja se nëse në marrëdhënien midis të qeverisurve dhe qeveritarëve është i mundur të kontrollohet shkëmbimi. Në dallim nga shoqëritë e tipit ushtarak, në demokraci qeveritarët janë në shërbim të shoqërisë dhe bashkimi nuk është më detyrues por vullnetar. Ideologjia dhe gjykimet e popullit janë gjykime ideologjike pra janë gjykime që i mungon përmbajtja apo informacioni për sa kohë informacioni kushton dhe prandaj preferon të japë gjykime ideologjike.

Ka një lloj ngatërrese kohore për sa kohë ai që qeveriset i jep të drejtën qeverisësit që të drejtojë përpara se t'i shoh veprën e tij. Pra e vetmja mënyrë që populli ka për t'u mbrojtur nga gënjeshtra është kufizimi i pushtetit të qeveritarëve. Pra duhet të kufizohet pushteti i përfaqësuesve pasi në të kundërt do të bllokohej mekanizmi i kërkimit të të panjohurës dhe e korrektimit të gabimeve që do të sillte rënien e produktivitetit. Sundimtari

3 A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015, p. 57.

është në një pozicion të privilegjuar dhe gëzon një forcë legjitime ose ndryshe një forcë në përputhje me shtetin.

Veberi përshkruan figurën e aventurierit politik që është një subjekt që realizon qëllimet e tij dhe jo ato të popullit dhe që karakterizohet nga mashtrimi i përhershëm. Pushteti mund të kufizohet me bashkimin shoqëror që kufizon ndërhyrjen e dorës publike duke e ndaluar si rrjedhojë që t’i marrë burimet ekonomike qytetarit në këtë mënyrë politika është një variabël i varur nga bashkimi shoqëror vullnetar. Në vendet demokratike të gjithë qytetarët përfaqësojnë pjesë të barabarta të sovranitetit dhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë në qeverisjen e shtetit. Tokëvili shikon tek qytetari amerikan se “ai i bindet shoqërisë jo sepse është inferior me ata që e drejtojnë apo më pak i aftë se një tjetër për të qeverisur por sepse bashkimi me të ngjashmit e tij i duket e dobishme dhe sepse e di që ky bashkim nuk mund të ekzistojë pa një pushtet rregullues.”⁴ Njerëzit në fakt bashkëpunojnë pasi të vetëm nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë dhe kanë nevojë për të bashkëpunuar me njerëzit e tjerë, pasi janë të panjohur. Tokëvili dallon tek shoqëria amerikane një sistem të bazuar mbi bashkëpunimin vullnetar ku njerëzit janë të vendosur në të njëjtin rrjesht pasi të vetëm janë të pafuqishëm. Në veçanti Adam Smith flet për një dorë të padukshme dhe për këtë beson se veprimi njerëzor duhet të ndahet në dy pjesë: “atë që bëjmë me iniciativën tonë individuale për të arritur qëllimin tonë dhe atë që bëjmë për të arritur bashkëpunimin me të tjerët.

⁵Pra gjithësecili për të realizuar qëllimet e tij favorizon dhe ndihmon në arritjen e qëllimeve të të tjerëve.

Sipas Tokëvilit ekzistojnë tre shkaqe kryesore që lejojnë ruajtjen e republikës demokratike në Shtetet e Bashkuara: territori dhe origjina, ligjet dhe zakonet. Ajo që evidenton si arsye të parë Tokëvili është fakti se amerikanët nuk kanë fqinj të fuqishëm dhe si rrjedhojë nuk duhet të shqetësohen për luftëra të mëdha, themeluesit e kombit amerikan sollën idenë e barazisë së kushteve që favorizon normalisht republikën demokratike. Duke iu referuar shkakut të dytë filozofi sheh tek forma federale e përshtatur nga amerikanët, në institucionet komunale dhe tek pushteti gjyqësor faktorët që e bëjnë të

⁴ A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015, p. 250.

⁵ A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015, p. 73.

sigurtë dhe të fuqishme republikën, duke kufizuar pushtetin e mazhorancës dhe duke korrigjuar gabimet e demokracisë. Tek zakonet ai sheh shkakun e tretë që bën të mundur ruajtjen e demokracisë pasi shikon sesi amerikanët janë gjithmonë në harmoni me zakonet duke kuptuar me zakonet statusin moral dhe intelektual të popullit.

Liria dhe barazia

Midis aspekteve të ndryshme të shoqërisë amerikane njëra në veçanti tërheq vëmendjen e Tokëvilit: barazia e kushteve. Ai shikon se në shoqëri ka një nivelim shoqëror, nuk ka privilegje nga lindja, shoqëria është e hapur dhe mund të zgjedhësh lirisht grupin me të cilat ndan të njëjtat preferenca.

Amerikanët lindin të lirë, dhe për të arritur kushte të tilla nuk i është dashur të luftojnë kundër një sistemi që ka ekzistuar më parë, barazia është shtyllë e shoqërisë demokratike. Në Francë përkundrazi shoqëria është e ndarë në klasa dhe barazia përfaqëson objektivin final e cila arrihet përmes revolucionit që e modifikon shoqërinë në themel të saj duke garantuar në të njëjtën kohë lirinë. Amerikanët në dallim nga francezët nuk kanë realizuar një revolucion të dhunshëm për të pohuar parimet demokratike dhe mungesa e konfliktit midis klasave është një aspekt tjetër që dallon shoqërinë amerikane nga ajo franceze. Shoqëria demokratike pra favorizon mobilitetin social në dallim nga shoqëria e rregjimit të vjetër që karakterizohej nga preardhja sociale.

Barazia e kushteve në Shtetet e Bashkuara mund të gjendet edhe tek inteligjencat megjithatë nuk përfshin zhdukjen e pabarazive të natyrës ekonomike dhe sociale. Tokëvili mendon se tendenca e përgjithshme e popujve është demokracia dhe se shoqëria demokratike do të triumfojë sepse është sistemi që garanton lumturinë për numrin më të madh të njerëzve. Në një shoqëri demokratike njerëzit mund të arrijnë qëllimet e tyre pa pengesa të llojit të preardhjes sociale apo përkatësisë sociale përveç të tjerave një shoqëri e këtij lloji favorizon bashkëpunimin dhe konkurrencën dhe i shpërblen njerëzit në bazë të meritave personale dhe jo të natyrës trashëgimore. Demokracia përveçse favorizon barazinë zhvillon edhe zilinë midis njerëzve.

Njerëzit në fakt kërkojnë ta arrijnë vazhdimisht barazinë që megjithatë

vazhdimisht ajo i largohet dhe që për këtë arsye Tokëvili shkruan se “populli me zjarr përpiqet që ta arrijë këtë të mire që është aq afër sa për ta njohur por shumë larg për ta arritur” “Tokëvili pretendon se barazia herët a vonë do të ndikojë edhe politikën dhe dallon dy mënyra përmes së cilës barazia mund të depërtojë në botën politike, ose duke i dhënë të drejtat të gjithëve ose asnjërit. Në rastin e dytë do të vendosej një pushtet absolut, që bën të mundur ardhjen e një legjislatori të madh që do të pretendojë se do të njohë gjithçka dhe do të caktojë fatin e të gjithëve. Por sipas Popperit nuk ekziston një burim i sigurt njohjeje pasi të gjitha “mundet herët a vonë të na çojnë në gabime” 8. Amerikanët kanë arritur të shpëtojnë nga pushteti absolut si rrjedhojë e disa shkaqeve të cilat janë origjina, rrethanat dhe zakonet që kanë të mundur vendosjen e sovranitetit popullor.

Populli amerikan merr pjesë në bërjen e ligjeve përmes përfaqësuesve të tij të cilët vendosen përmes votimit të përgjithshëm që i jep të gjithë njerëzve pushtet të barabartë. Por pushteti është.....pasi edhe pse njerëzit janë të vendosur formalisht në të njëjtën vijë nuk janë realisht kështu. Çdo marrëdhënie sociale është marrëdhënie pushteti. Pra është e lehtë të vihet re se tek amerikanët ka një nivelim të kushteve të pikënisjes, por nuk ka një nivelim në kushtet e jetës. Megjithatë individët i mbajnë vazhdimisht marrëdhëniet midis tyre për këtë arsye një individ megjithëse ka një pushtet më të madh se tjetri që ka përballë do të përpiqet të kufizojë shkallët e tij të lirisë pasi në të kundërt pjesa tjetër do të heqë dorë nga kontrata dhe do të vërë në zbatim ato lloj lirish ku ai është më superior. Tokëvili dallon edhe tek feja faktorin që favorizon barazinë, në fakt feja e krishterë i vendos të gjithë besimtarët në të njëjtin nivel pa asnjë lloj dallimi klase dhe i imponon të njëjtat rregulla të gjithë njerëzve. Katolikët sipas Tokëvilit, janë të shtyrënga besimi i tyre drejt demokracisë, përveç të tjerave duke qenë se shumica janë të varfër dhe në minorancë kërkojnë të kenë sovranitetin popullor për të arritur tek qeverisja kjo i çon ata që të favorizojnë shoqërinë demokratike.

Tokëvili analizon aspektin e lidhur me idenë e përsosjes njerëzore sipas së cilës njerëzit synojnë të perfeksionohen në dallim nga kafshët. Ai shkruan se kombet aristokratike duke i klasifikuar njerëzit në bazë të klasës dhe

6 L. INFANTINO, *Individualismo, mercato e storia delle idee*, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli 2008, p. 256.

lindjes, bllokojnë mekanizmin e kërkimit të të panjohurës dhe të korrigjimit të gabimeve duke kufizuar arritjen e perfeksionit njerëzor. Në të kundërt kombet demokratike janë të karakterizuara nga barazia, që lejon mobilitetin social duke i lënë të kuptojë individëve se kanë mundësi të perfeksionohen por në të njëjtën kohë i bëjnë të ditur njeriut se ai nuk është i pagabueshëm.

Tokëvili shikon se në shoqëritë demokratike barazia e kushteve i zbut zakonet. Në fakt ai shkruan “barazia e kushteve dhe zbutja e zakoneve nuk janë më për mua dy fenomene bashkëkohore por dy fakte të lidhura njëra me tjetrën.”⁷ Tokëvili pohon përveç të tjerave se shoqëria aristokratike bën të mundur që anëtarët që bëjnë pjesë në klasa të ndryshme të kenë opinione dhe ndjenja të ndryshme dhe kërkojnë të mos përzihen, ndërsa ata që bëjnë pjesë në të njëjtën klasë ushqejnë midis njëri tjetrit një simpati që nuk mund të haset as në shoqëritë demokratike. Njerëzit që jetojnë në një shoqëri demokratike në fakt kur munden me kënaqësi përpiqen të ndihmojnë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, tregohen të sjellshëm, me kushtin që kjo mos t’i sjellë dëme. Për Tokëvilin ajo çka vlen për individët vlen edhe për popujt, në fakt në rastin kur dy kombe kanë zakone dhe ligje të ndryshme këto do të tentojnë të mos jenë solidarë njëri me tjetrin, ndërsa në rastin kur dy kombe janë të barabarata në zakone dhe ligje, ato do të përpiqen të jenë të sjellshëm dhe të kuptueshëm midis tyre.

Demokracia synon të nivelojë edhe pozitën midis punëtorit dhe padronit, dy klasa që luftojnë në vazhdimësi me njëri tjetrin për çështjen e pagës. Në një shoqëri demokratike ka shumë sipërmarrës që vështirë se mund të bien dakort për t’i mbajtur pagat e ulëta ndërsa punëtorët gëzojnë disa pasuri që i lejojnë ata që të mos punojnë kur paga nuk i kënaq. Tokëvili beson se për një periudhë të gjatë, punëtorët do të përmirësohen pasi pagat e larta që fitojnë i bëjnë gjithmonë e më shumë të pavarur nga punëdhënësit e tyre, kusht që bën të mundur paga gjithmonë e më të larta. Kështu me rritjen e pagave kushtet tentojnë të barazohen. Situata e kundërt verifikohet në shoqëritë aristokratike ku sipërmarrësit janë pak dhe mund të merren vesh me njëri tjetrin për nivelin e pagave që duhet zbatuar.

Një tjetër konsideratë e Tokëvilit mbi shoqërinë demokratike ka të bëjë

⁷ A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015, p. 297.

me marrëdhëniet e brendshme në familje midis burrit dhe gruas. Shoqëria demokratike tenton të nivelojë kushtet në brendësi të familjes qoftë midis babait dhe djalit dhe midis fëmijëve. Tokëvili shikon se në shoqërite aristokratike ka një hierarki të ashpër në brendësi të familjes, ku babai zë një pozicion dominues dhe fëmijët nuk janë të barabartë midis tyre. Ligjet dhe zakonet demokratike në të kundërt synojnë të rrëzojnë barrierat në brendësi të familjes dhe të bëjnë më intime dhe më të ëmbla marrëdhëniet në brendësi dhe fëmijët janë të barabartë dhe të pavarur. Në të njëjtën mënyrë tek popujt aristokratikë kemi një konsideratë të ndryshme të burrit dhe gruas, qëllimi i martesës është më shumë ajo e bashkimit të pasurive sesa ajo e bashkimit të dy personave që duhen dhe si rrjedhojë lidhja bashkëshortore dobësohet duke sjellë tradhëtinë midis bashkëshortëve. Kjo gjë nuk vihet re tek shoqërite demokratike ku barazia e kushteve rrëzon barrierat ekzistuese midis burrit dhe gruas. Këto e konsiderojnë martesën si një kontratë ku njihen të gjitha klauzolat më përpara dhe se burri dhe gruaja janë të lirë ta pranojnë ose jo, kjo do ta bënte marrëdhënien bashkëshortore më të shtrënguar dhe më të vështirë për të pasur tradhëti midis bashkëshortëve.

Tokëvili më pas analizon marrëdhënien midis barazisë dhe lirisë. Barazia në shoqërinë demokratike mund të jetë një rrezik për lirinë, në fakt ajo synon të masivizojë shoqërinë dhe të mos pranojë dallimet ekzistuese. Liria tek shoqërite demokratike nuk është e përbuzur por në të njëjtën kohë nuk është prioriteti i tyre pasi ata tentojnë të preferojnë barazinë. Ajo çka shikon Tokëvili tek amerikanët e bën atë që të pohojë se “ata vërshojnë drejt lirisë me një impuls të shpejtë dhe me sforco të befasishme, nëse nuk ia arrijnë qëllimit heqin dorë; por asnjë gjë nuk mund t’i kënaq sesa barazia dhe preferojnë më mirë të vdesin sesa ta humbin.”⁸

Liria sipas Tokëvilit mund të gjendet edhe jashtë demokracive ndërsa ajo që i karakterizon shoqëritë demokratike është dashuria për barazinë. Ai vë re se pasioni për barazinë dhe për lirinë janë të ndryshme. Ideja e lirisë tek popujt evropianë është zhvilluar vetëm në momentin kur u pohua barazia e kushteve pra lindi si rrjedhojë e barazisë.

Tokëvili provon të shpjegojë arsyet se përse popujt demokratikë tentojnë

⁸ A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015, p. 527.

të preferojnë barazinën liri. Për Tokëvilin shpjegimi qëndron tek fakti se popujt demokratik besojnë se barazia e kushteve synon të jetë jetëgjatë dhe më e vështirë për t'u shkatërruar pasi duhet të ndryshohen idetë, zakonet dhe ligjet, ndërsa për të humbur liritë politike mjafton që të qëndrosh indiferente.

Tokëvili pohon se “të këqijat që sjell liria janë të menjëhershme të dukshme nga të gjithë dhe të ndjera pak a shumë nga të gjithë. Të këqijat që mund të prodhohen nga barazia ekstreme shfaqen pak nga pak, depërtojnë gradualisht në trupin social, shikohen ndonjëherë, dhe në momentin që bëhen më të rrezikshme zakoni ka bërë të mundur që mos të ndihen më”. Avantazhet e lirisë shfaqen vetëm pas shumë kohësh, ndërsa avantazhet e barazisë janë të menjëhershme dhe shikohen pa ndonjë vështirësi. Ndërsa liria politike duhet të fitohet me shumë sforco, dhe i sjell kënaqësi vetëm disa personave, ndërsa barazia nuk kërkon përpjekje dhe sjell kënaqësi për të gjithë njerëzit. Tokëvili e përmyll duke thënë se “ Unë mendoj se popujt demokratikë provojnë për lirinë një shije natyrore: e kërkojnë, e dashurojnë, dhe shikëputen me shumë dhimbje nga ajo. Por ata kanë për barazinë një pasion të flaktë, të pangopur të përjetshme, të pamposhtur: duan barazinë në liri, dhe nëse nuk e arrijnë këtë gjë e duan edhe në skllavëri”⁹. Kjo është dëshmi sesi për popujt demokratik është themelore barazia dhe për ta arritur janë edhe të gatshëm të humbin lirinë, vetëm që mos të kenë një klasë dominante siç është aristokracia.

Bibliografia

- A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015,
B. L. INFANTINO, *Individualismo, mercato e storia delle idee*, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli 2008

Summary

Equality can reign in civil society but not always in the political world.

You may only have the right to take care of your own pleasures, to have the same professions, to meet the same places, so to live the same way and to pursue the property with the same means but without all the same right

⁹ A. DE TOCQUEVILLE, *La democrazia in America*, BUR, Milano 2015, p. 530

to participate in the governance of the country. A kind of equality can be established in the political world even though there is no political freedom at all. You may be similar to all of your likes, except one who is unquestionably the master of all and who equally chooses his agents for his own power. It would be easy to formulate some kind of hypothesis according to which a total equality can be easily combined with institutions that are less or less free. However, people can not become totally equal without being totally free, and as a result, equality at its highest level is confused with freedom, so it is fair to distinguish one from the other. The taste that people try for freedom and what they try for equality are in fact two different things and I'm not afraid to say that in democracy they are two unequal things.

Tocqueville also points out that democratic society is an individualistic society in which everyone and his family tend to isolate themselves from others. Tocqueville also points out that major political and intellectual revolutions belong to the transition phase between traditional and democratic societies. He also points out that democratic societies can never be satisfied because being equal are inclined to be envious and at the same time conservative.

Democratic societies according to Tocqueville do not favor war because they regard it as a pervert of the normal state of peace, but that does not mean they will not develop it. Modern societies are shocked by two revolutions: one tries to realize greater equality for the largest number of persons, the other weakens; also called traditional powers. These two revolutions act in the opposite sense, one weakens power, the other strengthens it. Over the course of his work, he wanted to highlight the dangers of equality which are difficult to detect but at the same time are detrimental. Tocqueville claims, among other things, that people who live in the democratic centuries have developed a passion for independence that will be difficult to lose because it depends on their social conditions. Tocqueville asserts that the future will depend on the capacity of the nations to ensure that equality does not lead to slavery and misery but to freedom and prosperity.

KUMTESË: VIRTYTI, JETA DHE VDEKJA

M.Sc. Dorian Sevo

Kolegji Universitar "Logos"

Abstrakt

Në këtë diskurs dëshiroj të paraqes natyrën njerëzore, moralin njerëzor, dinjitetin e njeriut, moralin antik dhe stoicizmin e frymëzuar nga Sokrati. Diskursi vërtitet rreth problemeve morale antike por edhe rreth disa shembujve bashkëkohorë, duke risjellë në vëmendje Sokratin dhe guximin e tij stoik, Platonin, nxënësin e tij brilant, Senekën e dashur romak si dhe Montenjin, një filozof i natyrës njerëzore.

Fillimisht punimi diskuton rreth moralit antik grek e romak, dhe më pas ndalet në disa problematika kryesore lidhur me ambientin që na rrethon, duke këmbëngulur se rruga e vetme dhe e vërtetë për ta shpëtuar njeriun prej dekadencës morale është ungjilli, religjioni në përgjithësi, poezia, tregimtaria, romani, letërsia në përgjithësi dhe e hyjnueshmja muzikë.

Për ta shpëtuar njeriun prej degradimit të pakuptueshëm që po i ndodh në periudhën e shekullarizimit dhe për të ndaluar degradimin në moral duhet me patjetër të merremi me këto, kryesisht me religjion dhe me metafizikë.

Dy ndër figurat kryesore, ose më saktë ndër më kryesoret të periudhës antike greke lidhur me problemet e moralit, pra atë të virtytit por jo vetëm, janë padyshim dy figurat më të mëdha të antikitetit grek: Sokrati dhe Platoni - krenaria e Greqisë së lashtë. Këta kollozë, sipas meje, do të krahasoheshin me dy kolonat e Herkulit (dy portat e Gjibraltarit që në antikitet quheshin portat e Herkulit pasi mendohej se me një të goditur Herkuli lejoi që ujërat e Atlantikut të futeshin në Mesdhe duke krijuar atë që ne sot e quajmë Deti

Mesdhe). Pra, këto dy kolona do të krahasoheshin me Sokratin dhe Platonin aq sa edhe vetë Herkuli, bir i Zeusit - një Perëndie pagane -, do i kish zili për mençurinë e tyre dhe do i admironte Ata.

Dihet që vetë Sokrati nuk shkroi, përpos disa gjërave në Apologjinë e Sokratit, por shumë pak, ndoshta disa poezi, megjithëse edhe kjo mbetet ende e dyshimtë... Ndërkohë, një ndër nxënësit e tij më të mirë, Platoni, shkroi pothuajse çdo gjë që Sokrati mendonte dhe thoshte lidhur me probleme të ndryshme filozofike, nisur nga ato metafizike - si më të shkëlqyerat - e deri tek politika e etika.

Platoni klasifikohet ndër ata filozofë të cilët në periudhën në fjalë, i kushtonin shumë rëndësi mënyrës së përmirësimit të jetesës duke e bërë atë më të mirë dhe më të virtytshme. Pra, sipas tij vetë filozofia ishte një mënyrë jetese dhe ai që duhej të drejtonte polisën duhet të ishte një filozof; filozofi duhej ishte mbret, pasi vetëm ai mund t'ia nënshtrohte dëshirat dhe pasionet arsyes sepse shpirti i tij ishte i përbërë prej ari. Ai mendonte se të gjithë ne, pa diskutim, e dëshirojmë lumturinë; kjo na sjell ndërmend një shprehje të Aristotelit ku thuhet se: "Nuk është e rëndësishme thjesht që të jetosh, por që të kesh dhe një jetë të lumtur për aq sa kohë jeton."

Tek libri i autores Julia Annas "Platoni" shohim se nga njerëzit shëndeti, pasuria dhe bukuria e Platonit vlerësoheshin si elementë shumë të mirë, por sipas Platonit ato elementë bëhen akoma më të mirë në momentin kur ne i përdorim, pra ne përfitojmë prej tyre. Ashtu siç një zejtar i cili edhe pse mund t'i ketë të gjitha veglat dhe materialet, duhet të punojë me to që të mund të fitojë prej tyre.

Tek vepra - ligjet e Platonit, virtytet që na komprometojnë me të mirat e jetës materiale quhen "të mira hyjnore".

Sipas Sokratit, një njeri është i lumtur ose jo, bazuar në virtytshmërinë e jetës së tij. Pra, nëse një njeri është i virtytshëm në jetën e tij personale, familjare dhe shoqërore, atëherë ky person pa diskutim që është i lumtur, sepse lumturia e jetës, po sipas tij, varet kryekëput nga virtyti ose nga ajo çka do ta përkufizonim filozofikisht "jeta e drejtë".

Tek Republika e Platonit shohim edhe një shembull aktual të sjellë nga Sokrati, i cili na e bën më të kuptueshme vlerën reale dhe të drejtë të virtytit. Në të njëjtën vepër ai shprehet se: "Një njeri i drejtë bën një gjumë më të

qetë sesa një i padrejtë apo hajdut; njeriu i virtytshëm nuk ka se kujt t'i ruhet sepse nuk ka bërë ndonjë padrejtësi por shikon jetën e tij si një qytetar i denjë i polisit ku jeton; ai kërkon të jetojë me ndershmëri, dhe rrjedhimisht për shkak të thjeshtësisë së tij, i lumtur.”

Nga antikët virtyti shihej si një e mirë hyjnore, si një e mirë qiellore e papëlqyer me mëkatin dhe dashakeqësinë njerëzore, virtyti ishte qëndresa, forca dhe maturia e gjenisë greke të asaj kohe.

Vetë qëndrimi i Sokratit në momentin që ishte i burgosur për akuzën e korruptimit të të rinjve, tregon mirëfilli qëndrimin e tij në momentin që mendon nëse është e drejtë të arratiset nga burgu duke marrë parasysh se mundësitë që ai të largohej ishin të shumta - vetë nxënësit e tij ia ofronin këto mundësi. Megjithatë, ai me stoicizmin e vet nuk e pranoi këtë zgjidhje, pasi mendonte se të shkelesh ligjet e një shteti nuk është e drejtë. Më tej, fakti që ai vetë i kish mësuar nxënësit e tij se duhet t'iu binden ligjeve të polisit të tyre, si një e drejtë dhe një detyrim karshi shtetit dhe individëve që jetojnë në të, ndikoi në vendimin e tij final. Sokrati vrau veten; me stoicizëm ai piu gotën me helmin vrasës.

Pothuajse njësoj si Krishti edhe Sokrati u vra nga akuzat e popullit të tij; akuza të padrejta dhe të pa qëndrueshme. Njësoj si Krishti, edhe Seneka - i cili u vra me urdhër të perandorit romak Neronit njëkohësisht dhe nxënës i tij, duke iu hapur venat - paraqesin këta tre personazhe, të cilët nuk patën aspak frikë nga vdekja, por guximshëm ngritën lart ato parime dhe vlerat morale pa të cilat jeta nuk ka kuptim dhe bëhet degraduese. Krishti ka një kuptim më kryesor pasi ai shihet si shpëtimtar i njerëzimit dhe pavarësisht gjithë përvojave të hidhura të vuajtjes së tij të padrejtë - edhe pse të shkruara në ungjill dhe të pritura prej tij si pjesë e realizimit të profetësisë së larjes së mëkateve të gjithë njerëzimit - ai nuk i trembej aspak vdekjes.

Tek Krishti morali dhe dinjiteti njerëzor nuk janë vetëm një dimension tokësor, pra këto vlera nuk përfundojnë në këtë botë apo në këtë jetë tokësore, pasi ato i përkasin një dimensionit më të gjerë, përtej kufijve të kësaj jete. Për këtë arsye morali i krishterë mbështet moralin stoik tokësor duke theksuar se pavarësisht se vetë stoikët nuk e dëshironin jetën pas vdekjes, në këtë botë ata e dëshironin jetë të mirë e të virtytshme dhe është pikërisht kjo që na bën ne të ngjashëm me ta. Për ta “virtyti është një qëllim në vetvete

- ai nuk do të shpërblehet nga një jetë më e gëzuar pas vdekjes (siç ndodh në krishterim). I vetmi ngushëllim që i jepet atij që jeton dhe vdes, duke respektuar filozofinë stoike, do të jetë krenaria që është çliruar nga frika - e cila buron nga materialiteti i njeriut -, duke u hedhur vetë dhe me vullnetin e tij të lirë tek e pashmangshmja.¹” Dimensioni moral hyjnor pas vdekjes, i cili tek të krishterët karakterizon të gjithë rrethin hyjnor të krishterimit, gjendet i fshehur disi edhe në stoicizëm tek ideja e shkëndijave të shpirtit dhe idesë së Zotit. Pra, për një Zot (Logos) dhe për disa shkëndija të vendosura brenda nesh, brenda trupit njerëzor, në formë të shpirtit për të qenë të gjallë e në jetë. Këto shkëndija, të vendosura në zemër, qarkullojnë nëpërmjet gjakut duke na dhuruar aftësinë për të pasur dhe ndjerë të gjitha ndjenjat shpirtërore. Kjo ngjashmëri haset edhe në zanafillën e Biblës ku thuhet: “Atëherë Zoti Perëndi formoi njeriun nga pluhuri i tokës, i fryu në vrimat e hundës një frymë jete, dhe njeriu u bë një qenie e gjallë.”²

Sokrati dhe Seneka, mbi të gjitha do mbeten përfaqësuesit e qëndresës së fortë dhe të drejtë të shpirtit të kulluar, larg veseve dhe drejt qiellit.

Qëndrimet e tyre stoike janë të dokumentuara, ato nuk janë thjesht mitologji por ngjarje të vërteta, duke i kthyer ata në figura qendrore të historisë së moralit botëror. Jo më kot një ndër perandorët më fisnikë të Romës, Mark Aureli, i përkiste shkollës stoike duke e parë atë si një shkollë me vlera fisnike dhe humane në të gjitha dimensionet e saj. Pra, qëllimi final është se në jetë duhet të jesh i drejtë; në këtë mënyrë i jep jetës një kuptim të mirë dhe madhështor.

Platoni e lidh jetën e mirë me jetën e harmonisë së brendshme, së mirëqenies dhe lumturisë.

Sidoqoftë, për të, mirësia dhe virtyti lidhen ngushtësisht me mënyrën e sjelljes pasi kjo e fundit sjell mirëqenie dhe harmoni. Sipas tij, harmonia mund të arrihet vetëm nëse pjesët e shpirtit veprojnë sipas natyrës së tyre.

Nga ana tjetër, ai e vlerëson moralin si cilësinë më të lartë për një burrë shteti dhe në të njëjtën kohë cilëson pesë forma të qeverisjes: aristokracinë, timokracinë, plutokracinë, demokracinë dhe despotizmin. Megjithatë, të gjitha këto forma gradualisht e degradojnë cilësinë e shtetit, pasi lidhen

1 Jacoby, E. *Filozofët*, 50 të Pashmangshmit. Fq. 65.

2 Bibla. *Zanafilla* 2:7. Botimi ABS.

drejtpërdrejt me prishjen graduale të karakterit moral të drejtuesve dhe qytetarëve. Platoni e konsideron kalimin nga aristokracia në despotizëm si një rënie të ngadalshme të cilësisë së shtetit, pasi ashtu siç dhe e përmendëm më sipër, lidhet drejtpërdrejt me prishjen graduale të karakterit moral të drejtuesve dhe qytetarëve. Shteti ideal i Platonit do të ishte aristokracia, e cila me racionalitetin e saj, ngre lart “mbretin filozof”. Ky mbret filozof është suprem pasi me arsyen e tij, ai është në gjendje të ketë kontroll mbi dëshirat e tij. Megjithatë, duke marrë parasysh se asnjë sistem nuk është i përhershëm, ai shprehet se e keqja më e madhe është kur aristokracia shndërrohet në timokraci. Si pasojë, do të ketë një degjenerim sepse timokracia përfaqëson dashurinë për nderimet, ndërsa timokratët janë të dhënë pas dëshirave të tyre; arsyeja nuk i mbizotëron dëshirave të tyre të mëdha. Madje, - vazhdon ai -, sistemi më i keq qeverisës është plutokracia. Kjo pasi në këtë sistem fuqia qëndron në duart e atyre individëve të cilët kanë si qëllim primar pasurinë. “Kështu, - shprehet Platoni-, ndërsa të pasurit lartësohen në vlerësimin shoqëror, të virtytshmit fundosen në të.” Me pak fjalë, gjeniu i shekullit të V para Krishtit, u jep vlerave morale njerëzore jo vetëm cilësi të larta por edhe hyjnore, madje për më tepër ai thotë se “edhe jeta duhet dhënë kur nuk ka kuptim që ajo të jetohet pa nder dhe dinjitet”. Pra, për këta përfaqësues duhet sakrifikuar akoma dhe jeta njerëzore, vetëm e vetëm që vlerat morale të qëndrojnë të paprekura.

Ky qëndrim tregohet qartë në vrasjet e Sokratit dhe të Senekës, të cilët e pranuan fatin e tyre duke qëndruar stoikë para tij. Për hir të së vërtetës, duhet të themi se figura qendrore frymëzuese e stoikëve ishte vetë Sokrati me qëndrueshmërinë e tij stoike dhe filozofike, i cili duke pritur vendimin final për dënimin e tij, piu kupën me helm me një qetësi olimpike. Një tjetër qëndrim mjaft i prerë dhe i vendosur ishte ai i stoikëve lidhur me jetën dhe vdekjen. “Ne nuk kemi asgjë për t’u frikësuar, por vetë frikën” - shprehen ata.

Por, çfarë ishte për Senekën virtyti i cili i përkiste shkollës stoike? “Për stoikët e virtytit, që dëshironin me ngulm shpirtin hyjnor të botës, kjo vjen nga një mirësi e pafundme, dhe arrihet nëpërmjet guximit së heqjes dorë, thjeshtësisë dhe paanësisë.”³

3 Jacoby, E. 2006. *Filozofët*. Botimet Max. Fq. 64.

Por ajo çka shihet edhe si më interesante në doktrinën stoike është se i gjithë ky virtyt është një qëllim në vetvete. Stoikët nuk pretendonin të mira pas vdekjes bazuar në veprimet e mira që ata kishin kryer në këtë jetë, por thjesht i vetmi ngushëllim që ata merrnin duke jetuar sipas filozofisë stoike, do të ishte krenaria që janë çliruar nga frika - e cila buron nga materialiteti i njeriut -, duke u hedhur vetë dhe me vullnetin e tyre të lirë tek e pashmangshmja.” Në një plan të parë, ky qëndrim na kujton spartanët dhe kohën e antikitetit grek, kohën e lulëzimit të filozofisë helene dhe Platonit, kohën e mësimjeve të pushtimeve perse. Në atë kohë, pra, çdo qëndresë e tyre nuk lidhej me pretendimet apo qëllimet e tyre për botën e përtejme, por lidhej vetëm me vendin e tyre, me vetë Spartën dhe ky ishte një qëndrim stoik i vërtet.

Mjaft interes paraqet dhe filozofia e Senekës në lidhje me virtytin. Me mençuri dhe duke e kuptuar rrjedhshmërinë fatale të jetës, në një fragment të librit të tij “Letra për Lucilin”, ai shprehet: “Ti do të shkosh atje ku shkon gjithçka. Kjo gjë nuk është aspak e re për ty. Ti linde për t’iu nënshtuar këtij ligji. Këtë fat patën edhe babai e nëna jote, gjyshërit e stërgjyshërit e tu, të gjithë ata që kanë jetuar para tyre dhe të gjithë ata që do të vijnë pas nesh.

Një lidhje e pashpërbëshme dhe e patundshme i vargon dhe i tërheq zvarrë të gjitha qeniet njerëzore.”⁴ Me qëllim kryesor mjekimin e shpirtit, më poshtë ai vazhdon: “Filozofia duhet të na mësojë se si të jetojmë dhe jo të na mbajë fjalime. Rëndësi ka të mësojmë të jetojmë mirë, të përballojmë me guxim atë që është e pashmangshme.”⁵

Nga ana tjetër, filozofi francez të shekullit të XVI, Montenji, na paraqet dy sentenca të shkëlqyera ku vlerëson dhe pohon se arti i jetës është të njohësh se çfarë nënkupton të jesh njeri. Nuk ka asgjë më fisnike, - sipas Montenjit - se sa të krijosh njeriun e drejtë dhe të mirë. Ajo çka duhet theksuar sipas tij, është qëndrimi karshi sëmundjes së natyrës njerëzore:

“Nga të gjitha sëmundjet njerëzore, më e keqja është të përbuzësh qenien tënde.”⁶ Megjithatë, ajo çka e bën atë mjaft interesant është sentenca: “Asgjë nuk e shëmton natyrën njerëzore më shumë se sa përpjekja për të vlerësuar veten më tepër nga ç’është.”⁷ Lidhur me virtytin dhe vdekjen, pra me mënyrën

4 2005. *Mëso të jetosh: Letra për Lucilin/ Seneka*. Botimet Doruntina. Fq. 73.

5 2005. *Mëso të jetosh: Letra për Lucilin/ Seneka*. Botimet Doruntina. Fq. 6.

6 Stumf, S. E. Botimet Toena. Fq. 209.

7 Stumf, S. E. Botimet Toena. Fq. 209.

se si duhet jetuar virtytshëm dhe më pas për të vdekur po virtytshëm, ka vetëm një zgjidhje: filozofia! Duke u marrë me filozofi ne dimë ta jetojmë më mirë dhe më virtytshëm jetën tonë, prandaj, thotë Montenji: “Të filozofosh do të thotë të mësosh që të vdesësh, ta (kuptosh) vdekjen. Duke e kuptuar jetën dhe rrjedhshmërinë e saj, ti do të jesh i gatshëm t’i përgjigjesh vdekjes denjësisht, pra ti do të dish ta jetosh jetën ashtu siç duhet me dinjitet, me rregulla morale dhe të përpiqesh të mos gabosh aty ku nuk duhet”. Për këtë arsye sentenca e tij na tregon për rrokjen e kuptimit që filozofia na jep për të kuptuar botën dhe për t’i dhënë asaj një kuptim të vërtetë dinjitar dhe njerëzor, madje përtej njerëzores duke mos e harruar njeriun, dinjitetin, fantazinë dhe moralin. Bazuar në këto vlera dhe sigurisht duke u ndërgjegjësuar, do të ketë shpresë për rimëkëmbje nga vorbulla e shpeshtë dhe e pakuptimtë e konsumimit dhe globalizmit ku gjërat humane e shpirtërore po humbin kuptimin e tyre dhe po zëvendësohen. Për ruajtjen e këtyre vlerave ndikimin më të madh po e ushtron feja, e cila nuk harron njeriun dhe dinjitetin e tij, por vetëm kjo nuk mjafton! Paralelisht, institucionet shkollore duket të jenë më të vëmendshme përballë këtij problemi global, dhe jo vetëm për njeriun por me të njëjtën rëndësi duhet të kontribuojnë edhe për mbrojtjen e natyrës (malet, pyjet, lumenjtë, kafshët e egra, flora dhe fauna dhe oqeanet së bashku me gjallesat e tyre). Natyra e shenjtë po sulmohet rëndë nga dora e njeriut! Si një kosh i madh ku hidhen mbeturina, inerte e mbetje të ndryshme, harrohet se ajo është mushkëria jonë, frymëmarrja jonë. Në botë ka organizata pro natyrës të cilat me vullnetin e tyre po mundohen të ndërgjegjësojnë njeriun për të keqen që po i bën natyrës. Prandaj duhet të jemi gjithnjë në kërkim të metafizikës humane, të poezisë, të tregimit, të religjionit dhe mbi të gjitha të fantazisë. Për të qenë i moralshëm, njeriu duhet patjetër të jetë metafizik dhe fantastik. Në të kundërt ai nuk mund ta arrijë atë qëllim. Prandaj duhet të këmbëngulim tek poezia, religjioni, letërsia dhe muzika.

Me anë të tyre njeriu do të jetë i aftë të ruajë aftësinë e tij morale dhe etike dhe t’i ushqejë ato në përputhje me modelet e sipërpërmendura. Më shumë metafizikë për të shpëtuar njeriun. “Ta bëjmë njeriun metafizik e më pas ta bëjmë atë të drejtë”.

Ky është qëllimi i filozofisë.

Kjo është deviza ime.

Bibliografia

5. 1991-1994. Bibla. Diodati i Ri (Përkthim). Albanian Bible Society.
4. Jacoby, E. 2006. *FILOZOFËT*. Spektër.
3. Seneka. 2005. *Letra për Lucilin*. Doruntina.
2. Sinani, Gj. 2002. *Hyrje në Filozofi*. Guttenberg.
1. Stumpf, S. E. *FILOZOFIA* Botimet Toena. Tiranë

Summary

In this discourse, I would like to introduce to you the human nature, human morality, human dignity, ancient morality and stoicism inspired by Socrates. This discourse revolves around ancient moral issues and some modern examples, bringing Socrates back to his stoic courage, Plato, his brilliant student, dear Roman Seneca and I have also mentioned Montaigne as a philosopher of human nature.

I discussed about ancient Greek and Roman morals, and then I refer to some major issues regarding the surrounding environment.

Also, insisting that the true and the only way to protect man from moral decadence is the Gospel, generally religion, poetry, storytelling, novel, literature in general as well as deity music.

In order not to degrade ourselves in morality, we must engage on them, mainly on religion and metaphysics, to protect man from the inexplicable degradation that is happening to him in the period of secularization.

Key words: Virtue, Life, Death, Spirit, Eternal World, Life Philosophy.

NDIKIMI I KOHËS SË KONTAKTIT SERUM-KLOT NË TESTIN E FOSFORIT NË GRUP PACIENTËSH TË SHËNDOSHË

Dr. Erjola Reufi ^a

Aurela Xhardja ^b

^a Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Shkencave të Aplikuara

Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë

^b Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Shkencave të Aplikuara

Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë

Abstrakt

Në këtë studim u ndalëm mbi rëndësinë që ka koha e procedimit të kampionit nga momenti i marrjes tek pacienti deri në analizimin e tij në përqendrimin e fosforit në serum. Studimi u krye në 30 individë të shëndoshë, ku pas kryerjes së procedurës së venipunkturës kampioni u nda në tre tuba paralele. Seria e parë e kampioneve iu nënshtrua procesit të centrifugimit brenda 60 minutave, ndërsa kampionët e serisë së dytë dhe të tretë u ruajtën në temperaturë dhome në 28 ± 1 °C dhe u matën përkatësisht 4 dhe 72 orë pas kryerjes së procedurës së venipunkturës.

Përqendrimi i fosforit u mat me anë të metodës spektrofotometrike kolorimetrike duke përdorur reagjentët komercial Human Liquicolor.

Rezultatet e serisë të parë të cilat u përdoren edhe si seri kontrolli, u krahasuan me serinë e dytë dhe të tretë të kampioneve. U vu re një rritje me rreth 5 herë e përqendrimit të fosforit krahasuar me përqendrimin fillestar të matur brenda 60 minutave.

Rekomandojmë të tregohet kujdes në analizimin e kampioneve të fosforit të cilat duhet të procedohen maksimalisht në një limit kohor prej katër orësh nga momenti i marrjes së kampionit.

Fjalë kyçe: fosfori, faza preanalitike, koha e procedimit

Hyrje

Saktësia e rezultateve është një komponent gjithmonë e më i rëndësishëm për kujdesin ndaj pacientit. Klinikistët gjithmonë e më tepër po bazohen në treguesit biokimik për diagnostikimin e hershëm, diagnozën dhe prognozën.

Për të pasur ecuri dhe mundësi të vogël gabimi gjatë ekzaminimit duhet të kihen parasysh një seri faktorësh si kryerja e saktë e procedurës së venipunkturës, koha e procedimit të kampionit, tipi i antikoagulantëve të përdorur, si dhe një sërë faktorësh të tjerë si mosha, gjinia, klima, dieta, medikamentet apo aktiviteti fizik i ushtruar nga pacienti përpara ekzaminimit, të cilët mund të ndërhyjnë në rezultatin final të analitit.¹ Intervali kohor nga marrja e kampionit deri në analizim përfshin tre faza: fazën preanalitike, analitike dhe fazën post analitike, ku faza preanalitike përfshin marrjen e materialit dhe përgatitjen për analizë, transportin e tij në laborator, përpunimin e materialit dhe kalimin e materialit në instrumentin analizues.

Faza analitike përfshin gjithë hapat e ndërmarra gjatë analizimit të mostrës dhe faza post-analitike përfshin rishikimin e rezultateve për ndonjë anomali të mundshme, raportimin e tyre tek klinikisti si dhe ruajtjen e materialit.²

Me zhvillimin e teknologjisë vitet e fundit gabimet që burojnë nga faza analitike janë minimizuar, por nga ana tjetër gabimet gjatë fazës preanalitike janë më të tepërta në numër.³

Sipas studimeve të mëparshme, të kryera në këtë fushë, mendohet se faza preanalitike përbën rreth 60% të gabimeve të mundshme gjatë ekzaminimit të analitit ku një peshë të rëndësishme zë edhe koha e procedimit të kampionit.

Koha optimale midis marrjes së kampionit dhe ndarjes së serumit duhet të

1 A. Goxharaj, S.Licaj, *Praktikum i biokimisë, hematologjisë, dhe mikrobiologjisë mjekësore*.

2 S. Ashakiran, M.E. Sumati, N. Krishna Murthy. 2014. *A study of pre-analytical variables in clinical biochemistry laboratory*. Int. Jr. Bioinformatic and Biological Sci.: v.2 n.3 and 4, p. 127-134.

3 Dongbo J. Zhang, 1 R.K. Elswick, 2 W. Greg Miller, 1* and Jimmy L. Bailey. 1998. *Effect of serum-clot contact time on clinical chemistry laboratory results*. General Clinical Chemistry 1325-1333.

zgjasë mjaftueshëm deri në lejimin për t'u formuar kloti. Koha minimale për formimin e klotit cituar në "Textbook of Clinical Chemistry" rekomandohet të jetë 20-30 minuta.

Sipas NCCLS "Procedurat për trajtimin dhe procedimin e kampionëve të gjakut", rekomandohet një limit maksimal kohor prej 2 orësh nga marrja deri tek veçimi i serumit dhe analizimi i tij.⁴

Sot laboratorët biokimik-klinik të qendrave të mëdha spitalore, të ndodhur nën presionin e madh të vëllimit të punës ndonjëherë i shmangen zbatimeve të protokollit të procedimit të kampionit duke nxjerrë rezultate false pozitive ose negative të analizëve të caktuara. Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i gabimeve që burojnë gjatë procedimit të kampionit dhe dhënia e rekomandimeve të nevojshme për teknikët e ardhshëm të laboratorit në këtë fushë.

Për këtë qëllim u studiua ndikimi i kohës së procedimit të kampionit në rezultatin final të përqendrimit në serum të fosforit në intervale të ndryshme kohore 2, 4 dhe 72 orë.

Fosfori është një ndër anionet kryesor brendaqelizor. Është llogaritur se tek një i rritur i shëndetshëm që peshon rreth 70 kg gjendet rreth 700-800 mg fosfor ku 85% e të cilit në skelet dhe 15% në indet e buta. Në serum fosfori ndodhet në dy forma në trajtën e dihidrogjenfosfatit (H_2PO_4) dhe monohidrogjen fosfatit (HPO_4). Lidhja midis përqendrimit të tyre mund të përcaktohet nga ekuacioni Henderson-Hasselbach. Në pH 7.4 raporti midis HPO_4 me H_2PO_4 është 4:1. Fosfori luan një rol të rëndësishëm në metabolizëm duke marrë pjesë në ndërtimin e fosfolipideve, pra luan rol në ndërtimin strukturor të membranave qelizore paralelisht me grumbullimin, transferimin dhe çlirimin e energjisë në formën e ATP-së. Vlerat referente të fosforit në serum tek një i rritur variojnë 2.5-5 mg/dl. Hiperfosfatemia vihet re kryesisht gjatë hipervitaminozës D si pasojë e rritjes së absorbimit në zorrë të kalciumit dhe fosfateve, gjatë hipertiroidizmit, në disa tumore të kockave, leucemisë dhe në disa raste gjatë anemisë hemolitike. Nga ana tjetër, hipofosfatemia takohet gjatë hiperparatiroidizëm si pasojë e shtimit

4 NCCLS. 1995. *InfoBase 95, H18-A, Procedures for the handling and processing of blood specimens; approved guideline*. Villanova, PA: NCCLS.

të ekskretimit urinar të fosfateve, avitaminozës D, rakitizmit si dhe acidozës tubulare renale.⁵

Materiali dhe metodat

Ky studim u krye në 30 individë-vullnetarë të shëndoshë, të cilët i përkisnin grupit të studentëve të Kolegjit Universitar “Logos”, Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë. Të gjithë studentët u informuan paraprakisht për arsyen e marrjes së kampionit dhe qëllimin e këtij studimi.

Përpara kryerjes së procedurës së marrjes së gjakut, ata plotësuan formularin e mëposhtëm i cili do të na shërbente në rast se mund të gjenin vlera patologjike apo për të parë ndikimin që mund të kishte pesha apo stili i jetesës në këto vlera.

PYETËSORI	
EMER MBIEMER	
KODI I IDENTIFIKIMIT	
MOSHA	
GJATESIA(m)	
PESHA(kg)	
BMI	
JENI PËRDORUES DUHANI?	☐ PO ☐ JO
JENI KONSUMUES ALKOOLI?	☐ PO ☐ JO
STILI I JETES	
VUAN NGA SËMUNDJA E DIABETIT?	

REZULTATET	
1. Glukemia (mg/dl)	Vlerat referente
2. GOT/AST (U/L)	
3. GPT /ALT(U/L)	
4. Fosfori (mg/dl)	

Krijuaam tre grupe kontrolli, ndërsa kampionët e gjakut u ndanë në tre tuba te ndryshëm: a) tubi i parë u përdorë për analizimin direkt të analitit (brenda 60 minutash); b) tubi i dytë dhe c) tubi i tretë u përdorë për analizimin e kampionit pas 4 dhe 72 orësh. Tri seritë e kampioneve u ruajtën në temperaturë ambienti pa u veçuar masa e serumit nga masa eritrocitare. Për përfitimin e serumit u vijua si më poshtë:

1. Në një tub qelqi - me sfera qelqi (pa përmbajtje antikoagulant), u hodh 5 ml gjak i cili u morr me anë të punktimit venoz. Më pas, gjaku i marrë u nda

⁵ Vinod K. Bansal Clinical Methods: *The history, physical and laboratory examinations*, 3 rd edition, Chapter 198 Serum Inorganic Phosphorus

në tre tuba paralele. Duke marrë parasysh se u përdorën aktivator kloti, gjaku u përzie me kujdes 5-6 herë për t'u homogjenizuar me aktivatorin e klotit, përpara inkubimit. E njëjta procedurë u krye për të 30 kampionet që u morën në shqyrtim.


2. U la në qetësi në pozicion vertikal në temperaturë dhome për 30-45 minuta, (jo më tepër se 60 minuta), për të lejuar krijimin e koagulit dhe zbërthimin e fibrinogjenit. Tubi pas këtyre procedurave u centrifugua për 5 minuta në 3000 rpm për grupin e parë të kontrollit.

3. Serumi u ruajt në temperaturë ambienti pa u veçuar nga masa eritrocitare në dy intervale kohore 4 dhe 72 orë për serinë e dytë dhe të tretë të kampioneve.

Metoda kolorimetrike enzimatiske e dozimit të fosforit në serum

Fosfati bashkëvepron me molibdatin në mjedis të fortë acid për t'u formuar një kompleks me ngjyrë. Përthithja e këtij kompleksi është në përpjesëtim të drejtë me përqendrimin e fosfatit.⁶

Reaksioni zhvillohet si më poshtë:



Kampioni që u përdor ishte serum dhe aparati u programua sipas parametrave të mëposhtëm:

- Gjatësia e valës 340 nm
- Temperaturë ambiente
- Matja kundrejt reagentit blank
- Metoda EndPoint

Pipetojmë në ky veta	Reagent blank	Kampion ose Standard
Kampion ose Standard	-	10µl
Reagjenti i punës	1000µl	1000µl
Përzjemë dhe inkubojmë për një minutë në temperaturë dhome. Matim përthithjen e kampionit dhe të standardit kundrejt reagentit blank brenda 60 min.		

Tabela 1. Skema e pipetimit për përcaktimin e fosforit

⁶ Metodika e dozimit në serum të fosforit HUMAN LiquiColor.

Vlerat referente

Të rriturit: 2,5 - 5,0 mg/dl 0,81 - 1,62 mmol/l


Fëmijët: 4,0 - 7,0 mg/dl 1,30 - 2,26 mmol/l

Rezultatet

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelash dhe grafikësh rezultatet e fituara për grupin e parë të kampioneve të cilat u ruajtën në temperaturë dhome dhe u proceduan në intervale të ndryshme kohore 2, 4 dhe 72 orë, pas kryerjes së procedurës së venipunkturës.

Numri i kampionit	Brenda 2 orëve	Pas 4 orëve	Pas 72 orëve
1	4.8	6.2	24.6
2	4.5	5.7	23.4
3	4.3	5.5	24.8
4	5	6.5	13.9
5	4.8	6.1	20.7
6	3.9	4.7	23.7
7	4.8	6.2	19.6
8	4.8	6.2	21.8
9	3.8	4.8	20
10	4.5	5.8	24.6
11	5.3	6.6	23.1
12	5.8	7.1	23.3
13	2.4	2.7	12
14	3.8	4.9	19
15	4.2	4.9	21
16	3.5	6	17.5
17	3.5	4.8	17.5
18	3.9	4.9	19.5
19	4.3	5.1	21.5
20	3.4	3.8	17

Tabela 2: Rezultatet e përqendrimit të fosforit në serum në kohë të ndryshme kontaktit serum-klot në temperaturë dhome.



Grafiku 1 : Ndryshimi në përqendrimin e fosforit në varësi të kohës së kontaktit serum-klot për grupin e 1^{-rë} të kampioneve të ruajtur në temperaturë dhome.

Për grupin e matjeve të mësipërme është kryer përpunimi statistikor ANOVA (Excel) . Rezultatet janë paraqitur si më poshtë:

Anova: Single

Factor

Summary

Groups	Count	Sum	Average	Variance
Column 1	20	85.3	4.265	0.596
Column 2	20	108.5	5.425	1.076
Column 3	20	408.5	20.425	12.557

ANOVA

Source	of	SS	df	MS	F	P-value	F crit
Variation							
Between Groups	3	3249.941	2	1624.970	342.5665	1.71278E-32	3.1588427
Within Groups		270.3805	57	4.7435			19
Total	8	3520.321	59				

Tabela 3: Përpunimi statistikor ANOVA (excel) për rezultatet e studimit

Vlera e sinjifikancës $P < 0.05$ tregon se hipoteza e ngritur bie, pra vihet re një ndryshim i dukshëm midis matjeve të kryera në intervale të ndryshme kohore.

Për fosforin u vu re rritje false pozitive me rritjen e kohës së kontaktit.

Përkatësisht: pas 4 orësh vlerat u rriten mesatarisht rreth 1. 25 herë krahasuar me vlerat fillestare, ndërsa pas 72 orësh rritja ishte më e dukshme me rreth 5 herë krahasuar me vlerat fillestare.

Kjo rritje e vlerave të fosforit me kalimin e kohës së kontaktit serum-klot vjen pasi fosfori ndodhet në mjedisin brendaqelizor dhe përqendrimi i tij në eritrocite është rreth 7 herë më i lartë sesa në plazëm. Me rritjen e shkallës të hemolizës e cila u diktua edhe vizualisht me kalimin e kohës së kontaktit serum-klot, fosfatet çlirohen nga eritrociti në masë më të madhe dhe shndërrohen në sajë të hidrolizës në fosfor inorganik. Ky proces u reflektua në rritjen e vlerave në serum të fosforit pas 72 orësh.⁷

Rekomandimet

Rekomandojmë që stafi teknik duhet t'i kushtojë rëndësi gabimeve që burojnë gjatë fazës preanalitike të procedimit të kampionit. Këtu përfshihet kujdesi që duhet treguar gjatë kryerjes së teknikës së venipunkturës, centrifugimit, tipit të antikoagulantit të përdorur dhe radhës së përdorimit të tyre, kohës së procedimit të kampionit, transportit dhe kujdesit që duhet treguar në kampionet ikterik lipemik dhe të hemolizuar.

Qëllimi i kësaj teme ishte ndikimi i kohës së procedimit të kampionit në përqendrimin e fosforit.

Në këtë aspekt rekomandojmë të tregohet kujdes në analizimin e kampioneve të fosforit të cilat duhet të procesohen maksimalisht në një limit kohor prej 4 orësh nga momenti i marrjes së kampionit referuar, kjo edhe në studime të më përparshme të kryera në këtë fushë.⁸ Në rast të kundërt në qoftë se këto limite kohore tejkalohen rekomandohet përdorimi i koeficienteve të korrigjimit. Rekomandohet që kampioni të mos ruhet në temperaturë dhome për një kohë të gjatë por të ruhet në kushte frigoriferike në raste kur lind nevoja për analizime të mëtejshme.

7 Henry RL, Cannon DC, Winklemen JW Clinical Chemistry principles and Techniques 2 end pg. 726-72.

8 Bausset I, Juvet O, Milano E Impact of serum-clot contact time on lactate dehydrogenase and inorganic phosphorus serum levels.

Bibliografia

1. Goxharaj, S.Licaj, Praktikum i biokimisë, hematologjisë, dhe mikrobiologjisë mjekësore.
2. S. Ashakaran, M.E. Sumati, N. Krishna Murthy. 2014. A study of pre-analytical variables in clinical biochemistry laboratory. *Int. Jr. Bioinformatic and Biological Sci.*: v.2 n.3 and 4, p. 127-134.
3. Dongbo J. Zhang, 1 R.K. Elswick, 2 W. Greg Miller, 1* and Jimmy L. Bailey (1998). Effect of serum-clot contact time on clinical chemistry laboratory results. *General Clinical Chemistry* 1325-1333.
4. NCCLS InfoBase 95, H18-A, Procedures for the handling and processing of blood specimens; approved guideline. Villanova, PA: NCCLS, 1995.
5. Vinod K. Bansal *Clinical Methods: The history, physical and laboratory examinations*, 3 rd edition, Chapter 198 Serum Inorganic Phosphorus.
6. Metodika e dozimit në serum të fosforit HUMAN LiquiColor.
7. Henry RL, Cannon DC, Winklemen JW *Clinical Chemistry principles and Techniques* 2 end pg. 726-72.
8. Bausset I, Juvet O, MilanoE Impact of serum-clot contact time on lactate dehydrogenase and inorganic phosphorus serum levels.

SUMMARY

Changes in the test results can be induced by pre analytical, analytical or post analytical variations. To detect the real pathological changes in the patient the pre analytical, analytical and post analytical variation must be reduced to acceptable levels at which they cause no impact on the clinical interpretation of the results. As analytical and post analytical variation have decreased with the advancement of new technologies, automation, standardization and improved laboratory information system the relative contribution of pre analytical variation becomes an important element of overall reliability. Pre analytical phase start with request for investigation, specimen identification, blood drawing, sample collection etc. The time interval between blood collection and sample processing in analyzer is one important which generate most of the error during pre-analytical phase.

Prolonged contact of serum with clot can cause pre analytical variation. The optimum time interval between sample collection and separation of

serum from the clot should be long enough to allow complete clot formation but be shorter than the time in which a significant change in test result is induced by serum-clot contact.

During a prolonged contact time between serum and clot, both biological activity of the cells and trans-membrane diffusion can change the concentration of certain analytes in the serum. Each individual analyte has a different tolerance to delay in separating serum from clot. For clinically useful and reliable test results, the time between blood collection and serum separation must be controlled.

The aim of this study was to determine the effect of storage time on the laboratory results of serum phosphorus on 30 healthy subjects. The effect of serum-clot contact time on laboratory results was studied by dividing each blood specimen into three collection tubes. The control serum was separated from the clot within 60 minutes of collection. Two others tubes were incubated at $28 \pm 1.0^\circ\text{C}$ and the serums were separated after 4 h and 72 h. The phosphorus measurements were done by using HumaLyzer Primus photometer and Liquicolor reagent (UV determination). The stability of the test was determined by comparing the results of the phosphorus serums at 4 h and 72 h with the results of phosphorus serum separated within 60 minute.

We concluded that the values of phosphorus after 72h has been increased about 5 times compared with the values measured within 60 min of collection.

We recommend that the phosphorus serum should be separated from contact with cells as soon as possible in order to minimize the inaccuracy of results.

SISTEMET E SHFRYTËZIMIT MOBILE

M.Sc. Olta Petritaj ^a

M.Sc. Xhezmije Lulo ^b

^a Kolegji Universitar “Logos”

Fakulteti Shkencave të Aplikuara
Departamenti Informatikë e Zbatuar
olta.petritaj@gmail.com

^b Kolegji Universitar “Logos”
Fakulteti Shkencave të Aplikuara
Departamenti Informatikë e Zbatuar
xhezmije_palushi@hotmail.com

Abstrakt

Në ditët e sotme aparatet celularë janë pjesë e pandarë e jona, por pak nga ne kanë ditur dhe dinë se çfarë janë sistemet e shfrytëzimit, pa të cilët ato nuk mund të punojnë.

Sistemet e shfrytëzimit mobile u zhvilluan sepse ishte e nevojshme që një kompjuter i personalizuar të mund të përdorej edhe në aparate të minimizuara.

Sistemet e shfrytëzimit në ditët e sotme arrijnë të kombinojnë funksionet e tyre për kompjuterë me aparatet celularë si p.sh.: kamera, video kamera, voice recorder, music player, WiFi, GPS mobile navigacion etj. Sistemi i Operimit është përgjegjës për përcaktimin e funksioneve dhe veçorive që gjenden në pajisjen tonë. Zbatimi i aplikacioneve mobile bazohet në sistemin operativ. Çdo prodhues zgjedh sistemin operativ për një pajisje specifike. Për të përcaktuar përputhshmërinë e pajisjeve mobile për aplikacionet, është e nevojshme të mësohet rreth sistemit operativ

mobile. Ky punim jep një ide rreth sistemeve operative mobile. Do të fokusohemi në disa çështje si siguria, mënyrat e hakimit dhe në fund tek ajo që quhet lufta e smartphone-ëve.

Fjalë kyçe: Sisteme shfrytëzimi mobile, siguria, Smartphone, Android

Hyrje

Gjatë dekadës së kaluar smartphone-ët dhe tabletat e kanë përfshirë botën e teknologjisë në mënyrë shumë të shpejtë. Këto aparate kanë një rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë, kjo jo vetëm nga ana harduerike por edhe sistemi i tyre i shfrytëzimit. Një sistem shfrytëzimi mobile është përgjegjës për identifikimin dhe përcaktimin e funksioneve, duke përfshirë këtu sinkronizimin e aplikacioneve, e-mail, tastierë, etj. Sistemi i shfrytëzimit mobile është i ngjashëm me sistemet standarde por është relativisht shumë më i thjeshtë dhe në mënyrë primare menaxhon variacionet e lidhjeve wireless lokale, multimedia mobile dhe variacione të metodave të inputit.

Sistemi i shfrytëzimit përcakton se cilat aplikacione mund të ekzekutohen në pajisje të caktuara. Kompjuterët mund të punojnë me sisteme shfrytëzimi të ndryshme ose me versione të ndryshme të të njëjtit sistem shfrytëzimi.

Një pjesë e mirë e smartphone-ëve e kanë këtë kapacitet të ndryshimit të sistemit të shfrytëzimit, përveç disa rasteve kur nuk mund të përshtaten me versionin e ri të një sistemi shfrytëzimi. Një telefon Android mund të punojë vetëm me

Android dhe një iPhone vetëm me versione iOS¹.

Sistemet e shfrytëzimit ndahen në disa kategori:

1. Zotërues i firmës:

- Apple iOS;
- RIM BlackBerry OS;
- HP WebOS.

2. Zotërues nga një i tretë:

- Microsoft Windows Phone 7;
- Microsoft Windows Mobile.

¹ An Introduction To Modern Mobile Operating Systems. <http://www.addictivetips.com/mobile/an-introduction-to-modern-mobile-operating-systems/>

3. Free & open source:

- Android;
- MeeGo;
- Symbian.

Zhvillimi i sistemeve të shfrytëzimit mobile

Aparatet celulare ndahen në dy lloje aparatesh: feature phone² dhe smartphone³. Një ndryshim i rëndësishëm midis dy versioneve është niveli i zhvillimit të API në smartphone për të bërë të mundur ekzekutimin e aplikacioneve third party⁴. API i lejon aplikacioneve të integrohen më mirë në aparatet me OS sesa në feature phone.

Smartphone-ët janë telefona celulare të ndërtuar në sisteme shfrytëzimi mobile.

Sistemi shfrytëzimit i parë i përdorur në smartphone-ët e parë është kombinuar me OS e axhendave personale dhe funksioneve të aparateve celulare⁵. Një nga sistemet e parë të zhvilluar për axhendat personale dhe më pas si një sistem shfrytëzimi mobile është PALM OS, i cili vazhdoi zhvillimin e OS vetëm për axhendat personale derisa në treg u hodh NOKIA S40, një platformë softuerike e cila u implementua në telefonat që deri atëherë ishin quajtur feature phones.

NOKIA S40 është një nga platformat më të përdorura në miliona pajisje.

Lëshimi i këtij OS ishte me Nokia 7110 i cili është konsideruar si një nga aparatet e parë multimedial me aftësinë e dërgimit të mesazheve dhe me një browser WAP. Një platformë tjetër softuerike e Nokia-s është edhe S60 e cila u zhvillua në katër versione dhe u adaptua nga disa pajisje të ndryshme si

Panasonic, Samsung, Lenovo, Sony Ericsson⁶. S60 versioni 5 u emërua Symbian dhe këtu filloi evolucioni Symbian. Symbian ishte OS më popullore në vitin 2010 por me zhvillimin e mëtejshëm të Android dhe iOS, përdorimi i Symbian është reduktuar ndjeshëm. Pothuajse në të njëjtën kohë paralelisht zhvillohej edhe Windows mobile, i cili u bazua në kernelin e Windows CE [4].

² Telefonat e pare jo të bazuar në sisteme operimi.

³ Telefona celulare të ndërtuar në sisteme operimi.

⁴ Third party-aplikacione shitesë që instalohen në sisteme operimi.

⁵ Brian Fling, Mobile Design and Development, ISBN: 978-0-596-15544-5, O'Reilly.

⁶ Greg Shackles, Mobile Development with C#, ISBN: 978-1-449-32023-2, O'Reilly.

U dizajnua në një mënyrë të ngjashme me versionin desktop të Windows i cili u zhvillua deri në versionin 6.5.5.

Një tjetër sistem shfrytëzimi është dhe BlackBerry OS, i cili u zhvillua nga RIM (Research In Motion) me versionin 1.0 deri në versionin 6.0. Versioni BlackBerry OS 7 u shfaq në pajisjet

BlackBerry Bold, BlackBerry Touch dhe BlackBerry Curve dhe çdo pajisje e mëparshme nuk mund të kishte këtë OS. U zhvilluan shumë sisteme shfrytëzimi dhe vetë kompanitë mobile zhvilluan sistemet e tyre si p.sh.: HP webOS, Samsung Bada, etj., por vetëm dy sisteme shfrytëzimi konkurrojnë në ditët e sotme iOS dhe Android⁷.

iOS u zhvillua nga Apple Inc dhe u lëshua në vitin 2007 për iPhone dhe iPod-e por në ndryshim me OS-ët e tjera, iOS nuk është licencuar të instalohej në pajisje jo-Apple. Versionet e iOS azhurnohen një herë në vit nëpërmjet iTunes. Çdo version i lëshuar ka karakteristikat e tij që e bëjnë të dallueshëm nga versionet e tjera, karakteristika këto të cilat janë përmirësuar nga njëri version në versionin tjetër⁸.

Android u lëshua për herë të parë në vitin 2007 në versionin beta. Versioni i parë komercial u lëshua në shtator të vitit 2008⁹. Ai u zhvillua nga Google dhe Open Handset Alliance dhe që atëherë ka hasur në azhurnime të shumta nga version i tij origjinal. Aparati i parë që ka lëshuar Android 1.0 ishte HTC Dream. Versionet e tjera të Android ishin të bazuara në Linux kernel.

Android ka një komunitet të gjerë të zhvilluesve që krijojnë aplikacione që shtojnë funksione të ndryshme në pajisje. Ata i shkruajnë fillimisht në një version të Java-ës. Android ka një përdorim të madh dhe arsyeja është sepse ai është free OS¹⁰. Një arsye tjetër është mundësia e përdorimit të këtij sistemi shfrytëzimi në aparate të ndryshme dhe jo vetëm në aparate iOS.

7 <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/68341/iphone-vs-android>

8 <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/63292/ios-versions>

9 Greg Shackles, Mobile Development with C#, ISBN: 978-1-449-32023-2, O'Reilly.

10 <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/58426/android> dhe

<http://www.nielsen.com/us/en/insights/news/2011/who-is-winning-the-u-s-smartphone-battle.html>




Fig. 1: Shitjet e Smartphon-ëve në %

Sistemet e shfrytëzimit do të vazhdojnë zhvillimin e tyre dhe është për t'u parë se cila veti e sistemit do të jetë primare për zhvilluesit e tyre. Nëse do të jetë siguria apo shtimi i funksionaliteteve të ndryshme që do e bëjnë atë më interesant për përdoruesin.

Me rritjen e përdorimit të aparateve smartphone si një mjet komunikimi por edhe si një mjet që ndihmon në organizimin e punëve ose të jetës private, siguria në aparatet celularë është kthyer në një nga çështjet më të rëndësishme. Të gjithë smartphone-ët në të njëjtën mënyrë si kompjuterët

janë të ekspozuar ndaj sulmeve të hakerave. Këto sulme shfrytëzojnë dobësitë e smartphone-ëve dhe mund të vijnë nga burime të ndryshme si SMS, MMS, rrjete WiFi ose GSM, por ka edhe sulme që shfrytëzojnë dobësitë softuerike të sistemit të shfrytëzimit. Së fundmi ka edhe softuere "të infektuar" të cilët shfrytëzojnë informacionin e pakët që mund të ketë përdoruesi¹¹. Një përdorues smartphone-i është vazhdimisht i ekspozuar ndaj kërcënimeve të ndryshme gjatë përdorimit të telefonit të tij. Këto ndërhyrje mund të shkaktojnë probleme në funksionimin e aparatit telefonik dhe në transformimin ose vjedhjen e të dhënave personale.

¹¹ https://en.wikipedia.org/wiki/Mobile_security

Arsyet e sulmeve

1. Të dhënat: Smartphone-ët janë pajisje për menaxhimin e të dhënave, kështu që mund të përmbajnë të dhëna si p.sh: numrat e llogarive bankare, informacione private, etj.

2. Identiteti: nëpërmjet smartphone-ëve mund të transmetohen të dhëna të cilat kanë të bëjnë me personin që zotëron atë aparat si p.sh.: nr. pasaporte, të dhëna për kontrata biznesi, etj.

Kjo mund të jetë një nga qëllimet e sulmeve për vjedhjen e identitetit në përdorimin e tij për çështje jo ligjore.

3. Disponueshmëria: duke sulmuar një smartphone është e mundur limitimi i funksionalitetit të tij.

Burimi i sulmeve

Të bazuar në komunikim

Disa nga sulmet rrjedhin nga të metat e menaxhimit të SMS dhe MMS.

Mesazhet SMS të dërguara nëpërmjet internetit mund të përdoren në sulme kundrejt infrastrukturës së komunikimit mobile të një qyteti të madh.

Ky sulm shkakton vonesën e dërgimit të mesazheve për të ngarkuar rrjetin.

Një tjetër sulm i mundshëm është edhe ai nëpërmjet MMS-ve duke bashkangjitur skedarë të infektuar me virus të cilat në momentin që përdoruesi vendos t'i hapë, aparati është automatikisht i infektuar. Një shembull real është ai i virusit Commwarrior i cili përdorë listën e kontakteve dhe u dërgon mesazhe MMS të gjithë kontakteve menjëherë pas hapjes së mesazhit.

Një lloj sulmi tjetër është i bazuar në rrjetet e komunikimit, pra mund të ndodhin nëpërmjet rrjetit GSM, WiFi ose Bluetooth. Sulmet nëpërmjet rrjetit GSM kryhen më lehtë për arsye se algoritmet që janë përdorur për ndërtimin e rrjetit GSM thyhen më shpejt.

Sulmet e bazuar në WiFi janë edhe më të shpeshtë. Nëpërmjet tyre mund të sigurohen username dhe fjalëkalime. Sistemet janë shumë të ndjeshëm ndaj këtyre sulmeve sepse shpesh herë WiFi është e vetmja mënyrë për të pasur akses në internet¹². Meqenëse smartphone-ët janë pajisje të cilat mund të aksesohen nëpërmjet internetit, ata mund të sulmohen aq lehtë sa edhe kompjuterët.

12 https://en.wikipedia.org/wiki/Mobile_security

Malware

Malware janë programe kompjuterike të cilat kanë për qëllim dëmtimin e sistemit në të cilin ndodhen. Por duhet theksuar se malware janë ndjeshëm më të pakët në smartphone në krahasim me kompjuterët. Disa nga viruset dhe Trojanet më të njohur janë: *Cabir*, *Commwarrior*, *Phage*, *RedBrowser*, *WinCE.PmCryptic.A*, *CardTrap*, etj. Ekziston një shumëllojshmëri të malware dhe kjo për faktin sepse ka një shumëllojshmëri të sistemeve të shfrytëzimit¹³. Megjithatë sulmuesit mund të krijojnë malware të cilat mund të shpërndahen në sisteme të ndryshme.

Të bazuar në dobësitë e softuerit

Sulme të tjera janë të bazuara në të metat e sistemit të shfrytëzimit ose aplikacioneve që ndodhen në aparatin mobile. Smartphone-ët mund të jenë viktima të piraterisë klasike si phishing ose website të infektuar. Diferenca me kompjuterët është se smartphon-ët akoma nuk kanë një antivirus të fuqishëm. Shpesh herë është e mundur të arrihet të kalohet mbrojtja duke modifikuar vetë sistemin e shfrytëzimit. Këto sulme janë të vështirë dhe në botën reale kjo kërkon manipulimin e firmware. Në teori smartphone-ët kanë një avantazh kundrejt hard drive, sepse skedarët e sistemit të shfrytëzimit janë në ROM dhe nuk mund të ndryshohen nga malware.

Mekanizmat e sigurimit ndaj sulmeve janë të ndara në disa kategori, përderisa jo të gjithë sillen në të njëjtin nivel dhe klasifikohen në bazë të menaxhimit të sigurisë, sistemit të shfrytëzimit deri tek niveli i njohurive të përdoruesit. Duke marrë në konsideratë këto klasifikime, në rastin e parë sistemi mund të ruhet nga një aplikacion, kurse në rastin e dytë instalimi i softuere-ve të dyshimtë do të parandalohet. Shtresa e parë e sigurisë brenda një smartphone-i është në nivelin e sistemit të shfrytëzimit. Përveç roleve të zakonshme të një sistemi shfrytëzimi duhet gjithashtu të vendoset një protokoll për vendosjen e aplikacioneve të jashtme dhe të dhënave pa paraqitur asnjë rrezik. Disa mënyra të tjera për t'u siguruar nga sulme të ndryshme janë edhe vrojtime që duhet të kryejë përdoruesi në aparatin e tij. Në qoftë se përdoruesit janë të kujdesshëm shumë sulme mund të parandalohen.

¹³ https://en.wikipedia.org/wiki/Mobile_security

iOS jailbreaking dhe Android rooting

Zotërimi i një pajisje mobile si smartphone ose tablete nuk do të thotë që ke fituar të gjithë të drejtat mbi atë sistem shfrytëzimi. Softuerë të smartphone përfshijnë një shtresë DRM¹⁴. Ky DRM ekziston për dy arsye: për të limituar softueret që përdoruesi mund të instalojë në pajisje dhe për arsye sigurie.

Jailbreaking

Jailbreaking është një nga proceset më të njohur dhe më të përdorur, me vetëdije, të hakimit të pajisjeve mobile për të kapërcyer kufizimet DRM, duke lejuar kështu përdoruesin të instalojë softuerë të paaautorizuar dhe të kryejë ndryshime në sistemin e shfrytëzimit.

Jailbreaking mund të konceptohet si një proces instalimi të disa kernel të modifikuar, duke qenë se kernel është supervizori i sistemit të shfrytëzimit, i cili lejon përdoruesin të ekzekutojë një kod të pa nënshkruar¹⁵. Gjithashtu i jep akses në nivel rutimi i cili në rast të kundërt nuk do ishte e mundur.

iOS është një mjedis i mbyllur dhe aplikacionet duhet t'i përmbahen udhëzimeve të rrepta të Apple për të arritur deri në App Store. Ky kufizim ekziston për mbrojtjen e përdoruesit dhe për të mbajtur një nivel të lartë të përgjithshëm të aplikacioneve.

Rooting

Rooting është një proces që u lejon smartphone, tabletave ose pajisjeve të tjera që punojnë me Android OS të përfitojnë kontrolle të privileguara, të njohura si root access, në nënsistemin e Android. Shpesh Rooting kryhet me qëllimin e kapërcimit të limiteve, për të pasur mundësi të modifikojë ose të zëvendësojë aplikacionet e sistemit, të ekzekutojë aplikacione që kërkojnë leje në nivel administratori ose të kryejë veprime të tjera, të cilat në ndonjë rast tjetër nuk do mund të aksesoheshin nga përdoruesit normal të Android.

Rooting është e ngjashme me jailbreaking në një pajisje Apple me sistem shfrytëzimi iOS, por tek Android rooting mund të lehtësojë heqjen e plotë dhe zëvendësimin e sistemit të shfrytëzimit të pajisjes. Pavarësisht deklaramit

14 DRM-Digital Rights Management

15 Kod i pa nënshkruar-Uncoded code-i referohet një aplikacioni të cilit nuk i është caktuar një çelës sekret

që Android është një sistem shfrytëzimi open source, përdoruesi akoma nuk ka akses të plotë rutimi.

Rooting është i kërkuar për veprime më të avancuara dhe potencialisht të rrezikshme duke përfshirë këtu modifikimin ose fshirjen e skedarëve të sistemit ose aksesimin e vetë harduerit.

Një tjetër qëllim përdorimi është heqja ose zëvendësimi i sistemit të shfrytëzimit¹⁶.

Në krahasim me iOS jailbreaking, rooting nuk përdoret për të instaluar aplikacione të cilat gjenden jashtë google play. Android OS e mbështet këtë shtesë në dy mënyra nëpërmjet opsionit

“Burime të panjohura”.

Rooting i Android ka avantazhe shumë të mëdha si p.sh. ndryshimi i sistemit të shfrytëzimit duke marrë atë më të fundit, mund të ndryshohen temat e pajisjes, ka shumë aplikacione për pajisjet e rutuara të cilat do të përmirësonin në mënyrë drastike performancën dhe jetëgjatësinë e baterisë. Një nga disavantazhet më të rëndësishme është rreziku i shkatërrimit të sistemit softuerik të quajtur “bricking” në mënyrë të tillë që aparati të mos funksionojë më dhe të jetë i papërdorshëm¹⁷. Një tjetër arsye është edhe siguria, duke rritur rrezikun për të instaluar softuerë të infektuar. Ndonëse këto raste nuk janë shumë të njohur, gjithsesi është e rekomandueshme që pas Rooting të instalohet një softuer antivirus. Ekziston mundësia që të rikthehesh dhe ta ç ‘bësh rooting.

Lufta midis smartphone-ëve

Lufta midis smartphonë-ve është një betejë biznesi e vazhdueshme midis prodhuesve si Apple Inc, Google, Samsung, Microsoft, Nokia, Motorola dhe HTC, dhe të tjerëve në një konflikt patentash. Ky konflikt është pjesë e një rrjeti më të madh lufte midis korporatave të teknologjisë dhe softuer-ëve.

Kompanitë i përdorin patentat kryesisht për të mbrojtur «pronën intelektuale» nga përdorimi ikonkurrencës dhe gjithashtu për të siguruar ose për të rritur shpërndarjen e tyre komerciale duke ngadalësuar progresin e konkurrencës. Që nga viti 2010, në tregun e smartphone-ëve, ka një numër

16 <https://www.tomsguide.com/us/Root-Your-Android-Phone,review-1688.html>

17 <https://www.tomsguide.com/us/Root-Your-Android-Phone,review-1688.html>




Fig. 2: Patentat për pajisjet mobile. Burimi: Reuters, news reports

të madh akuzash dhe kundër akuzash të bazuara tek patentat dhe grafika. Kjo është një nga skemat se sa shumë është përhapur kjo luftë¹⁸.

Qëllimi i patentave është mbrojtja e “pronave intelektuale” dhe inkurajimi i risive. Gjithsesi ato janë përdorur në mënyrë ofensive duke kërcënuar me çështje gjyqësore, ose për të detyruar kompanitë të ndajnë kohë dhe para të cilat mund të përdorshin në mënyrë më të mirë për kërkime dhe zhvillime.

Windows phone vs Android

Windows 8 është i vlefshëm për pajisje të ndryshme, përfshirë desktop, tabletat, dhe faktorë të tjerë formë. Windows 8 ka shumë ngjashmëri me Android nga arkitektura e sistemit operativ në konceptet e zhvillimit të app, mjetet dhe pajisjet e zhvillimit të softuerit (SDKs).

Kernel i Windows 8

Windows 8 ka një arkitekturë driver që lejon user-mode, si dhe *kernel-mode driver*. User-mode drivers (të tilla si ato për kamerat dhe printerët) funksionojnë në një mjedis pak të privilegjuar në user mode, e cila ndihmon

18 <https://www.pcmag.com/article2/0,2817,2399098,00.asp>

për të parandaluar përplasje të sistemit që shkaktohen nga probleme të cilësisë së driverit¹⁹.

Kernel i Android

Android është ndërtuar duke u bazuar në thelbin e programit Linux që është përshtatur për aparate celularë. Ndryshimet thelbësore përfshijnë menaxhimin efikas të energjisë, rritjen e sigurisë, mbështetje të re të hardware, përmirësimin e performancës së sistemit të *flash file*, dhe raportimin e përmirësimit të gabimeve. Aplikacionet e Android janë mbartur në brendësi të Java (JVM) gjatë kohës së punës dhe ata mund të përdorin një pjesë (subset) të JavaAPI, që janë në themel të Java Development Kit (JDK).

Android gjithashtu ofron lidhjet Java për zonat e programimit me platformë specifike si menaxhimin e energjisë, ndërfaqen e përdoruesit, memorien lokale dhe integrimin e shërbimeve cloud²⁰.

Përfundime

Sistemet e operimit kanë arritur të ndikojnë në jetën tonë të përditshme. Funksionet në aparatet celularë janë nga më të ndryshmet duke filluar nga ato më elementaret që ekzistojnë në telefonat pa sistem shfrytëzimi si ora dhe alarmi, mesazhet, etj., dhe deri tek ato që mund të krijohen për qëllime personale.

Jo të gjitha kompanitë kanë qenë të suksesshme në zhvillimin e vazhdueshëm të sistemeve të shfrytëzimit, por kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë pasur fitime financiare. Kjo tregon që akoma aparatet celularë nuk zgjidhen nga cilësia e sistemit të shfrytëzimit që punon në të. Ata kryesisht klasifikohen nga emri i firmës dhe më pas nga funksionalitetet e tyre.

Rëndësinë e sistemit të shfrytëzimit në vëmendjen e përdorueseve e ka sjellë edhe lufta e patentave midis smartphon-ëve. Kjo është nga të paktat anë pozitive që ka shfaqur kjo luftë e vazhdueshme.

Pavarësisht suksesit që këto sisteme kanë, ato ekspozojnë vazhdimisht të dhënat personale të përdoruesit. Kjo tregon që zhvillimi i teknologjisë nuk shton sigurimin e të dhënave personale edhe pse qëllimi është ky.

19 <http://www.differencebetween.info/difference-between-android-and-windows-phone>

20 <http://www.differencebetween.info/difference-between-android-and-windows-phone>

Edhe pse këto sisteme shfrytëzimi ofrojnë funksionalitete të mëdha, përdoruesit nuk janë mjaftueshëm të kënaqur dhe gjithmonë gjejnë opsione të ndryshme për pasurimin e sistemit të tyre të shfrytëzimit, duke pasur mundësinë e ndryshimit të versioneve të sistemit të shfrytëzimit, shtimin e aplikacioneve që i ndihmojnë ata në jetën e tyre, etj.

Janë bërë hapa shumë të mëdha, nga pika në të cilën një veprim kryhej nga disa komanda DOS-i deri më sot që një prekje ekrani është e mjaftueshme për hapjen e një aplikacioni.

Sistemet e shfrytëzimit vazhdojnë zhvillimin e tyre. Në një të ardhme mund të kemi sisteme me funksione shumë më të avancuara se këto që na impresionojnë sot.

Bibliografia

1. An Introduction To Modern Mobile Operating Systems <http://www.addictivetips.com/mobile/an-introduction-to-modern-mobile-operating-systems/>
 2. Brian Fling, Mobile Design and Development, ISBN: 978-0-596-15544-5, O'Reilly.
 3. Greg Shackles, Mobile Development with C#, ISBN: 978-1-449-32023-2, O'Reilly.
 4. <http://www.nielsen.com/us/en/insights/news/2011/who-is-winning-the-u-s-smartphone-battle.html>
 5. https://en.wikipedia.org/wiki/Mobile_security
 6. <https://www.pcmag.com/article2/0,2817,2399098,00.asp>
 7. <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/58426/android>
 8. <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/63022/symbian>
 9. <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/63292/ios-versions>
 10. <https://www.pcmag.com/encyclopedia/term/68341/iphone-vs-android>
 11. <https://www.tomsguide.com/us/Root-Your-Android-Phone,review-1688.html>
- [12] <http://www.differencebetween.info/difference-between-android-and-windows-phone>

Summary

Nowadays mobile phones are part of our inseparable life but few of us have known what are the usage systems without which they can't work.

Mobile usage systems were developed because it was necessary for a personalized computer to be used on minimized handsets.

Today's operating systems are able to combine their functions for computers with mobile devices such as camera, video camera, voice recorder, music player, WiFi, GPS mobile navigation etc. The Operating System is responsible for determining the functions and features found on our device. The application of mobile applications is based on the operating system. Each manufacturer chooses the operating system for a specific device. To determine the compatibility of mobile devices for applications, it is necessary to learn about the mobile operating system. This paper gives an idea about mobile operating systems. We will focus on some issues like security, hacking, and ultimately what is called Smartphone warfare.

1. Në redaksinë e revistës shkencore “LOGOS” pranohen artikuj të cilët nuk janë publikuar më parë dhe nuk do të publikohen përpara se të dalin në këtë revistë.
2. Artikulli duhet të përmbajë 4000-5000 fjalë.
3. Abstrakti rreth 200 fjalë vendoset në fillim të artikullit.
4. Artikujt duhet të paraqiten në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje të shkurtuar në gjuhën angleze, në hard copy dhe në formë elektronike, të punuara në Microsoft Word, me shkrim “Palatino Lynotype”, madhësi shkrimi “12”.
5. Në fillim të faqes së parë të artikullit vendoset emri dhe mbiemri i autorit, titulli akademik, grada shkencore, funksioni dhe emri i institucionit ku punon.
6. Citimet dhe shënimet vendosen në fund të faqes dhe numërohen në mënyrë kronologjike.
7. Tabelat, grafikët dhe ilustrimet numërohen në mënyrë kronologjike dhe poshtë shënohet burimi nga janë marrë të dhënat.
8. Literatura e konsultuar ose bibliografia vendoset në fund të tekstit, e renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve. Kur citohen disa vepra të të njëjtit autor, më përpara vendoset botimi më i hershëm.
9. Çdo artikull i dërguar në adresën e redaksisë u jepet për recension dy studiuesve kompetentë në fushat përkatëse. Artikulli botohet nëse të dyja recensat janë pozitive. Nëse njëra është pozitive dhe tjetra negative, punimi i jepet një recensenti të tretë, vlerësimi i të cilit vendos për botimin ose jo të punimit.
10. Varianti elektronik i çdo numri të revistës publikohet në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar “LOGOS”: www.shlplogos.edu.al.

